ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 6 NËNTOR 2021. NUMËR 155 VITI IV I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Këto kujtime, ky udhëtim fizik dhe mendor, si te çdo njeri, kanë ndikuar tek unë si frymëzim për të shprehur në poezi çfarë është disi e veçantë, trazuese, mbresuese, e njëjtë apo e ndryshme në kohë, rrënjosur në vete nëpër vite, një univers real e metaforik i qyteteve ku kam jetuar.

TIMO FLLOKO: Tri poezi për tri qytete ku kam jetuar

(fq. 2)

SHËNIME PËR LIBRAT

"Një sagë e vogël" e Besnik Mustafajt botohet në arabisht

NJERIU I KRIJUAR NGA BURGU

nga Somer Shahade

Nga jehona në shtypin arab për romanin "Një sagë e vogël", botuar në arabisht nga shtëpia botuese *Al-Aan*, me përkthim nga origjinali të Ibrahim Fadlullah. Shkrimi i mëposhtëm është botuar në suplementin kulturor të njërës nga gazetat më të mëdha arabofone, *Al Araby*, e cila del në Londër dhe shpërndahet në mbarë botën. (fq. 5)

Romani "Marrja e gjakut" nga Andreas Dushi

Absurdi i qeniesimit - Back to the roots

Nga Ballsor Hoxha (fq. 8)

Autori i romanit "Marrja e gjakut" është krejtësisht i vetëdijshëm për pragmatizimin e leximit sot, për pragmatizmin e rrëfimit, e qoftë edhe të pragmatizimit të – ëndrrës mashtruese – letërsi! Në paragrafin hyrës të këtij romani lexuesi ngacmohet dhe vëmendësohet se nuk do të ketë mëshirë ndaj po këtyre pragmatizmave.

FILLIMET E MODERNITETIT NË PROZËN ROMANORE SHQIPE

nga Ermir Nika (fq. 9)

Letërsia shqipe, pavarësisht kushteve më të cilat u përball pas Luftës së Dytë Botërore, nuk duhet të vlerësohet si një hallkë e shkëputur nga zhvillimet e letërsisë europiane dhe anasjelltas, letërsia në Europë, në historinë dhe në traditën e saj, nuk do të ishte e plotë pa lëvizjet që u vunë re në letërsinë shqipe.

DAMON GALGUT FITON "THE BOOKER PRIZE" 2021

Kjo është hera e parë kur Galgut do të nderohet me çmimin £50,000, paçka se ai ka qenë në listën e ngushtë edhe dy herë të tjera. "The Promise" është romani i tij i nëntë dhe i pari në shtatë vjet. Kështu, ai u bë i treti afrikano – jugor që e fiton këtë çmim prestigjoz pas JM Coetzee dhe Nadine Gordimer. (fq. 21)

RUSANA HRISTOVA BEJLERI:

Duhet të përgatitemi për 100 vjetorin e lindjes së shkrimtarit Thoma Kacori (1922-2008)

Bisedë e Mimoza Hasani Pllana me albanologen e njohur bullgare (fq. 14)

Arratia nga Parajsa e Lev Tolstoit: Faji i kujt, pra?

Nga Pavel Valereviç Basinski

Përktheu nga origjinali Agron Tufa (fq. 12)

(fq. 22)

DIAPSALMATA

Søren Kierkegaard

BIBLIOTEKË

Adil Olluri (fq. 16)
Legjenda për artistët dhe ministrin

Dan Ibrahimi (fq. 17)
E njëjta hënë

Mara Venuto (fq. 18)
Natë e ethshme

Bruno K. Öijer (fq. 19)
Kurrë s'do ta kuptosh

Skënder Rusi (fq. 10)
Lëndina e pikëllimit

"PUTHJA" E GUSTAV KLIMT

Nga Bledar Kurti (fq. 20)

LEKSION PËR STUDENTËT E ARTIT

Oscar Wilde (fq. 7)

Shtëpia e gjyshit në Gjirokastër

TIMO FLLOKO: TRI POEZI PËR TRI QYTETE KU KAM JETUAR

Ndonjëherë, kur i hedh një vështrim së shkuarës, s'di pse koha e jetës, e viteve, muajve, ditëve, orëve e çasteve sikur ngrin në përfytyrim, një ngrehinë e brishtë, por kështjellore, e vendosur në zemër të elementeve të natyrës, erës, shiut, detit, relievit të vet të papërsëritshëm e të ndryshëm në gjeografinë emocionale të kujtesës... në fantazi sa në vetëdije. Fëmijëria më shfaqet me figurën e vet, me qytetin "miturak" të saj; adoleshenca rend me një hap më ekspresiv e dinamik, kurse ajo që do t'i përkiste kohës së munguar në qytetin e origjinës ku s'ke jetuar një ditë të vetme i përngjet gjithaq një ngrehine, por surreale, të ngritur në mjegull a për së thelli saj... dhe brenda vetes secili e ndien se koha e jetuar është një histori, që ka pa fund çaste, ngjarje e mbresa, me emocione të secilës stinë të jetës. Këto kujtime, ky udhëtim fizik dhe mendor, si te çdo njeri, kanë ndikuar tek unë si frymëzim për të shprehur në poezi çfarë është disi e veçantë, trazuese, mbresuese, e njëjtë apo e ndryshme në kohë, rrënjosur në vete nëpër vite, një univers real e metaforik i qyteteve ku kam jetuar.

QYTETI ËNDËRR

Gjirokastra, qyteti i tim eti, i gjyshit Grigor dhe gjyshes Katerina, i xhaxhallarëve të mi dhe të afërmve të tyre. Qytet ku gjyshi ndërtoi një shtëpi, në vitin 1927, që ndodhet përballë gjimnazit "Asim Zeneli" të qytetit, në krye të Palortosë (sot bulevardi "Kadare"). Në atë shtëpi jetoi familja e Grigorit, im atë dhe vëllezërit e tij deri pas lufte, kur familja u vendos në Vlorë. Unë nuk kam jetuar në Gjirokastër asnjë ditë, s'kam fjetur në atë shtëpi asnjë natë (shtëpinë e kishin dhënë me qira te doktor Zhusti, i ungji i aktorit Viktor Zhusti; ata jetuan aty deri në fund të viteve '60). Kam xhiruar katër filma në Gjirokastër, kam jetuar atje në mënyrë "virtuale", artistike nëse e kthej në metaforë, vetëm përmes roleve në filma, që nga filmi i parë *Ngadhënjim mbi vdekjen*, deri te *Çerçiz Topulli*, heroi legjendar, i kthyer në legjendë jo veç përmes bëmave të tij asokohe (që vrau dhe bimbashin turk), por edhe prej statujës së mrekullueshme në bronz, të punuar me art nga Odise Paskali i madh! Në këmbën e djathtë të atij monumenti ka një shpim plumbi, qëlluar hershëm nga një ushtar a komit grek, me ose dhe pa qëllim. Dhe vitet ikën si nëpër erë, duke lënë historitë e këtij qyteti magjik pas, të legjendarizuara e të kthyera në mite kohëve. Në bulevardin "Ismail Kadare", dikur Palortoja, nga shtëpia e Fllokajve, te Skëndulajt dhe deri te Hoxhajt (shtëpia e udhëheqësit komunist Enver Hoxha), diku në midis, merr për poshtë Sokaku i të Marrëve, më i përfoluri, më i çarturi, më i çuditshmi dhe më absurdi në qytetin kryelartë.



Rruga me emrin tim në Pejë

Sokaku i të Marrëve
Qytetit të origjinës

Tatëpjetë Sokakut të të Marrëve zbres,
Nëpër të mistertin katakomb, në terr.
(Ç'fantazi e prapë ta ketë shpikur, vallë,
Këtë pjerrinë a udhë të fshehtë për ferr?)

T'i merr mendtë, të pataks ky qytet,
Që rri pezull atje përmbi re,
Ngritur lartësive, dozot, enkas,
Erërave të qiellit për t'u bërë fole.

Yjet varur sa s'i prek me dorë,
Dritë e Hënës e ngjyros me ar qytetin,
I çuditshëm duket ai, surreal,
Si në pikturat e Bashkim Zano-Ahmetit.

Mbahem fort mos më merr rrëpira,
Tatëpjetë atij honi mesjetar,
Rrapëllimës, ku dikur lëshoi
Aeroplanin Dino Çiçua i marrë...

Si i verbër mund të qorrollisesh,
Të gremisesh, shenjë të humbësh fare,
Ca më keq, mendsh të ikësh përngaherë,
Kur shkon poshtë Sokakut të të Marrëve.

Si skaj ëndrre që s'ia gjen dot fundin,
Të tërheq me vete e të merr.
(Tek shkel gurë prej stralli, më ngjan vetja
Si Virgjili i Dantes nëpër ferr...)

Kufi i shuar mes dheut, nëndheut,
Arkeolog në botë ta ndajë s'e ka të lehtë,
Nën një sterrë të këtij labirinti, ndoshta,
Fshihet *Grali*, misteri i shenjtë.

Sokak i fantaksur, kryemarrë,
Më i thikëti pa fjalë në univers,
Që mbyt grahma dhimbjesh gjer në zgrip,
Dhe jep shpirt te pragu i Kadaresë.

Më bëhet se prej shekujsh endem,
Si një hije nëpër gjurmët e të parëve,
I përhënur nga magjí e natës zbres
Si i marrë Sokakut të të Marrëve.

QYTETI KU LINDA

Peja, e rrethuar malesh të larta deri në qiell, në përfytyrimin tim prej fëmije, nga Bjeshkët e Nemuna, përgjatë grykës përpirëse të Rugovës, ku derdhet gjithë pesha e atyre maleve si një uragan erërash të forta e sa herë përmbysëse... Lindja dhe frymëmarrja e parë thonë se lidhet me mbrujtjen e bionatyrës njerëzore, si të thuash se ajri që thith në vitet e para të jetës krijon dhe prirjen e trupit përshtatur me atë klimë, të ftohtë a të ngrohtë, krijon madje kiminë ndjesore, fiziobiologjike, të individit njerëzor. Në vite kam ndier se pëlqej, në rastin më të parë, klimën malore, sa më lart nivelit të detit... Peja më afron si ndjesi klimatike me Lurën, Voskopojën, Leskovikun...

Në Pejë jetova 8 vjet, para se të vendosesha në Vlorë, në një klimë tipike mesdhetare, sigurisht, nga më të jashtëzakonshmet mbi glob, por disi të panatyrshme për mua në krye të herës. Në Pejë kalova miturinë, bri lumit të Bistricës, që përshkon qytetin; në bregun e saj. Shtëpia jonë ishte në rrethin qendror të qytetit, përballë kinemasë (aty ku nisën ëndrrat) dhe në afërsi të Teatrit. Në kinema isha i përhershëm, një spektator pa "portofol", me hyrje të lirë në çdo seancë, ku me orë të tëra mahnitesha nga filmat *western* me *cowboys*. Sa herë

Foto me Çerçizin e Odise Paskalit.

Roli i Çerçiz Topullit me Liza Laskën, nënën


Portreti i Timo Fllokos, në rolin e Çerçizit, nga piktori Bujar Luca, gjatë xhirimeve të filmit, 1969

ndodhte të më merrnin kur errej e vonoja të kthehesha në shtëpi. Ndieja dorën e ashpër të nënëgjyshes ose zërat e butë të tezeve apo dhe të nënës kur ndodhte të vinte përmes errësirës së sallës ku shfaqej filmi. Në atë *bioscop* (kinema) më lindi embrioni i dashurisë për t'u bërë një aktor filmi, i frymëzuar e plot ëndrra aventurash në kryet e mi, një dëshirë e dashuri e pavetëdijshme prej fëmije. Për të mos i thënë të gjitha, po e lë këtë rrëfim në mes sa edhe në imagjinatën e kureshtjen lexuesit, me idenë se ka kohë kurdoherë për t'i thënë gjërat që s'janë thënë.

Peja
Vendlindjes

Pejë,
në ijë të Bjeshkëve të Nemuna
që si pleq të moçëm,
me plisa resh mbi krye,
qiejsh kuvendojnë.
Gërryer thellë, zhuritur,
Gryka e Rugovës.
Lart malet shpinat shtrijnë,
murana flijimi,
ku heshtjen e vet ha durimi,
me lot ujëvarash,
sytë e kalimtarëve i nginj.
Ka rrjedhur koha lumë,
por shtrati i mallit s'është tharë.
Nga padurimi klith:
Më ke pritur herët,
po vij!
Gryka zërin e përpin...
Më pështjell një erë, më mpin.
Nderem në ajrí,
dhe më merr harrimi.
...
Pejë,
vendlindja ime,
në zgrip të pikëllimit!

VLORA, FËMIJËRI DHE RINI E PARË

Mbërrita prej së largu, si një *alien*, nga një botë e natyrë tjetër, në një qytet të dielltë, të ngrohtë e mikpritës pa kufi, por edhe të ashpër e të egër nga natyra e njerëzve. Mbërrita i brishtë, i "sjellshëm", i ndryshëm nga të gjithë moshatarët e mi, nga vëllai im Aleksandër, i vetmi mik e vëlla, i pari që më krijoi hapësirë e kohë, së bashku me Medinin dhe Jahjanë, shokët më të afërt, që natyrshëm të ambientohesha. Nga dita e parë, d.m.th. nga klasa e tretë deri në maturë... 11 vjet jetë, formova "veten", përgjatë një trajektoreje nga më të paimagjinueshmet, me dinamikë intensive, me frekuencat, uljet e ngritjet, rëniet e ngjitjet në rrugën e kalimit (si në kapërcyell), nga fëmijëria dhe çuditë e lojërave të saj në adoleshencë, në zgjimin e dëshirave për art, për poezi e vajza. Nga s'shkova me shokë e s'brodha, nga s'u ngjita e s'u hodha, Qafës së Topit, nga ku Selam Musai qëlloi me top anijet e Italisë së 20-ës, siç thoshin të moçmit, a kur lëshohesha teposhtë Budakut të lugetërve në Tophana... apo kur hidhesha prej majës së Kalasë detit poshtë me krye e jo me këmbë (tani veç kur e shoh nga poshtë më pushton tmerri) dhe si notoja largësisë e zhytesha thellësive për të prekur funddetin, si personazhi i Xhon Steinbekut te *Margaritari*, për të shkulur *pina* (guaska të mëdha) *kumit* (rërës) disa pashë nën ujë. Nuk dyshoj se ato aventura krijuan përvojat e hershme emocionale, pa të cilat s'mund të imagjinohet krijimtaria e aktorit. Duke u rritur dhe duke u larguar nga prapësitë e duke iu afruar librit, leximit, pasionit të të mësuarit të poezive përmendsh e duke provuar si një adhurues naiv artin e të shkruarit – poezi, novelëza, frymëzuar nga leximet, nga Mopasani, Cvajgu, Gogoli... Si ritual, e ndaja kohën e të shkruarit me kohën e plazhit, të lojës së futbollit në rërë me shokët, me kohën e peshkimit netëve vonë me tim atë. Isha plot ëndrra dhe ndonjëherë, i romantizoja netët me *firmamentin* plot yje mbi vete, me ëndërrimet rinore si personazh romantik përrallash, me pritjet e sahershme të sirenës që do të dilte nga deti, mbështjellë me luspa peshku... (!) Por, krahas dëshirës për të "fluturuar" (ku e gjej dhe shkakun e dëshirës së atëhershme prej fëmije për t'u bërë pilot... gjë që e kam shprehur në ndonjë intervistë), përsëri, filmi ishte pasioni dominues, sa në pavetëdije aq në pamundësi. Si çdo djalosh, isha i pushtuar çdo çast nga dashuria për muzikën e huaj, atë italiane më tepër se na ndante veç deti në midis, ndiqja *hit*-paradat, adhuroja Modunjon, Çelentanon, Batistin, Luçio Dalan...

Asokohe, kur s'kishte nisur ashpër lufta ndaj çdo vlere në art apo, më keq akoma, ndalimi i çdo gjëje të kulturës perëndimore, shfaqeshin filma të huaj, sidomos filma francezë me shumicë, me aktorë të mëdhenj, si Zhan Gaben, Zherar Filip, Belmondo, Klaudia Kardinale, Ani Zhirardo etj. Nuk ndodhte të humbisja një film pa e parë, atyre që s'lejoheshin për moshën ua gjenim hilenë, duke kapërcyer murin e duke u futur fshehtazi në kinemanë verore para se të errej dhe dilnim nga poshtë stolave porsa niste filmi. Ato aventura, e jo vetëm, më mbrujtën në mënyrë më serioze një ëndërr, disi të kristalizuar: dhashë dhe fitova konkursin në profilin e artin dramatik për t'u bërë aktor! Rastësia e solli, por ëndrra i dha krahë. 11 vjet në Vlorë, mësova të rritem, të kuptoj, t'u jap formë e trup vizioneve, të notoj e të "fluturoj", të shijoj bukuritë plot mistere të nënujit, t'i dashuroj njëmend si detin dhe qiellin.

Shtëpia buzë Bistricës, në Pejë

S'mora kum te bova
Vlorës, qytetit të rinisë së hershme

Ndarja me ty, Vlorë, ishte më e hershmja.
Sa ndarje pata... si jotja, rrallë në jetë.
Dashurive të shtira ua mbylla portat,
Me ndarje të tilla ku e ku më lehtë.

Ika prej teje me një valixhe të drunjtë,
Mbushur me ëndrra dhe dëshira-peng,
Një vështrim fajshëm në ikje i hodha,
Orës së qytetit ngelur dymbëdhjetë.

Zemra m'u zbraz, u ndjeva i përzënë,
Më tepër nga vetja, Vlorë, se nga ti.
(Mos po ikja larg udhëve pa kthim,
Prapa diellit ta hasja fatin tim?)

A më përzije se dashuria qe sosur?
Zemra jote me pashë s'matet dot,
Shtatin ma ndoqe me nishane sysh,
Stepja ndaj rrezikut nuk më ra për short.

Sa herë kryet rrokullisa Qafës së Topit,
Mbi humnera, vdekjes pranë i shkova,
Zhytur thellësive, frymën gjatë e mbajta,
Cika fundësitë, s'mora kum te bova.

Ma mbolle fatin si një rrënjë ulliri,
U deha nga deti, nga jod' i Jonufrit,
Dunave u shtriva netëve plot magji,
Mblodha yje të këputur gushti.

Ngashëreva mbytur agut kur u nisa,
Rrugica e ngushtë shkretane mbeti,
Më tërhiqte pas çdo skërkë e shkelur,
Nga majë e Shashicës në Shesh të Kateqit.

Lehtas m'u çapit pas nëna, loti iu këput,
Kollën e babait e gërreu heshtja,
Më humbi vështrimit mëhalla e fjetur,
Kuiste era, më përcillte vjeshta.

Vura Sazanin në vend të zemrës,
Rrëmbeva blunë e detit dhe të qiellit,
Perëndimet okër të Nestor Jonuzit,
Thellësinë plumb të Skënder Kamberit.

I mora edhe retë ngarkuar me vete,
Lundrën me kujtime, vitet e një jete,
Harruar pastaj rashë në gjumë të thellë,
M'u bë se fjeta mbase njëqind vjet.

Gjithçka ndryshoi, dashuria ime jo!
Rrënjosur thellë meje, Vlorë, a s'e ndien,
Në këtë heshtje burri mallin e patretur,
Kthimin tim aty ku zemrën lashë peng?

Filmi i parë, "Ngadhnjim mbi vdekjen"

Po Tirana? Asnjë poezi për të? Asnjë varg? Çudi, vërtet, se s'ndodh që një dashuri e gjatë dhe e madhe të mos marrë çfarë natyrshëm i takon! Tiranën, mendoj se e kam pasur ngaherë me vete, në vete, të pandarë sysh e në sy, ndryshe nga qytetet e mia të dikurshme, të cilat, nga droja se po i humbja, më largoheshin e largoheshin, duke më lënë të vetëm apo, në të kundërt, duke u ndier të braktisura prej meje. Tirana është qendra e botës sime. Jetova e jetoj në shtatin e saj, në shtrojën e kraharorit ku ndiej rrahjet e forta të zemrës së saj të madhe, kur shkela për herë të parë në oborrin e shkollës "Aleksandër Moisiu", pranë Teatrit Popullor, në moshën shtatëmbëdhjetëvjeçare, për t'u bërë, siç thonë njerëzit, artist – dhe bëra emër.

Shtegtimi, Los Anxhelesi? Asnjë mbresë, asnjë dedikim, glorifikim, fashinim... Asnjë varg?!

Jo. S'ndodhi, siç kishte ndodhur dikur, në librin e parë, me poemën kushtuar Parisit, *Natë në Montparnasse*, një poemë e gjatë programatike, po ca më shumë çudi poemi qiellor, *Takim me të dashurën Mari...*, shkruar si në *trans*, ndaj një qyteti imagjinar, të së ardhmes, si të kishte qenë real e jo në fantazi, pas një kthimi nga fluturimi fantastik në Tokë pas 9.000 vjetësh, në një raketë me shpejtësinë e dritës... (!) (Pse jo, kur qielli është për këdo qyteti i fundit, i përjetshmi.)

Nuk ka arsye, as ndonjë paradigmë a rregull, se përse nuk lind një poezi a çfarëdo vepër arti në çdo rast, të pritshëm madje, ka veçse një fjalë: *destin*, përsëri si dashuria, e cila nuk ka shpjegim se si ndodh... mbetet mister. Enigma e krijimit fshihet më përtej, në zona të paditura a në ndjesi besëtyte, ku ta dish, asgjë s'mund ta shpjegojë, veçse ta imagjinojë shtysën fanepsëse të frymëzimit, *Pulëbardhën e Anakreontit.*

Jetoj në Tiranë, shkoj në Los Anxheles, në Pejë më rrallë, në Vlorë pranë detit, në Gjirokastër në shpirt të surreales a të ëndrrës dhe, pas çdo ikjeje e shtegtimi në ato qytete, në kthim, ndiej në zemër të më marrë malli...

SHOQATA "MARTIN CAMAJ" ZGJEDH KRYETARIN E RI

Në mbledhjen e fundit vjetore të Shoqatës "Martin Camaj", u zgjodh edhe kryetari i ri. Ai do të jetë Prof. Dr. Christian Voss nga Universiteti Humboldt në Berlin. Nënkryetare e saj vijon të jetë znj. Zuzana Finger, përkthyesja e njohur e letërsisë shqipe në gjuhën gjermane. Ndërsa Ledio Hala dhe Andreas Cyllok do të jenë amëtarë të kryesisë.

Shoqata "Martin Camaj" që e ka selinë në Lenggries ka si synim përkrahjen e shkëmbimit kulturor dhe ndërmjetësimin mes kulturave shqiptare dhe gjermane e sidomos, të përkujdeset për veprën letrare të Camajt edhe duke e përhapur atë. Gjithashtu e ndjek objektivin të përkrahë përhapjen e letërsisë dhe kulturës shqiptare dhe të mbështesë hulumtimin e gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare.

Qëllimet në fjalë shoqata i realizon kryesisht me anë të ligjeratave dhe mbrëmjeve letrare si dhe me kontribute financiare për botimin e librave.

Shtëpia e gjyshit në Gjirokastër, në Bulevardin Ismail Kadare



Nga jehona në shtypin arab për romanin "Një sagë e vogël", botuar në arabisht nga shtëpia botuese Al-Aan, me përkthim nga origjinali të Ibrahim Fadlullah. Shkrimi i mëposhtëm është botuar në suplementin kulturor të njërës nga gazetat më të mëdha arabofone, Al Araby, e cila del në Londër dhe shpërndahet në mbarë botën.

NJERIU I KRIJUAR NGA BURGU

nga Somer Shahade

Errësira sundon jashtë hekurave.

Lexuesi zbulon se burgu, që duket si vend në romanin "Një sagë e vogël burgu", i shqiptarit Besnik Mustafaj, nuk është thjesht një vend. Romani, i botuar nga shtëpia botuese jordaneze "Al -Aan", me shpërndarje në mbarë botën arabe, përkthyer nga origjinali shqip prej Ibrahim Fadlullah, trajton ndryshimet e thella psikologjike, që shkakton burgu mbi të burgosurit, gardianin dhe familjet e tyre.

Romani ndahet në tre libra. Secili prej tyre tregon një aspekt nga jeta në burg. Romani zbulon botën e errët të burgut dhe, nëpërmjet zbërthimit të padrejtësive, bëhet edhe zbërthimi i njeriut, që ka krijuar burgu, në vend që të dalë andej një njeri i ri dhe i shëruar. Romani nuk del jasht realitetit të egër dhe po kështu atij nuk i mungon shpresa dhe optimizmi.

Në librin e parë: Bardhyli Huta rrëfen historinë e babait të tij, Omer Huta. Është një tregim, që ai e ka të lidhur me gjyshin, Oso Hutën, me kontradiktat midis të vërtetës së dukshme dhe të asaj, që është e fshehur. Gjyshi, gjatë regjimit mbretëror, kishte qenë i dënuar politik. Omeri u rrit në dy periudha të ndryshme: njëra shkon deri në moshën dymbëdhjetë vjeçare. Kjo është një etapë, ku fatntazia e tij krijon përfytyrimin për atë baba kreshnik, i cili ka në gjoks një zemër prej dragoi; të babait, me heroizmat dhe trimëritë e të cilit lavdërohen të tjerët. Ai është një burrë që i kundërvihet shtetit, megjithëse i vockël në krahasim me shtetin e fuqishëm. Ky përfytyrim për babanë kreshnik dhe të ndryshëm sa vjen e rritet në fantazinë e fëmijës, si një formë kompensimi për mungesën e babait. Në krahasim me fëmijët e tjerë, që jetonin nën kujdesin dhe mbrojtjen e baballarëve të tyre, Omeri kishte një baba ndryshe. Ky ndryshim krijon krenarinë e fëmijës, megjithëse është i detyruar të jetojë si të ishte një bonjak. Kur Omeri mësoi se babai i tij ishte në burg, iu ndez fantazia dhe vendosi që burgu të bëhet edhe fati i tij.

Burgu nuk është vetëm katër mure, por edhe ëndërrime e mendime.

Por një ngjarje rutinë do ta shkatërronte fëmijën. Kur, bashkë me nënën, vizitoi në burg, babain e tij, Oso Hutën, në moshën dymbëdhjetë vjeçare, ai zbuloi re se i ati s'ishte siç e kishte përfytyruar, por një burrë i dobët dhe i pafuqishëm, i poshtëruar deri në thellësi të shpirtit. Osoja qan dhe përqafon djalin e tij, Omerin, i cili, nga ana e vet, ndjen neveri për babanë e tij të drobitur. I shpërthejnë lotët dhe ikën prej tij, për të paralajmëruar, vite më vonë, djalin e tij, Bardhylin se, nëse do binte në burg, ai nuk do shkonte ta shihte atje.

Siç vepron fantazia në jetën e fëmijës, po kështu vepron ajo edhe tek i burgosurit, i cili, në librin e dytë të romanit, është vet Bardhyli. Ai ra në burgun shqiptar pasi vendi u bë Republikë Popullore Socialiste. Bardhyli rikthen jetën e gjyshit të vet pas gjashtëdhjetë vjetëve. Pas njëmbëdhjetë muajsh brenda në burg, ai ka drojë të takojë gruan e tij, Lindën. Fantazia e tij seksuale përflaket kur mendon për një takim me gruan e tij të ligjshme. Por dy paralajmërime: njëri prej shokut të tij në burg, që sheh se ai po shkon në takimin e premtuar dhe i thotë:" O i gëzuar! Mos u gëzo"! dhe tjetri, që i erdhi nga gardiani, i cili i tha: "Mbaje gozhdë në tru", ia vranë fantazinë.

Ëndrrat poetike të të burgosurit shndërrohen kështu në një lloj holuçinacioni, që vërshon gjatë gjithë kohës së takimit me gruan e tij. Ai torturohet nga dyshimi se, bashkë me ta, nëpërmjet mikrofonëve të përgjimit, në dhomën e posaçme të takimeve intime brenda burgut, të jetë i pranishëm, është edhe polici, bartësi i uniformës ushtarake, gjë që e pengon të sillet normalisht me gruan e tij. Plus frikëra të tjera, që vërshonin me ngulm në trurin e tij, si ajo për Lindën, humbja e besimit në vetvete si dhe ajo miza, që i gumëzhinte vazhdimisht ne vrimën e veshit. Të gjitha këto e shpartalluan afrimin e Bardhylit me gruan. Gjatë përçartjeve dhe rrethanave të tij pasqyrohet sa e madhe është dhuna, që aplikon shteti kundër armiqve të vet. Kjo e bën Bardhylin të mendojë se ajo dhomë takimesh ishte përgatitur për takimin e babait me gjyshin e tij dhe për takimin e atij vet me gruan e tij. Por ajo tashmë ua kalon pajisjeve të tortures në burg. Kjo, sepse i burgosuri e kupton dhimbjen që e ka pllakosur, duke shkatërruar, në mënyrë të pandreqshme, përfytyrimin e vjetër për të dashurit e tij.

Në librin e tretë të romanit "Një sagë e vogël burgu" ngjarjet zhvillohet jashtë tij. Për lexuesin bëhet e qartë se i gjithë romani shtjellohet rreth detyrës dhe përgjegjësisë. Shkrimtari tregon historinë e tre shembujve, që e japin këtë preambulë para botës. Kjo, sepse pas largimit të italianëve dhe në pritje të pushtimit të Shqipërisë nga gjermanët, organet e shtetit ishin inekzistente. Por si gazetari, si gardiani dhe ushtaraku i dalë në pension mbeten besnik të përgjegjësive të tyre. Secili prej të treve është shembull i njeriut, të cilin e burgosin përgjegjësitë e tij. Burgu nuk është vetëm në kështjellë, por edhe në veprimet, që njerëzit kryejnë gjatë jetës së tyre.

Shpërbërja e eksperiencës së burgut nuk do të thotë se njeriu del prej tij i shëruar.

Linda tregon historinë e gjyshit të saj, Hiqmet Hidit, me qëllim që të kuptojë kompleksin e nënës së saj për burgun, pasi ajo refuzoi martesën e vajzës së saj me Bardhylin. Ajo deshi ta martojë atë në një vend, ku s'kishte burg politik. Linda arrin tek historia e gjyshit: në kohën, kur italianët largohen, të burgosurit ikin nga kalaja-burg, duke marrë me vete gardianët, me qëllim që t'i ndëshkonin për keqtrajtimin, që u kishin bërë. Por ata e lënë Hiqmet Hidin të lirë, sepse ai kishte qenë i mëshirshëm me ta. Në pritje të udhëheqësve të rinj të Shqipërisë, gardiani Hidi mbledh gurë dhe i vendos nëpër biruca. Për këtë ai konsiderohet i çmendur, që bën me turp gruan dhe vajzën e tij, nënën e Lindës. Kjo pas një thashethemi, sipas të cilit, ai do i arrestonte të dyja ato për të bërë një burg të vërtetë me njerëz të burgosur.

Në roman jepen shumë përshkrime rreth çasteve të fundit të Hiqmet Hidit në burg, para se t'i dorëzohej vendimi. Në vend të dhunës shtetërore, romani zbulon një lloj tjetër dhune: dhunën e njerëzve. Në pjesën e fundit jepet historia e një gazetari pa gazetë, e një luftëtari pa ushtri dhe e një gardiani të mbetur pa burg. Në këto shembuj, që jetojnë me një punë në boshllëk, rrjedh shakaja e njerëzve, pas të cilës fshihet poshtërsia e tyre. Në pritje të ardhjes së gjermanëve, përballë egërsisë së njerëzve dhe dhunës së tyre, që vijnë si pasojë e përvojave të këqija lidhur me aparatin shtetëror, mbeten pikëpyetjet e të çmendurit për përfundimin e diktaturës.

Nga errësira e burgut, vend i mbyllur, i cili përbën një laborator të pasur për çdo shkrimtar, Besnik Mustafaj transmeton pikëpyetjet për burgun, në mes të mureve të kalasë, tek të gjithë llojet e tjerë të burgjeve, duke filluar nga përfytyrimet e personazheve për veten e tyre dhe për të tjerët e duke përfunduar tek përfytyrimet e ndryshme rreth burgut, që kanë të tjerët në mejdisin shoqëror, si dhe për arbitraritetin e tyre në fatin e personit. Ndërsa terrina e egër e burgut e merr errësirën e saj nga lidhjet që ka me mendimin dhe nga shkatërrimi që i bën presioni nga brënda.

Somer Shahade, i lindur në Latakije, qytet kryesor në bregdetin sirian, më 1989, vlerësohet si njëri nga shkrimtarët më të rëndësishëm të letërsisë së sotme arabe. Ai bëri emër qysh me romanin e parë "Fushat e misrit" (2016) për të cilin mori Çmimin El-Tajib Saleh në Hartum. Me romanin e dytë "Ndarje"(2019) mori Çmimin Nagib Mahfuz në Kajro. Artikulli u përkthye në shqip nga Sulejman Tomçini.

LEKSION PËR STUDENTËT E ARTIT

Oscar Wilde

Në leksionin që e kam për privilegj që ta mbaj para jush sonte unë nuk dëshiroj që t'ju jap ndonjë përkufizim abstrakt të së bukurës, përgjithësisht. Sepse ne që punojmë në fushat e artit, s'mund të pranojmë ndonjë teori të së bukurës në shkëmbim të vetë të së bukurës, dhe duke qenë shumë larg nga dëshira për ta izoluar atë në një formulë duke thirrur intelektin, ne, përkundrazi, kërkojmë ta materializojmë atë në një formë që i jep gëzim shpirtit me anën e ndjenjave. Ne duam ta krijojmë atë, jo ta përcaktojmë atë. Përkufizimi duhet të ndjekë veprën: vepra nuk duhet të përshtatë vetveten sipas përkufizimit.

Në të vërtetë, asgjë nuk është më e rrezikshme për artistin e ri se ndonjë konceptim i bukurisë ideale: ai është tërhequr vazhdimisht prej saj ose në bukurinë e dobët ose në abstraksionin e pajetë: ndërsa për të prekur idealin përgjithësisht ju nuk duhet ti rripni asaj vitalitetin. Ju duhet ta gjeni atë në jetë dhe ta rikrijoni në art.

Atëherë, ndërsa, në njërën anë unë nuk dëshiroj t'ju jap juve ndonjë filozofi të bukurisë, (sepse, ajo që dëshiroj sonte është të hetoj sesi ne mund të krijojmë art, jo sesi ne mund të flasim për të), në anën tjetër unë nuk dëshiroj të merrem me ndonjë gjë si për shembull historia e artit anglez.

Sa për të filluar, një shprehje e tillë si arti anglez është një shprehje pa kurrfarë kuptimi. Dikush, njëlloj, duhej të fliste gjithashtu për matematikën angleze. Arti është shkenca e së bukurës, dhe matematika shkenca e së vërtetës: nuk ekziston shkollë nacionale e ndonjërës prej tyre. Në realitet, një shkollë nacionale është vetëm një shkollë provinciale. Madje nuk ekziston as ndonjë gjë e tillë si një shkollë arti. Ekzistojnë vetëm artistë; kjo është e gjitha.

Dhe për sa i përket historive të artit, ato janë krejt të pavlera për ju, po të mos jeni duke kërkuar harresën spitullaqe të ndonjë profesoriati arti. Nuk ka vlerë për ju të dini datën e Perugino-s ose vendlindjen e Salvator Rosa-s: gjithçka që duhet të mësoni rreth artit është të dalloni një pikturë të mirë, kur e shihni atë, nga një pikturë e keqe, kur e shihni gjithashtu. Për sa i përket kohës së artistit, të gjitha veprat e mira duken përpiktazi moderne: një pjesë e një skulpture greke, një portret nga Velasquez – janë gjithmonë moderne, gjithmonë i përkasin kohës sonë. Dhe për sa i përket nacionalitetit të artistit, arti nuk është nacional por universal. Pastaj, në lidhje me arkeologjinë shmangeni atë plotësisht: arkeologjia është vetëm shkenca e krijimit të shfajësimeve për artin e keq; ajo është shkëmbi në të cilin shumë artistë të rinj mbyten dhe shkatërrohen; ajo është humnera nga e cila asnjë artist, i vjetër apo i ri, nuk kthehet kurrë. Ose, nëse ai kthehet, është kaq i mbuluar me pluhurin e epokave dhe me mykun e kohërave, saqë ai është krejt i panjohur si një artist, dhe duhet ta fshehë veten për ditët që i kanë mbetur nën kapelën e një profesori ose vetëm si një ilustrator i historisë së lashtësisë. Sa e pavlerë është arkeologjia në art ju mund ta vlerësoni nga fakti e të qenit të saj shumë popullore. Popullariteti është kurora e dafinave të cilën bota e vendos mbi artin e keq. Çfarëdo që është popullore është gjë e gabuar.

Atëherë, pasi unë nuk do t'ju flas rreth filozofisë të së bukurës, ose rreth historisë së artit, ju do të pyesni se për çfarë do të flas sot. Subjekti i leksionit tim sot është ajo çka e bën artistin dhe ajo çka një artist bën; cilat janë marrëdhëniet e artistit me ato që e rrethojnë, cili është edukimi që artisti duhet të marrë dhe çfarë është cilësia e një vepre të mirë arti.

Tanimë, për sa i përket marrëdhënieve të artistit me ato që e rrethojnë, me të cilat unë nënkuptoj epokën dhe vendin në të cilin ai ka lindur. I gjithë arti i mirë, siç e kam thënë dhe më përpara, nuk ka të bëjë fare me ndonjë shekull të veçantë; por ky universialitet është cilësia e veprës së artit; kushtet që e prodhojnë këtë cilësi janë të ndryshme. Mendoj se ajo që ju duhet të bëni është që të kuptoni plotësisht epokën tuaj, me qëllim që të largoheni plotësisht prej saj; duke kujtuar që ju nëse, në fund të fundit, jeni një artist, ju nuk do të jeni tellalli i një shekulli, por mjeshtri i përjetësisë, që gjithë arti mbështetet në një princip dhe që vetëm konsideratat e përkohshme,në fund të fundit, nuk janë principe, që ata të cilët ju këshillojnë që ta bëni artin tuaj një përfaqësues të shekullit të nëntëmbëdhjetë po ju këshillojnë të prodhoni një art të cilin fëmijët tuaj do ta quajnë të vjetruar. Por ju do të më thoni që kjo është një epokë jo artistike, që ne jemi një popull jo artistik dhe që artisti vuan shumë në këtë shekullin tonë të nëntëmbëdhjetë.

Sigurisht që vuan. Unë, përkundër gjithë njerëzve, nuk do ta mohoj këtë. Por, sillni ndërmend që kurrë nuk ka ekzistuar një epokë artistike, ose popull artistik që nga fillimet e botës. Artisti ka qenë dhe do të jetë gjithmonë një përjashtim i mrekullueshëm. Nuk ekziston epokë e artë për artin; ekzistojnë vetëm artistë të cilët kanë krijuar atë që është më e artë se sa ari.

Çfarë? Ju do të më thoni mua: – Grekët? A nuk ishin ata një popull artistik?

Mirë pra, grekët sigurisht nuk ishin, por, ndoshta, ju kini parasysh athinasit, qytetarët e njërit prej njëmijë qyteteve.

A mendoni ju që ata ishin një popull artistik? Le t'i marrim ata në kohën e zhvillimit të tyre më të lartë artistik, në pjesën e dytë të shekullit të pestë para Krishtit, kur ata kishin poetët më të mëdhenj dhe artistët me të mëdhenj të botës antike, kur Parthenon-i çohej në harmoni sipas urdhrave të Fidias, kur filozofi fliste për urtinë në hijen e një portiku të pikturuar, dhe tragjedia shtrihej në përkryerjen e procesionit dhe në patosin përmes mermereve të skenës. Atëherë, a nuk ishin ata një popull artistik? Aspak. Çfarë është një popull artistik përveçse një popull që i do artistët e vet dhe që e kupton artin e tyre? Athinasit nuk mund të bënin asnjërën.

Po si e trajtuan ata Fidian? Fidias ne i detyrohemi për epokën madhështore, jo vetëm në artin grek, por në të gjithë artin – ku unë nënkuptoj fillimin e përdorimit të modelit të gjallë.

Dhe çfarë do të thoshit ju nëse të gjithë peshkopët anglezë të ndjekur nga populli anglez zbrisnin nga Exter Hall-i drejt Royal Academy, një ditë prej ditësh, dhe përcillnin Sër Frederick Leighton me një karrocë burgu në Newgate me fajësimin se ju ka lejuar të përdorni modele të gjalla në projektet tuaja për pikturat e shenjta?

A nuk do të bërtisnit me zë të lartë kundër barbarizmit dhe puritanizmit të një ideje të tillë? A nuk do t'u shpjegonit atyre që mënyra më e keqe për të nderuar Zotin është të çnderoni njeriun i cili është i bërë sipas imazhit të Tij dhe është vepër e duarve të Tij; a nuk do t'u shpjegonit që nëse dikush dëshiron të pikturojë Krishtin ai duhet të gjejë personin më të ngjashëm me Krishtin që mund të gjendet dhe nëse dikush dëshiron të pikturojë Zojën mund të gjejë vajzën më të dlirë që njeh ai?

A nuk do të vërsuleshit dhe do të bënit shkrumb e hi Newgate-in, nëse është e domosdoshme, dhe të thoni që një gjë e tillë është pa paralel në histori?

Pa paralel? Po pra, kjo është pikërisht ajo që bënë athinasit.

Në dhomën e mermereve të Parthenon-it, në Muzeun Britanik, ju do të shihni një mburojë mermeri në mur. Mbi të janë dy figura; ajo e një burri fytyra e të cilit është e fshehur përgjysmë, tjetra e një burri me tiparet hyjnore të Perikliut. Vetëm për realizimin e saj, për paraqitjen në një basoreliev, të marrë nga historia e shenjtë greke, të imazhit të burrit të madh të shtetit i cili qeveriste Athinën aso kohe, Fidia u plas në qeli dhe atje, në burgun publik të Athinës, vdiq artisti suprem i botës së vjetër.

Dhe ju mendoni që kjo ishte rast i veçantë? Shenja e një epoke filistinase është ulërima imoralitetit drejtuar kundër artit, dhe kjo ulërimë u ngrit nga populli athinas kundër çdo poeti të madh apo mendimtari të kohëve të tyre – Eskilit, Euripidit, Sokratit. Ishte e njëjta gjë me Firencen e shekullit të trembëdhjetë. Artet e mira të dorës janë të përshtatshme për esnafët jo për popullin. Në momentin që esnafët e humbën fuqinë e tyre dhe populli vërshoi brenda, bukuria dhe ndershmëria e veprës vdiq.

Dhe kështu, kurrë mos fol për një popull artistik; kurrë nuk ka ekzistuar një gjë e tillë.

Por, ndoshta, ju do të më tregoni mua që bukuria e jashtme e botës është zhdukur thuajse plotësisht nga ne, që artisti nuk banon më në mes të rrethinave të hirshme të cilat, në epokat e shkuara, ishin trashëgimia natyrale e çdonjërit dhe që arti është shumë i vështirë në qytezën tonë të pahirshme, ku, pasi shkoni në punën tuaj në mëngjes ose pasi ktheheni prej saj mbrëmjeve, ju duhet të kaloni nga rruga në rrugë nëpër arkitekturën më budallaqe e më të marrë që ka parë bota ndonjëherë; arkitekturë ku çdo formë e këndshme greke është shprishur e dhunuar, ku çdo formë e këndshme gotike është shprishur e dhunuar, duke reduktuar tre të katërtat e shtëpive të Londrës tek të qenit vetëm si kuti katrore të proporcioneve më të poshtra, aq të ronitura sa dhe të tymosura, aq të varfra sa dhe pretendimet e tyre – dera e hollit gjithnjë në ngjyrën e gabuar dhe dritaret në përmasa të gabuara dhe ku, (madje kur ju të lodhur prej shtëpive ktheheni për të soditur vetë rrugën), nuk keni asgjë për të parë përveç mbulesave të oxhakëve, njerëzve me pako sanduiçi, kutive postare të kuqe dhe e bëni madje këtë me rrezikun e të shtypurit prej një omnibusi ngjyrë smeraldi.

A nuk është arti i vështirë, do të më thoni mua, në rrethina të tilla si këto? Sigurisht është i vështirë, por arti nuk ishte asnjëherë i lehtë; ju vetë nuk do të dëshironit të ishte i lehtë; dhe, përveç kësaj, asgjë nuk e ka vlerën e të bërit përjashto atë që bota e quan të pamundur.

Por, ju nuk çani kokë të merrni përgjigje vetëm nga një paradoks. Cilat janë marrëdhëniet e artistit me botën e jashtme, dhe cili është rezultati i humbjes të rrethinave të bukura për ju, është një nga çështjet më të rëndësishme të artit modern; dhe nuk ekziston pikë mbi të cilën Z. Ruskin këmbëngul në mënyrë të tillë që dekadenca e artit ka rrjedhur nga dekadenca e gjërave të bukura; dhe që kur artisti nuk mund të ushqejë sytë e tij me të bukurën, e bukura largohet nga vepra e tij.

Unë kujtoj se në një nga leksionet e tij, pas përshkrimit të pamjes së ndyrë së një qyteti të madh anglez, ai vizaton për ne një pikturë të asaj çka kanë qenë rrethinat artistike shumë kohë më parë.

Mendoni, thotë ai, me fjalët e imagjinatës perfekte, piktorike, bukurinë e të cilave unë mund ta imitoj vetëm paksa, mendoni se çfarë ishte skena e cila prezantohej, në shëtitjen e tij pasditeve, para një modeluesi të shkollës gotike të Pizës – para Nino Pisano-s ose ndonjërit prej pasuesve të tij:

Në secilën anë të një lumi të kthjellët ai shihte një vijë pallatesh më të shndritshme akoma, me harqe dhe me shtylla si dhe të shtruara me porfir në të kuqe të thellë e me serpentinë; përgjatë molit para portave të tyre kalëronin trupa kalorësish, fisnikë në pamje dhe në formë, verbues në kreshtë dhe në mburojë; kali dhe njeriu një labirinth ngjyre më vete dhe drite reflektuese – thekët e purpurt, e argjendtë dhe të ngjyrë alli duke rrjedhur mbi gjymtyrët e forta dhe mbi rrugën ushtuese, si dallgë deti mbi shkëmbinjtë në perëndim. Duke u hapur mbi secilën anë të lumit kishte kopshte, oborre dhe manastire; vargje të gjata kolonash të bardha midis kurorave të hardhive; ngritja e shatërvanëve nëpër gonxhet e shegëve dhe portokallëve: dhe ende përgjatë rrugëzave të kopshteve, nën të kuqen dhe midis të kuqes së hijeve të shegëve, duke lëvizur ngadalë, grupet e grave më të dlira që Italia kish parë ndonjëherë – më të dlira sepse ishin më të pastrat dhe më të mençurat; të edukuara me dijet më të larta si dhe në gjithë artin oborrtar – në vallëzim, në këngë, në zgjuarsinë e ëmbël, në nxënien e lartë, në kurajën më të lartë, në dashurinë më të lartë – të afta njëlloj të mbushin me gëzim, të magjepsin apo të mbrojnë shpirtrat e burrave. Përmbi gjithë këtë peizazh të jetës të përkryer njerëzore, çohej kupola dhe kulla e kambanës të ndezura nga alabastri i bardhë dhe ari: përtej kupolës dhe kullës së kambanës shpatet e kodrave të gjera zbardhonin nga ngjyra e degëve të ullinjve; larg kah veriu, përmbi një det të purpurt të majave të rënda të Apenineve, malet e kthjellëta, shpatet e mprehta të Carrara-s lartësonin flakët e tyre të palëkundshme të majave të mermerta në qiellin e qelibartë; vetë deti madhështor, duke u djegur me hapësirën e dritës, shtrihej nga këmbët e tyre deri tek ishujt Gorgonianë; e përmbi të gjitha këto, gjithnjë i pranishëm, afër apo larg (i parë midis gjetheve të hardhive, i imagjinuar me gjithë marshimin e tij reve në rrjedhën e Arno-s, apo i vendosur me thellësirën e blusë ngjitur, përkundrejt flokëve të arta dhe fytyrës përvëlonjëse të zojes dhe kalorësit), ai qiell i pashqetësuar dhe i shenjtëruar, i cili ishte tek të gjithë njerëzit, në ato ditë të besimit të pafaj, vërtet vendbanimi i padiskutueshëm i shpirtrave, njëlloj siç ish toka e njerëzve; dhe i cili hapej drejtpërdrejt nëpërmjet portave të reve dhe velit të vesës në brendësi të madhështisë të botës së përjetshme; – një qiell parajsor në të cilin çdo re që kalonte ishte me të vërtetë koçi e një engjëlli, dhe çdo rreze e mbrëmjes dhe e mëngjesit të vet derdhej prej fronit të Zotit.

A mendoni ju atë si një shkollë dizajni?

Pastaj shikoni në pamjen e mërzitshme, monotone të ndonjë qyteti modern, në veshjet e zymta të burrave dhe grave, në arkitekturën e pakuptimtë dhe të pavlerë, në rrethinat e pangjyra dhe të frikshme. Pa një jetë të bukur nacionale, jo vetëm skulptura, por të gjitha artet do të vdesin.

Mirë, për sa i përket ndjenjës religjioze të mbylljes së pasazhit, unë nuk mendoj se kam nevojë që të flas rreth saj. Religjioni buron nga ndjenja religjioze, arti nga ndjenja artistike: ju kurrë nuk e ngatërroni njërën me tjetrën; po të mos keni mbjellë rrënjën e duhur nuk keni për të marrë lulen që prisni; dhe, nëse një njeri sheh në një re koçinë e një engjëlli, ai ndoshta do ta pikturojë atë krejt ndryshe nga një re.

Por, për sa i përket idesë së përgjithshme të pjesës më të parë të kësaj pjese të këndshme proze, a është realisht e vërtetë që rrethinat e bukura janë të nevojshme për artistin? Mendoj se jo; jam më se i sigurt që jo. Në të vërtetë, për mua gjëja më jo artistike, në këtë epokën tonë, nuk është indiferenca e publikut ndaj gjërave të bukura, por indiferenca e artistit ndaj gjërave që quhen të shëmtuara. Sepse, për artistin e vërtetë, përgjithësisht, asgjë nuk është e bukur ose e shëmtuar në vetvete. Me realitetet e objektit ai nuk ka të bëjë fare, por ka të bëjë vetëm me dukjen e tij, dhe dukja është një çështje e dritës dhe e hijes, e masave, e pozicionit dhe e vlerës.

Dukja është, në fakt, vetëm një çështje e efektit; ju keni të bëni me efektet e natyrës dhe jo me gjendjen reale të objektit. Ato që ju duhet të pikturoni si piktorë nuk janë sendet ashtu siç janë, por sendet ashtu siç duken se janë; jo sendet ashtu siç janë, por sendet ashtu siç nuk janë.

Asnjë objekt nuk është kaq i shëmtuar sa, në disa kushte të dritës dhe hijes, apo në shoqërim të objekteve të tjera, të mos duket i bukur; asnjë objekt nuk është kaq i bukur sa, në disa kushte, të mos duket i shëmtuar. Besoj që në çdo njëzet e katër orë ajo që është e bukur duket e shëmtuar dhe ajo që është e shëmtuar duket e bukur, të paktën njëherë.

Dhe karakteri i rëndomtë në një masë të madhe në pikturën tonë angleze më duket për shkak të faktit që shumë nga artistët tanë të rinj shikojnë vetëm drejt asaj që ne mund ta quajmë "bukuri e gatshme", ndërsa ju ekzistoni si artistë që të mos e kopjoni të bukurën por ta krijoni atë në artin tuaj, të prisni dhe të vëzhgoni për të në natyrë.

Çfarë do të thoshit për një dramaturg i cili nuk do të vendoste në dramën e tij askënd si karakter përveçse njerëz të virtytshëm? A nuk do të thoshit ju që atij i mungonte gjysma e jetës? Kështu që për artistin e ri i cili nuk pikturon gjë tjetër veç gjërave të bukura, unë do të them që i mungon gjysma e botës.

Mos prisni që jeta të jetë piktorike, por përpiquni ta shihni jetën në gjendje piktorike. Këto gjendje ju mund t'i krijoni për veten tuaj në studio, sepse ato s'janë veçse gjendje të ndriçimit. Në natyrë ju mund të prisni për to, të kërkoni për to, t'i zgjidhni ato dhe, nëse ju prisni dhe shikoni, ato do të vijnë.

Natën, në Gower Street, ju mund të shihni një kuti postare që është piktorike: mbi argjinaturën e Thames-it ju mund të shihni policë piktorikë. Madje as Venecia nuk është gjithnjë e bukur, po kështu edhe Franca.

Të pikturosh atë që sheh është një rregull i mirë në art, por të shohësh atë që ja vlen të pikturohet është një gjë shumë më e mirë. Shiheni jetën në gjendje piktorike. Është më mirë të jetosh në një qytet me mot të ndryshueshëm sesa në një qytet me rrethina të këndshme.

Tani, duke parë se çfarë e krijon artistin dhe çfarë artisti krijon, kush është artisti? Është një njeri që jeton midis nesh i cili përmbledh në vetvete të gjitha cilësitë e artit më fisnik, vepra e të cilit është një gëzim për gjitha kohërat, i cili është, vetëm ai, një mjeshtër i të gjitha kohërave. Një njeri i tillë është Z. Whistler.

* * *

Por, do të thoni ju, veshjet moderne, kjo është një gjë e keqe. Nëse ju s'mund të pikturoni një rrobë të zezë atëherë nuk mund të pikturoni jelekun e mëndafshtë. Veshja e shëmtuar është më e mirë për artin – fakte të të dukurit, jo të objektit.

Çfarë është një pikturë? Së pari, një pikturë është një sipërfaqe e ngjyrosur bukur, thjesht, me një mesazh ose kuptim spiritual për ju jo më të madh sesa një fragment pikant i qelqit Venecian ose një pllakë blu nga muri i Damaskut. Ajo është, së pari, një gjë e pastër dekorative, një kënaqësi kur e sheh.

Të gjitha pikturat arkeologjike që ju bëjnë të thoni "Sa e çuditshme!", të gjitha pikturat sentimentale që ju bëjnë të thoni "Sa e trishtë!", të gjitha pikturat historike që ju bëjnë të thoni "Sa interesante!", të gjitha pikturat që nuk ju japin menjëherë një gëzim të tillë artistik që t'ju bëjnë të thoni "Sa e bukur!", janë piktura të këqija.

* * *

Ne kurrë nuk e dimë se ç'do të bëjë një artist. Sigurisht që jo. Artisti nuk është një specialist. Të gjitha ndarjet e tilla si piktorë kafshësh, piktorë peizazhi, piktorë të lopëve skoceze në një mjegull angleze, piktorë të lopëve angleze në një mjegull skoceze, piktorë të kuajve të garave, piktorë të bulldogut gjuetar, të gjitha janë të përcipta. Nëse një njeri është artist ai mund të pikturojë çdo gjë.

Objekti i artit është të gjallërojë më hyjnoren dhe më të largëtën e kordave që krijojnë muzikën në shpirtin tonë; dhe ngjyra është sigurisht, nga vetvetja një prezencë mistike brenda sendeve dhe toni një lloj i rojës.

A jam duke kërkuar, atëherë, për teknikën e thjeshtë? Jo. Për aq kohë sa ekzistojnë disa shenja të teknikës në tërësi, piktura është e papërfunduar. Po çfarë është të përfunduarit? Një pikturë është e përfunduar kur të gjitha gjurmët e punimit dhe të mjeteve të përdorura për të shkaktuar rezultatin, të jenë zhdukur.

Në rastin e artizanit – e endësit, poçarit, farkëtarit – në punën e tyre ekzistojnë gjurmët e duarve të tyre. Por kjo nuk ndodh me piktorin, kjo nuk ndodh me artistin.

Arti nuk duhet të ketë ndjenjë rreth tij, përveç bukurisë së tij; asnjë teknikë përveç asaj që ju nuk mund ta vëzhgoni. Dikush duhet të jetë i aftë të thotë për një pikturë jo që ajo është "e pikturuar mirë", por që ajo "s'është e pikturuar".

Çfarë diference ka midis artit absolutisht dekorativ dhe një pikture? Arti dekorativ e thekson materialin e tij: arti imagjinativ e mohon atë. Tapiceria tregon fijet e saj si pjesë e bukurisë së vet: një pikturë e mohon kanavacën e vet: ajo nuk tregon asgjë prej saj. Porcelani e thekson glazurën e tij: akuarelet e mohon letrën.

Një pikturë nuk ka kuptim, përveç bukurisë të saj; nuk ka mesazh përveç gëzimit të saj. Kjo është e vërteta e parë rreth artit që ju kurrë nuk duhet ta humbisni nga sytë. Një pikturë është një gjë thjeshtësisht dekorative.

Përktheu nga origjinali: Neli NAÇO

Romani "Marrja e gjakut" nga Andreas Dushi, "Onufri", 2018

ABSURDI I QENIESIMIT – BACK TO THE ROOTS

Ballsor Hoxha

Autori i romanit "Marrja e gjakut" është krejtësisht i vetëdijshëm për pragmatizimin e leximit sot, për pragmatizimin e rrëfimit, e qoftë edhe të pragmatizimit të – ëndrrës mashtruese – letërsi! Në paragrafin hyrës të këtij romani lexuesi ngacmohet dhe vëmendësohet se nuk do të ketë mëshirë ndaj po këtyre pragmatizmave.

Është roman absurdi, roman që me qëllim dhunon excess-in (teprinë) e thurjeve gjuhësore, dhe që me qëllim shuan çfarëdo syzheu, duke krijuar dhe duke dezintegruar skemën e pragmatizmit, përmes revoltës, dhe si besim në letërsinë, origjinalen e saj, dhe në mundësinë e arritjes së saj pavarësisht excess-it gjuhësor!

"Marrja e gjakut" siç edhe thuhet eksplicit brenda tij, nuk është menduar për masa të gjera. Por në shenjë revolte, ky roman, duke kërcënuar vetë besueshmërinë e tij, logjikën e tij, dhe edhe atashimin e lexuesit të tij, qoftë si teknikë e si qëndrim, është guximi për të rikthyer, për të kapur fillin e humbur dhe për të krijuar letërsi, jo nga epshi i megalomanisë, por vetëm dhe vetëm nga ankthi shpirtëror për të rrëfyer, për të – arritur – tjetrin.

Në letërsinë botërore, e tutje në tërë sociologjinë tonë, sot, ka, si në çdo gjë tjetër një konflikt dhe luftë për origjinaren, e aq më shumë për origjinalen. Në të vërtetë është vënë në dyshim nëse ka fare një origjinale, derisa origjinarja, e trajtuar shumë gjerësisht dhe rrënjësisht nga Jacques Derrida, aq sa ky trajtim i tij ka kaluar në krye-rrjedhë (mainstream) të mendimit bashkëkohor, duke bërë që origjinarja të mendohet të jetë vetëm paraardhëse e prezentes e prezencës sonë. Derisa origjinalja të jetë diçka e mbetur prapa primordiales!

Romani "Marrja e gjakut" i Andreas Dushit, autor i ri në moshë, vetëm 19 vjeç kur e ka shkruar romanin në fjalë, është pikërisht rrëfim në vorbullën e këtij konflikti global, mbi letërsinë. dhe tërë sociologjinë tonë bashkëkohore. Pavarësisht, sa i informuar është, apo sa ka qenë i informuar ai për këtë, e që është bukur e dukshme në romanin e tij, rrëfimi të cilin e thurë është krejtësisht – origjinal – apo thënë ndryshe, sipas skemës së krye-rrjedhës së mendimit bashkëkohor, romani i Dushit është krejtësisht burues (burimor). Në temë, në përmbajte e sidomos në teknikën e rrëfimit të Dushit në këtë roman.

Sigurisht, kjo nuk është përpjekja e vetme në letërsinë tonë, sa i përket origjinares/origjinales, romani "Marrja e gjakut" qysh në faqet e para të kujton romanet e Mehmet Krajës, siç është një inicim krejtësisht unik dhe i një-linjeje. Apo thënë ndryshe, ky rrëfim mblidhet e përmblidhet sikur pikat e shpërhapura të shiut, në një liqe të tërë ndërthurjeje. Sigurisht, po i njëjti rrëfim dhe teknika e tij përmban edhe – gof – in Pashkian, e që aq më shumë përmban edhe gjurmët e Pashkut me emrat si Lulashi, pastaj derivimet e personave në devijimin e të njëjtit emër si tek Pashku, siç janë personazhet Lulashi, Laloshi etj; dhe po ashtu edhe hetimin linear, megjithëse imagjinar, të Dushit në këtë rrëfim, përkundër hetimit tek Breznitë e Hankonatëve të Kadaresë.

Në një mënyrë rrëfimi i romanit "Marrja e gjakut" fillon nga asgjë, nga asnjë rrjedhë dhe asnjë ngjarje, dhe krejtësisht në një mono-ritëm, duke krijuar vadën dhe rrjedhën e tij, e cila, sikur rrjedhë e pikave të shiut krijojnë një liqe të tërë. Nga një Voc, personazh në roman, dalin fëmijët e tij, gratë, absurdi shqiptarë i gjakmarrjes e deri tek shpërndërrimi i narrativeve, qoftë globale, e qoftë atyre të mishëruara në kolektivin tonë, p.sh. përmes religjioneve.

Por aq më shumë duke pasur për bosht qendror motivin, origjinaren dhe origjinalen, imagjinare gjithnjë, të gjakmarrjes. Derisa arrijmë në një absurd krejtësisht unik të Dushit, ku gjakmarrja, apo obligimi i gjakmarrjes lind për shkak të vetëvrasjes së personazhit të Vocit, gjak, të cilin, duhet nxjerrë vetë djemtë e tij ndaj po ashtu pjesës tjetër të djemve të tij, për shkak se konsiderohet se po kjo vetëvrasje e Vocit është edhe gjak i rënë në shtëpinë e tyre, në tërë absurdin e kësaj.

Në të vërtetë, Dushi, në parodi e absurd, imiton burimin, gjenezën dhe shkakoren e kësaj rrjedhe të këtyre masave të rrëfimit të tij, pra të një kolektivi të tërë, apo thënë më saktë të tërë shqiptares. Sigurisht, ky nuk është ankth, apo tension ankthi brenda këtij rrëfimi, përkundrazi ai është një shurdhërimë dhe hapërim nëpër absurdin e saj.

Nëse thellohemi më tuje në këtë mono-ritëm të këtij rrëfimi, të thurur me vetëdije të plotë të këtij autori, lehtë mund të hasim në atë lirinë krejtësisht primordiale të njeriut e kolektivit të njeriut para Publikes, para konstruksioneve shoqërore, prej gjuhës e deri tek vetëdija, d.m.th të vetë paradigmës së njerëzores, apo të vetë shoqërisë sonë, kolektivit tonë lidhur me mitin tonë identifikuaes, një prej tyre në të vërtetë, e që është ai i sakrificës, Rozafatit.

Në të vërtetë, kjo paradigmë ka edhe fragmentin e tij të gjuhës (Blanchot) – cica jashtë – që me gjithë vulgaren dhe brutalen e tij, ky fragment i zhveshur shënjon para-gjuhën, para Publiken e para-kompleksin e vetëdijes dhe normës.

Në të vërtetë ky fragment përmban tërë revoltën e letërsisë ndaj vetë dhunimit të saj, qoftë duke e kaluar po të njëjtën në commodity (mall), e qoftë duke e kaluar po të njëjtën në 'gjendje lehtësimi'. Siç janë shpikjet bashkëkohore për trullosje!!

Por, mbi të gjitha, Andreas Dushi është përfaqësues i letërsisë bashkëkohore, të gjeneratës në maturim e sipër, të letërsisë më të re shqiptare, andaj është tejet me rëndësi të lexohet e të vëzhgohet, si autor serioz e si bartës i po të njëjtave konflikte të lartpërmendura, si për sa i përket konfliktit mbi origjinalen dhe bashkëkohoren, e po ashtu edhe sa i përket revoltës autoriale, të letërsisë serioze ndaj shpërdorimit të vetë saj.

Fillimi i romanit "Marrja e gjakut"

Ndoshta çfarë do të tregoj mund të duket e çuditshme, prandaj të lutem, nëse nuk mund të pranosh diçka të çuditshme, mos lexo më tej. Nëse e di dhe e ndjen se mundesh, je i ftuar që bashkë me mua të mësosh historinë jo shumë të zakontë të familjes së Vocit, të *zotit* të saj, emrin e të cilit mban. Ai është babai i Lekës, Lecit, Laloshit dhe Lulashit, vëllai i Vilzanit dhe bashkëshortit i bukuroshes venedikase Leticia.

Voci, si i zoti i shtëpisë, duhej të kujdesej për të shoqen dhe kalamajtë që kishte me të. Kishte disa vjet, qysh kur prindërit i kishin vdekur, që ishte ndarë nga i vëllai i cili ishte martuar pak kohë më vonë me një grua nga Roma për të cilën thoshin se e kishte motër.

Vendi ku Voci dhe familja e tij jetonin quhej Mali me Tym. Aty nuk ndodhte asgjë. Dhe, për hir të së vërtetës, nuk kishte nga kush të ndodhte diçka, pasi, përveç familjes së Vocit, aty jetonin veç edhe tri familje. Askush nuk vinte as për vizitë e as për dasma (ndonëse rrallëkush e mban mend dasmën e fundit). Veç për morte.

Mali me Tym ruan këtë emër që kur Osmanët pushtuan gjithkah. Gjatë pushtimit, ata mblodhën çdo simbol fetar të krishterë. Të gjithë kryqat e mbledhur i çuan në një mal, vendi i fundit ku depërtuan. Natën kur po festonin, Barbar Pasha u vuri zjarrin dhe sipas gojëdhënës, tymi nga djegia e tyre zgjati për më tepër se tre vjet deri kur Barbar Pasha qe larguar.

Besoj e ke dëgjuar gojëdhënën:

Kur turku vendin mori,
Tan' krygjat n'krah i bori,
E te tanë në t'mbramin mal
I hodhi e i vuni zjarr.
Barbar Pasha, ai çfarë djali,
Me mjekërr sa nji anë mali,
Si kryqave u kalli zjermin,
Qeshi kur ndiu tuj i thirr emnin.
Edhe krygjat si kjenë djegë,
Tan' turqelitë bashk' janë rrekë,
Me ujë zjermin fik e kanë,
Por tymi mbeti në çdo anë.
Kalun dit' e kalun muj',
E ma n'mend s'i ra kërkuj,
Tymi i zi s'prau nji dekik,
E mbloi t'ndritshmin metelik.
Veç kur Pasha u largue,
N'Stamboll shkoi me jetue,
Dikush nji kovë ujë e hodhi,
Tymi iku, dilli doli.

Nuk e ke dëgjuar gojëdhënën? Si ka mundësi? Unë kam menduar se kjo gojëdhënë është shumë popullore. Gabimi im. E pranoj, edhe unë gaboj. Madje më shumë se ti, sado gabimtar të jesh! Ndonëse, fakti që ti nuk e njeh, nuk do të thotë se nuk është popullore. Apo jo?

FILLIMET E MODERNITETIT NË PROZËN ROMANORE SHQIPE

nga Ermir Nika

Sistemi letrar shqiptar dhe zhvillimet e ndryshme brenda tij, nuk e sendërtoi profilin e tij në mënyrë spontane në një rreth vicioz, jashtë procesit të përgjithshëm evolutiv të letërsisë së gjithëmbarshme. Letërsia shqipe, pavarësisht kushteve më të cilat u përball pas Luftës së Dytë Botërore, nuk duhet të vlerësohet si një hallkë e shkëputur nga zhvillimet e letërsisë europiane dhe anasjelltas, letërsia në Europë, në historinë dhe në traditën e saj, nuk do të ishte e plotë pa lëvizjet që u vunë re në letërsinë shqipe. Prirjet që u shfaqën në letërsinë europiane dhe atë botërore, veçanërisht në gjininë e romanit, ku spikati stili lakonik i Ernest Heminguejit i shkrirë në dialogë të drejtpërdrejtë dhe pa ngarkesa autoriale, me anë të së cilave zbulohej gjendja e brendshme e personazheve si edhe me përshkrimet autentike të peizazhit, dha një ndikim të thellë në zhvillimet e mëvonshme të letërsisë që lëvrohej në Europë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Po ashtu, edhe romanet e shkrimtarit të shquar gjerman Erih Maria Remark, të cilat bënë një jehonë të ndjeshme në shtypin gjerman të kohës, duke u shtrirë e duke fituar gjithmonë e më shumë terren edhe ne kontinentin amerikan, në Shqipëri nuk gjetën mishërim thjesht për faktin se në këtë rast kishim të bënim me dy shkrimtarë antifashistë, çka lë shkas të mendohet se një gjë e tillë i shkonte për shtat politikës që ndiqte shteti shqiptar pas ardhjes në fuqi të regjimit komunist. Përkundrazi kjo dukuri letrare, përfshiu krijimtarinë e disa prej shkrimtarëve më në zë të asaj periudhe në Europë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e më gjerë. Padyshim që në këtë proces edhe Shqipëria, përpos kushteve dhe klimës në krijuar në letërsi dhe në art, nuk mund të bënte përjashtim. Në përpjekje për të përvijuar një panoramë të plotë të situatave që mbizotëronin pikërisht në këtë fazë që po përjetonte kultura dhe në veçanti letërsia shqipe, mendojmë se është e udhës të vendosim theksin mbi një tregues shumë sinjifikativ, i cili prek në vija të përgjithshme tiparet kryesore të ardhjes së modernitetit në romanin europian, si dhe, në mënyrë më specifike nxjerr në pah tiparet më përfaqësuese të kësaj dukurie në prozën romanore shqipe. E prirur për të sendërtuar një model letrar krejt të ndryshëm si në art ashtu edhe në letërsi, kjo frymë e re krijuese që në lindje të saj do të përballej me muret e sistemeve diktatoriale dhe do të arrinte të ruante ekzistencën e saj nën presionin shtypës të klikave sunduese të kohës, si në Europë, po ashtu edhe në Shqipëri. Autorët tek të cilët u vu re në mënyrë më të drejtpërdrejtë ky ndikim dhe që përçuan frymën moderniste në prozën romanore shqiptare qenë pikërisht Petro Marko dhe Ismail Kadare, të cilët më talentin dhe me konceptet që zotëronin për artin e shkruar, me mënyrat dhe mjetet shprehëse si në rrafshin stilistikor ashtu edhe në atë gjuhësor, përvijuar pamjen moderne të romanit shqiptar. Ndër të gjithë prozën romanore të shkruar para luftës, vetëm romani "Pse" i Sterjo Spases është parë ndonjëherë si prurje moderniste. Shkruar nga një autor shumë i ri, nën ndikimin e gjithëfarë leximesh, ajo vepër mbeti si një eksperiment i veçuar prej të cilit shkrimtari hoqi dorë në një roman tjetër pasardhës "Afërdita" të botuar para mbarimit të Luftës së Dytë Botërore.

Në atmosferën e përgjithshme që mbizotëronte jo vetëm në botën e letrave por edhe në krejt jetën intelektual dhe kulturore në Shqipërinë e gjysmës së dytë të shekullit XX, botimi i romaneve të Petro Markos "Hasta la vista" dhe në veçanti "Qyteti i fundit" patën një jehonë të ndjeshme në valën e botimeve të asaj kohe, duke u shndërruar në objekt diskutimesh në qarqe të gjera të lexuesve dhe në mënyrë të veçantë në sferat letrare. Po në këtë mënyrë, do të priteshin edhe romanet e para të Kadaresë, ku shtresat e ndryshme të shoqërisë, në mënyrë të veçantë ato intelektuale, do të tregonin një interesim gjithnjë në rritje për këtë dukuri letrare që po përvijohej haptazi në diskordancë të plotë me frymën dhe modelet e gatshme mbi të cilat sendërtohej arti dhe kryesisht letërsia e atyre viteve. Me daljen në dritë të romaneve të Petro Markos, në letërsinë shqipe po përvijohej një fizionomi të re, duke krijuar gradualisht distancë nga letërsia e klisheve dhe e shablloneve me të cilat ishte konturuar krijimtaria letrare e pas çlirimit. Ndërsa do të ishte pikërisht Ismail Kadare ai autor, falë formës së re letrare, stilit dhe frymës së re që përçonte në prozën shqipe, që do të përmbyste krejt raportet që kishte romani shqiptar me të shkuarën. Vepra romanore e Kadaresë që në fillesat e saj, ndihej si një vepër e ndikuar nga letërsia perëndimore, dhe kryesisht nga modelet letrare të Heminguejit dhe të Remarkut, një proces ky që u zhvillua gati nën të njëjtat simptoma dhe përngjashmëri ashtu si në mjaft vende të botës, si në Gjermani, Angli, Shtetet e Bashkuara të Amerikës etj, ku ndikimi i veprës së këtyre dy autorëve në procesin krijues, veçanërisht në gjininë e prozës ishte mjaft evident. Me kalimin e kohës, proza romanore shqipe e lëvruar nga Marko e Kadare, krijoi një profil dhe identitet të vetin në letërsinë europiane, çka e vuri në dukje veçanërisht kritika e huaj. Në këtë aspekt, pavarësisht rrethanave ku gjendej e ngërthyer krijimtaria letrare në vend, falë formimit dhe koncepteve të këtyre dy shkrimtarëve ndaj letërsisë, romani shqiptar, si proces letrar, me botimin e veprave romanore të Petro Markos dhe Ismail Kadaresë, po orientohej dhe filloi të ecte në koherencë të plotë me zhvillimet dhe rrymat që mbizotëronin në prozën romanore në Europë dhe në botë. Modelet e letërsisë së huaj dhe fryma që mbizotëronte në perëndim, po e jepte ndikimin e saj edhe në letërsinë shqipe, por me kalimin e kohës procedetë e letrare të perëndimit bashkëjetuan në mënyrë të njëkohshme me risitë dhe dukuritë letrare në terrenin shqiptar, duke shkrirë disa nga elementët narrativë dhe strukturorë në disa prej pikëtakimeve të përbashkëta e njëkohësisht, me prirjen për të krijuar marrëdhënie komunikimi të ndërsjella. Cilado qoftë marrëdhënia e letërsisë me sferat e tjera me vlerë për të, librat ndikohen prej librave; librat imitojnë librat e tjerë, i parodizojnë, i transformojnë - dhe jo thjesht në mënyrë kronologjike. "Në letërsinë e sotme origjinaliteti i zhanrit është më i dukshëm në ato raste kur nisemi nga veprat dhe autorët më me ndikim, me forcë centrifugale: ndikimi letrar, për shembull, i Eliotit dhe Odenit, i Prustit dhe Kafkës në rrjedhat e ndryshme të letërsisë bashkëkohore"[1].

Me anë krahasimit, marrë jo si teori e veçantë po thjesht si metodë dhe njëherazi si sprovë hipotezash, kemi qëmtuar për të depërtuar në mënyrë më të sigurt në shqyrtimin e teksteve. "Në pikënisje kjo metodë i përmbahet këtij parimi që e bën të dallueshëm nga disiplinave të tjera "të krahasuara": çfarë ndodh kur një ndërgjegje njerëzore, e përfshirë në një kulturë (në kulturën e saj) përballet me një vepër, që është shprehje dhe pjesë e një kulture tjetër? Thënë ndryshe, takimi (i rastësishëm ose jo) me të huajën, me atë që nuk flet të njëjtën gjuhë, që nuk ka të njëjtën kulturë, që është një "barbarus", gjuha e të cilit mbetet e pakapshme, njësoj si fonemat që s'kanë kuptim, takimi me *tjetrin* pra, është pikërisht në qendrën e qasjeve krahasuese"[2]. Lidhjet e ndërsjella midis veprave të artit janë objekt krahasimi kritik të dy sistemeve tërësore, dy konfiguracioneve që vetëm në fazat paraprake të studimit mund të copëtohen në elemente përbërëse. Kur krahasimi të jetë përqendruar vërtet në dy tërësi, atëherë bëhet e mundur të arrijmë në përfundim për një problem themelor të historisë së letërsisë – për problemin e origjinalitetit. Në kohën tonë origjinalitetin zakonisht e ngatërrojnë thjesht me shkeljen e traditës ose e kërkojnë aty ku në të vërtetë nuk ekziston, përgjithësisht në materialin e veprës së artit ose në skeletin e saj – subjekti tradicional, konstrukti tradicional. Gjatë analizës së teksteve letrare jemi munduar të dallojmë veçantinë që vihet re në një individualitet krijues nga unikaliteti i plotë. Si çdo qenie njerëzore, çdo vepër letrare ka karakteristikat e veta individuale; por, njëkohësisht, atë e bashkojnë me veprat e tjera cilësitë e përbashkëta, ashtu si çdo njeri ka tipare të përbashkëta për të gjithë racën njerëzore, për seksin, kombin, klasën, profesionin e tij etj. Përgjithësisht kritika letrare dhe historia e letërsisë synojnë të karakterizojnë atë që është individuale në një vepër, në një autor, në një periudhë, ose në një letërsi kombëtare. Në punimin tonë, metodën krahasimtare nuk e kemi vlerësuar thjesht si një bashkësi tekstesh në një përqasje letrare, aq më pak si praktikë e "paralelesh". Në thelb është fjala për një përpjekje intelektuale, që synon të studiojë çdo objekt të quajtur (ose që mund të quhet) letrar, duke e vënë në marrëdhënie me elementët e tjerë përbërës të një kulture. Duke u bazuar kryesisht në kriterin letrar, jemi munduar të përcaktojmë caqet e një dukurie letrare, që, duke e kundruar si një hark kohor ku mbisundon një sistem i caktuar normash, modelesh dhe konvencionesh letrare, solli prurje të panjohura më parë. Historia e një periudhe qëndron pikërisht në hetimin e ndryshimeve nga një sistem normash në tjetrin. Duke qenë një hark kohor, të cilin ne e konceptojmë si një tërësi unike, është e qartë se uniteti i këtij harku kohor, pra, i periudhës, mund të jetë vetëm relativ. Kjo do të thotë se gjatë kësaj periudhe ka skema normash që nuk gjejnë realizim të plotë. Në qoftë se uniteti i periudhës do të ishte madhësi absolute, atëherë periudhat do të viheshin njëra mbi tjetrën si blloqet e gurit, pa vazhdimësi dhe traditë zhvillimi. Për këtë

1 Rene Wellek dhe Austin Warren: *Teoria e Letërsisë*, Sh. B. **Onufri**, Tiranë 2007, f. 243.

2 Yves Chevrel: *Letërsia e Krahasar*, Sh. B. **Albin**, Tiranë 2002, f. 10 – 11.

(Vijon në faqen 11)



LËNDINA E PIKËLLIMIT

Poezi nga Skënder Rusi

DITËT E MIA PA TY

Ka ditë kur unë
S'di ç'të bëj me veten,
Dal nga shtëpia
Dhe vetmia për dore më mban,
Kërkoj një lumë ku unë
mund të mbështetem
Të fle mbi ujrat e tij
Pak,fare pak!

Ka ditë që pres hapat e kthimit tënd,
Ato janë nisur,
unë e njoh këtë zhurmë,
Lamtumirë ditët e mia në paqe,
Dhe gjithë ju të tjerat
Që i komandoj unë!

Ka ditë kur unë jam bosh,fare bosh,
Jam ky pyll ku të pëlqen të vdesësh,
Nëse në këtë pyll një ditë do më kërkosh,
Atje do të më gjesh në formën e vesës!

LËNDINA E PIKËLLIMIT

Unë jetoj tek lëndina e pikëllimit,
Ku fluturojnë veç harabelë të vdekur!
Hapni portat e qiellit,ç'prisni,
Këtu çdo ditë zgjat sa një shekull!

Po unë për këtë nuk mërzitem,
Këtu e ka kasollen edhe era,
Ajo më futet nëpër vite,
Dhe e gjen ku rri fshehur zemra!

Unë jetoj në lëndinën e pikëllimit,
Jam brenda saj, atje ku rri shpirti!
Unë jam ky lumë që juve dot s'e shihni
Që lëviz brenda jush e ju nuk e dini!
Aty nis jeta që nga fillimi!

NATA DHE UNË

Qielli si një libër
I mbylli kapakët,
Dielli krejt i kuq
Si një sy i lodhur,
Nata si një ankth
I ka hapur krahët
(Ka ca shekuj
Që nuk i kam folur!)

Njërin sup të saj
Të zbuluar pakëz,
Ma dha të mbështetem
Si një mik i vjetër!
Nata po të dojë
Të çon në Parajsë,
E të bën të ndjehesh
Në një botë tjetër!

Qielli si një libër
I mbylli kapakët,
Vuri veç një shenjë
Që të mos ngatërrohet,
Nata është e gjitha
Një mashtrim i bardhë,
Herë na pushton,
Herë nga ne pushtohet!

DËBORA BLU

Kërkoj të futem brenda syve të tu,
Dhe kjo me asnjë kusht, natyrisht,
Përjashta po bie dëborë blu,
Nuk është dëborë po shpirt!

Trokas në portën që atje më shpie,
Tek sytë e tu të mëdhenj,
Bie dëborë blu,vazhdon e bie,
Është shpirti im që dhemb!

Brenda syve të tu edhe unë
Kërkoj pa asnjë kusht që të hyj,
Por ah,ky qiell rëndoka shumë,
Më lodhën yjet që me dorë i shtyj!

Kërkoj të hyj breda syve të tu,
Paçka se e kam të vështirë
Të të them,të dua,
Ti edhe qerpikët i ke hedhur në luftë,
I mbyll ata që mos më shohësh mua!

DITË PA MËNGJES

Dita lindi por pa mëngjes
Më kot e prita diellin që të vinte,
Jam ulur në një stol
Dhe nuk e di kë po pres,
Nuk e di pse erdhi ai që po ikte!

Sa ngadalë lëvizin akrepat e orës,
Sikur të jenë të sëmurë të tre!
Ma jepni pak pëllëmbën e dorës,
Dua të lexoj kohën që m'u fsheh!

Por mos më thoni që nuk është e mundur
Që s'mund të ketë ditë pa mëngjese,
Brenda pëllëmbës sime dielli rri i strukur,
Sikur ka frikë prej njerëzve!

Do desha tani të ishte mëngjes,
Por edhe ai si dielli fshihet,
Prapë m'u ftoh kjo kafe ekspres,
Dhe kur do ta pi, nuk dihet!



DHURATË

Të dhashë ditët e mia më të bukura,
Dhe vetë mbeta pa ditë!
Midis tyre ka dhe ditë të humbura,
Ditë të lodhura nga marrëzitë!

Të dhashë netët e mia çapkëne,
Që i ruaja t'i kisha për vete,
Ato vdesin njera pas tjetrës,
Si zjarret në duart e njerëzve!

Zjarret e mi janë të vegjël,
Po të mjaftueshëm për t'u ngrohur
Nuk dua asgjë të më kthehet
Paçka se ndjehem i lodhur!

Të dhashë ditët e mia më të bukura,
Që do vijnë me mua përtej kësaj jete,
Secila prej tyre është një hënë delikate
Që fillon e dridhet po e preke!

O, Ç'FAT QË ZGJODHA

Unë s'di të ec,
Di veç të vrapoj,
Si ky glob që vrapon mes planetësh!
Kapërcej këtë qiell e në të tjerë shkoj,
Në lëvizje jam prej mijëra vjetësh!

Unë s'di të ec,
Di veç të fluturoj
Bashkë me zogjtë dhe njëlloj me ta,
Kohë nuk kam,ndaj s'di të ndaloj,
Dhe vetëm erën e kam krah!

Unë s'di të ec,
Di veç të nxitoj,
Janë me mua hapësira dhe koha,
Nga gjumi,njerëzimin vetëm unë e zgjoj,
Dhe tok me të do të vrapoj akoma!

Ndërsa vdekja,
Vdekja ime është në koma!

FALEMINDERIT E DASHUR

Çdo ditë
Ti më sjell copëza dielli
M'i ve ato në xhep
Që unë t'i kem për rrugës!
-Bëj kujdes-më thua pastaj në vesh
Se mos i humbësh.

E dashur faleminderit!
Ti më rri gati
Edhe për gjërat e mia më të vogla.
Përshembull, kur dal nga mëngjezi,
Ti nuk rri pa më përcjelle deri te porta!

Ose nuk të ze gjumi,
Sikur pakëz të më dhembë koka!

Faleminderit e dashur!
Unë i bashkova copëzat e diellit që më dhe
Dhe bëra me to një diell të vogël.
Qielli do jenë sytë e tu të mëdhenj
Me ta do ta shoh botën!

DUKE ECUR RRUGËS

Duke ecur rrugës
më godet një pemë,
(E përse ta fsheh,
isha i hutuar!)
Ajo ish si unë,
s'mund të ish e verbër,
Mund të ishte,thjesht,
pemë e dashuruar!

Duke ecur rrugës
godita një pemë,
(Nuk e di se si
pengohem mbi ajrin!)
Ajo seç më foli
me një zë të gjelbër,
(Pemët s'janë si njerëzit
që s'dinë të falin!)

Duke ecur rrugës
më trishtoi një pemë,
E lashë pa gjethe,
unë dhe jo era!
Tani rri e pres
kur do bëhet vjeshtë,
Kur s'do kenë gjethe
as pemët e tjera!

MËRZITJE

Më ke mërzitur shumë,,
Nuk mund të vazhdohet më kështu,
Më thanë të ndez ca qirinj edhe unë,
Për vete dhe për ty gjithashtu!

U shuajt qiriri i madh,
U bë errësirë papritur,
Në shtëpi mund të rri veç një cast
Ajo më shumëmë është mërzitur!

Nuk mund të vazhdohet kështu
Ta hajë dreqi,ta hajë,
Fryn era si për inat
Që e kemi lënë jashtë!

O Zot që rri atje lart,
Edhe qirinjtë e vegjël drithërojnë,
Prandaj edhe unë s'i shuajta,
Sado pak ata na ndriçojnë!

'MUND TË ISHA I LUMTUR

Mbrëmë nuk fjeta gjithë natën.
E pra, duhej të isha i lumtur!
Qielli mbi ne si një çadër e kaltër
Të tregonte edhe më të bukur!

E pra, duhej të isha e lumtur.
Ish një natë e tërë me ty!
Me të drejtën për të të puthur
Në buzë, në faqe, në sy.
Ish një natë e tërë me ty!

Me aromë prej teje, e gjitha.
Por që s'u quajt dot "Jotja",
Sepse nuk u quajt as "Imja"!
Kish aromë prej teje e gjitha.

Por unë s'i gëzohesha dot!
Se ti doje të isha robi yt,
Por unë s'zihem aq lehtë rob!
Ndaj s'mund të gëzohesha dot!

E pra, s'mund të isha i lumtur!
Paçka se nata ish aq e kaltër!
Paçka se ti ishe aq e bukur!

NUK E MBAJ MEND

Nuk e mbaj mend ç'shekull ka qenë,
Kur ne me natën u bëmë një!
Mbaj mend veç borën që kishte rënë,
Dhe binte prapë, ashtu, pa zë!

I kam harruar që të gjitha
Dhe rrugët që atje më shpunë,
Vec një kambanë atje te kisha
Nuk mundem dot ta harroj unë!

Ajo binte vetëm për mua
dhe mua kjo gjë më pëlqente,
Kambanat kush i ka krijuar
Bekimin e Zotit ka me vete!

Nuk e mbaj mend ç'natë ka qenë,
Ishim në prill apo në mars,
Unë puthje si ajo s'kam dhënë
Dhe nuk kam vdekur si atë çast!

NË MESNATË

Gjithnjë në mesnatë
ti më hyn në gjumë,
Rri pakëz me mua
dhe ngrihesh e ik!
Kudo ku të kanë prekur,
ta dish që jam unë,
Kudo që më kanë prekur,
ta dish që je ti!

Akrepat e orës përmbi njeri-tjetrin,
(O,ç'kryqëzim mesnatash të mëdha!)
Nuk e dimë ,këtë, e kanë mësuar
nga njerëzit,
Apo njerëzit
e kanë mësuar nga ata!?

Gjithnjë në mesnatë,
ti më hyn në gjumë,
Po ç'dreqin ke
që aq shpejt më ikën!?
Akrepat e orës
nuk i lëviz dot unë,
Të ishte kështu
do ta vonoja ditën!

Se ti asaj ia ke frikën!

JETË E MBUSHUR ME GABIME

S'po vjen dot në botën time,
Bëra çmos të hysh në të!
Ditë e mbushur me gabime,
Hapat hedh një e nga një!

Bora e parë s'ka rënë ende,
Po ky dimër ngjan me ty!
Natë e mbushur me gabime,
Hapat hedh dy e nga dy!

Unë ju flas me heshtjen time,
Zëri im shkon përmbi re!
Jetë e mbushur me gabime,
Hapat hedh tre e nga tre!

M'u mërzit dhe puthja ime,
Nëse duhet që ta dish!
Jetë e mbushur me gabime,
Ku jetojmë gabimisht!

DORË E DASHUR

Po bëhen 100 vjet
që ke nisur e dridhesh,
Si të ishe fluger që tregon
drejtimin e erës!?
Aq sa tani,
unë kam krijuar bindjen
Që s'je pjesë e krahut,
por je pjesë e zemrës!

Se vetëm brenda saj
gjithnjë fryjnë erëra,
E vijnë ca dimra
që nuk duan të ikin!
Po ti,e vogla ime,
mos u fshih nëpër xhepa,
E mos ki turp
nga sy që të bezdisin!

Se je dorë poeti
dhe kjo nuk është pak,
Gjithnjë veç ngrohtësi
u ke falur njerëzve!
Gjithnjë e ke urryer
dashurinë fals,
Dhe shtrëngimin fals
me duart e të tjerëve!

Dorë e dashur,
e di që të kam lodhur,
Në 100 vjet kam bërë
1000 marrëzi!
Por asnjëherë
më dimër s'jam ndodhur,

Se sa kur dridhesh ti!

Cikël poetik nga përmbledhja më e fundit me lirika e poetit Skënder Rusi, "Ti më ke dashur pakëz", botuar nga shtëpia botuese "Armagedoni", Prishtinë, tetor 2021.

(Vijon nga faqja 9)

arsye, në çdo periudhë gjejmë medoemos edhe mbeturinat e skemave paraardhëse të normave, edhe embrionet e skemave pasardhëse.

Një tipar dallues në rrjedhat e letërsisë shqipe, i krijuar përgjatë procesit evolutiv prej pesë shekujsh, lidhet me faktin se kjo letërsi ka mundur të krijojë identitetin e saj artistik, duke ruajtur së pari vlerat e traditës së krijuar si edhe të përballojë transformimet e ndryshme në brendinë e saj.

Në fillim të shekullit XX, letërsia shqiptare kaloi në një fazë të re, me tematikë më të zgjeruar politike-shoqërore, me karakter më të thelluar popullor e demokratik, me theks më të dukshëm realist e me elemente të fuqishme kritike. Në këto zhvillime intensive në procesin evolutiv të saj, fizionomia e letërsisë shqipe nga fillimi i shekullit të XX e deri në vitet e Luftës së Dytë Botërore e në vazhdim, shfaqet me një përbërje mjaft të ngjeshur e të larmishme, në kuptimin që brenda një periudhe të shkurtër kohe në brendinë e saj kanë bashkëjetuar shumë dukuri rrymash letrare, herë të qëndrueshme e herë kalimtare, herë të natyrshme e të pritura, herë të " panatyrshme " e deri diku të " papritura ".

"Prej kohësh është ndier se historia e letërsisë së një kombi, e ndërtuar si renditje kohore e jetës dhe e veprimtarisë së shkrimtarëve më të shquar të saj, është megjithatë e pamjaftueshme për ta kuptuar dhe përthithur atë letërsi si një proces ndryshimesh të paprera, që përmes krijimit të vazhdueshëm lë mënjanë pjesë të tëra të vetvetes për të lindur e rritur të tjera pjesë, të cilat përsëri do t'i zëvendësojë me vepra, prirje e dukuri të tjera"[3].

Në përpjekje për të analizuar dhe krahasuar dukuritë dhe risitë, kahet dhe sprovat që po spikatnin në letërsinë e huaj si edhe prirjeve që u shfaqën në letërsinë shqipe në përqasje me zhvillimet në procesin letrar europian pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe përfshirjes së procesit krijues të lëvrimit të modelit të realizmit socialist, është arritur që prozën romanore të Petro Markos dhe Ismail Kadaresë ta analizojmë nëpërmjet dy metodave: historiko – kulturore dhe metodës krahasuese, nëpërmjet të cilave këtë dukuri letrare që karakterizon veprat e këtyre dy autorëve të rëndësishëm të letrave shqipe, ta trajtojmë në kompleksitetin e vet së pari si alternativë letrare. Për t'iu avitur këtij qëllimi nevojitet të hedhim një vështrim mbi historikun e romanit shqiptar që nga fillesat e tij, e duke vijuar më tej me situatën dhe rrethanat e krijuara pas Luftës së Dytë Botërore dhe konkretisht përgjatë viteve '50 – '60 të shekullit XX, kohë në të cilën romani nisi të lëvrohej dhe të botohej gjerësisht në Shqipëri. "Para historisë së letërsisë qëndron një problem i njëjtë: të hetojë historinë e letërsisë si art, veçuar relativisht nga historia e shoqërisë, nga biografitë e shkrimtarëve ose nga vlerësimi për këtë apo atë vepër"[4]. Për rrjedhojë në mënyrë krejt të natyrshme, nuk mundet kurrësesi të mohojmë se ka një dallim të prerë midis historisë politike dhe historisë së artit. Ka dallim midis asaj çka është historike dhe e kaluar, dhe asaj çka është historike por edhe pjesë, gjithsesi e së tashmes. Duhet pranuar se pjesa më e madhe e historive të letërsisë janë ose histori të jetës shoqërore, ose histori të mendimit shoqëror të ilustruar më vepra letrare, ose përmbledhje përshtypjesh e gjykimesh për vepra të veçanta të renditura pak a shumë në rend kronologjik. Në gjykimin e Tomas Uërtënit, historianit të parë të poezisë angleze, është pikërisht historia mekanizmi që regjistron me përpikmëri tiparet e kohës së vet, duke bartur peizazhet më të gjalla dhe shprehëse të zakoneve, si arrin të transmetojë në brezat e ardhshëm një pasqyrë të vërtetë të jetës. Një tjetër historian i njohur i letërsisë angleze Henri Morni e mendonte letërsinë si biografi të kombit, si histori të shpirtit kombëtar. Për studiuesin Lesli Stefënin letërsia ishte një lloj funksioni i veçantë i organizimit të shoqërisë në tërësi, produkti anësor i ndryshimeve shoqërore. Ndërsa U. Xh. Kort'houp, autor i së vetmes histori të poezisë angleze të bazuar në një koncept të njësuar zhvillimi, e përcaktonte studimin e poezisë angleze si studim, në thelb, të rritjes së pandërprerë të instituteve kombëtare që gjejnë pasqyrim në letërsi, kurse unitetin e objektit ai e kërkonte pikërisht aty ku e kërkon historiani i jetës politike, domethënë, në jetën e kombit në tërësi. Por në këndvështrimin tonë letërsia nuk mbetet në vetëm në kufijtë e pasqyrimit të proceseve shoqërore, por në thelb ajo është rikrijimi dhe përmbledhja e gjithë historisë së mendimit njerëzor, pasi letërsia nuk mund të konceptohet si një radhë veprash të mbyllura në vetvete, pa asgjë të përbashkët me njëra – tjetrën, as një radhë veprash që lidhen sipas cikleve kohore; letërsia klasiciste, letërsia romantike, letërsia realiste etj. Duke e parë në këtë këndvështrim, përdorimi i metodës krahasuese mbetet një mjet i domosdoshëm për të analizuar përngjasimet stilistikore dhe përmbajtjesore të drejtimeve të ndryshme letrare, si edhe përpjekjet e sprovat e ndërmarra nga autorë të ndryshëm për të thyer konturet e skemave të gatshme, për të mbërritur së fundi në krijimin e modeleve të pavarura, të cilat shënjuan stadin e shkëputjes së romanit shqiptar nga klima e përgjithshme e solidaritetit të shkrimit unik. Në këtë mënyrë do të saktësohen disa nga faktorët më thelbësorë të ndërtimit të subjektit të veprave letrare që përfaqësojnë këtë periudhë, duke pasur parasysh kushtet dhe rrethanat në të cilat romani shqiptar mundi të konsolidojë fizionominë e tij letrare.

Gjatë analizës së elementëve përbërës të strukturës formale të romanit që u lëvrua në Shqipëri përgjatë viteve '50 – 60 të shekullit XX-të, vërejmë se teksa ndryshojnë temat, personazhet, ndryshojnë edhe strukturat e brendshme të veprës, sa i përket risive stilistikore, tematikës, elementëve kohore dhe atyre vendorë në të cilin shtjellohet krejt subjekti i romanit si lloj dhe tipologji shprehëse. Një ndërlidhje e personazheve me situatat e krijuara, origjinalitetin e mënyrës narrative, strukturimin e tekstit në varësi të metamorfozës që pëson personazhi, përbën në vetvete një faktor që jep ndikimin e vet edhe në ndryshimin e rrëfimit dhe veprimit, në kohë dhe në hapësirë. Ky tip shkrimi njëkohësisht përjashtonte unitetin e rrëfimit të romanin klasik dhe pranonte prirjet moderniste që viheshin re në letërsinë e huaj. Në vijimësinë e këtij procesi riformatimi që po pësonte romani shqiptar falë koncepteve dhe formave që kultivonin shkrimtarë të tillë si Petro Marko dhe Ismail Kadare, vërehen ndryshime të ndjeshme si në dinamikën e të rrëfyerit përgjithësisht, e veçanërisht të rrëfimtarëve, si dhe të ndërtimit të frazës ashtu edhe të përsosjes së nivelit artistik, i cili arrihej nëpërmjet shprishjes së normave standarde të shkrimit që ngërthenin artin e të rrëfyerit. Kështu vërejmë se me ndërrimin e kapitujve, romani do të pësojë jo vetëm ndërrim të psikikës dhe karakterit të përgjithshëm të personazhit, por edhe shndërrim dhe përmbysje të ngjarjeve, situatave, formës narrative, pozicionit hapësinor e kulturor kundrejt botës. Pikërisht një kahje e tillë na shfaqet herë si dukuri e përgjithësimit të fenomeneve jetësore dhe në të njëjtën mënyrë të rikonceptimit të realitetit objektiv dhe herë si i shformësim të tipareve dalluese të përkatësisë së ambientit në të cilin u farkëtua stili dhe struktura romanore në letërsinë shqipe.

3 Ali Xhiku: *Letërsia Shqipe si polifoni*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Letërsisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, Sh. B. Dituria 2004, f. 7.
4 Rene Wellek dhe Austin Warren: *Teoria e Letërsisë*, Sh. B. **Onufri**, Tiranë 2007, f. 262 – 263

ARRATIA NGA PARAJSA E LEV TOLSTOIT: FAJI I KUJT PRA?

Nga Pavel Valereviç Basinski

Përktheu nga origjinali Agron Tufa

Por nuk do të bëhemi hipokritë dhe do të shtrojmë një pyetje: a nuk kishin vallë lidhje konfliktet familjare me ftohjen e një burri tashmë të plakur ndaj shoqes së vet pakrahasimisht më të re (diferenca mes tyre ishte gjashtëmbëdhjetë vjet), por dhe ajo, tanimë, larg të qenit e re? Ndalemi pak e shestojmë, përshembull, në këtë fletë të kujtimeve të saj: "Jetën e tij familjare Lev Nikollajeviçi e ka konsumuar plotësisht. Ende diku në thellësinë e zemrës së tij është e ngrohtë dashuria për mua, për vajzat, të cilat ai i kishte dhe të domosdoshme, dhe të dashura, por ai u largua, u largua shpejt, dhe unë gjithë e më tepër ndjeja vetminë time dhe gjithë përgjegjësinë për vete dhe për familjen".

Kjo zbulesë depërtuese femërore duket se flet vetë. Por një fjalë na pështjellon në të: "shpejt". Ky kujtim daton në 1894. Shpejt? Largimi i parë i Tolstoit nga shtëpia ndodhi në vitin 1884, dhjetë vjet më parë. Pas vitit 1894, ata jetuan së bashku për mbi pesëmbëdhjetë vjet. Pra, nëse Tolstoi u largua, nuk ishte "shpejt".

Në pyetjen e shtruar përgjigjet mbushamendshëm dhëndri i Tolstoit M.S. Suhotin në ditarët e tij. Por kur? Në vitin 1910. "Sado e çuditshme, por ftohjen e plotë të L.N. ndaj gruas mund ta vëresh, dhe kjo i bie në sy njeriut që jeton në shtëpi vetëm përgjatë viteve të fundit, veçanërisht gjatë vitit të fundit. A nuk ndodh vallë në masën që kurmi gjithë e më shumë po vdes?

As në letrat, as në ditaret e Tolstoit të viteve 1890 nuk i gjejmë simptomat e kësaj ftohjeje. Përgjigjja më bindëse për pyetjen tonë është letra e Tolstoit për gruan, e shkruar në nëntorin e vitit 1896 nga Jasna. "Ti më pyet: a vazhdoj të të dua. Tani ndjenjat e mia për ty janë të tilla që, siç kam bindjen, kurrsesi nuk mund të ndryshohen, sepse ato janë plot me të gjitha ato gjëra që vetëmse i lidhin njerëzit. Jo, jo të gjitha. Nuk mjafton dakordësia e jashtme në besimet tona, - e them e jashtme, sepse mendoj që mosmarrëveshja është vetëm e jashtme, dhe gjithmonë jam i bindur se ajo do të shkatërrohet. Po ne na lidh dhe e shkuara, dhe fëmijët, dhe ndërgjegjja e fajeve tona, dhe keqardhja, dhe *tërheqja e parezistueshme* (kursivi im. – *P.B.*)".

Çfarë "tërheqjeje e parezistueshme" kihet parasysh? Siguristh, do të kishte qenë e vrazhdë të llogarisësh se bëhet fjalë përjashtimisht për pasionin seksual. Por do të ishte qesharake gjithashtu të flasësh dhe për marrëdhënie ngushtësisht platonike me gruan madje në fund të viteve 1880, kur ai po kapërcen kufirin e të shtatëdhjetave të moshës së tij.

Pikërisht në këtë kohë Tolstoi është xheloz ndaj saj në lidhje me muzikantin dhe kompozitorin S.I. Tanjejev, i cili nis të shfaqet shpesh në shtëpinë e tyre në Hamovinik dhe t'i kalojë verat në Jasnoe Poljana, si në daça. Dashuria e Sofia Andrejevnës ndaj muzikës (e ndërsjelltë me burrin) dhe përjetimet e papërmbushura përsa u përket aftësive të saj interpretuese i ngjallën një pasion morbid për muzikantin brilant, student i Çajkovskit, një pasion që edhe fëmijët e saj më të mëdhenj e shikonin me mosmiratim. Sa i përket Lev Nikollajeviçit, ai, duke ruajtur me Tanjejevin së jashtmi marrëdhënie miqësore (dëgjonte muzikën e tij, kuvendonte me të, luante me të shah), ia shtroi të shoqes çështjen e pashmangshme të zgjedhjes: o me mua, o me atë!

Kur në shkurt të vitit 1897 Sofia Andrejevna u bë gati të udhëtonte në Petërburg, që të ishte e pranishme në repeticionin e Tanjejevit, Tolstoi i shkruajti asaj nga Nikolsko-Oboljaninovo:

"Është jashtëzakonisht e dhimbshme dhe poshtërimisht e turpshme që një person krejtësisht i huaj e i panevojshëm, përpos dhe aspak interesant, na udhëheq jetën, na helmon vitet tona të fundit apo makar një vit të jetës sonë; Zot, sa poshtëruese, sa e dhimbshme e torturuese që na u dashka të përballojmë tani dhe se kur e se ku do të shkojë ai, se çfarë provash po bën e kur do të luajë".

Në maj të po atij viti xhelozia e Tolstoit mbërrin apogjeun e vet. Vetë ai gjendet në Jasnoje-Poljana, ndërsa e shoqja – në Moskë, po ajo është e shtrënguar t'i vijë pranë për të qetësuar tërbimin e tij.

Menjëherë pas kthimit të saj në Moskë ai i dërgon një letër, të cilën do ta kishim siklet ta citonim, duke pasë parasysh që është shkruar prej një plaku pothuaj shtatëdhjet vjeç, nëse në letër nuk do të kishte pasur aq shumë forcë poetike rinore.

Ai e nis me paralajmërimin "Lexoje e vetme".

"Zgjimi im dhe shfaqja jote qenë një nga ndjesitë e mia më të forta e më të gëzueshm që kam provuar; dhe kjo për një 69-vjeçar ndaj një gruaje 53-vjeçare... Vera nxiton të jetojë – jargavani tashmë po vyshket, bliri po e gatuan ngjyrën e vet, në thellësi të kopshtit, në gjethnajën e dendur, turtujt dhe trishtilët, ndërsa bilbilët poshtë parvazeve të dritareve janë çmendurisht muzikalë. Tani është natë, të shkëlqyer, si të larë, janë yjet, dhe pas shiut kundërmojnë jargavanët dhe gjethet e mështeknës. Serjozha (djali ynë) erdhi po atë natë që ti u largove; ai trokiti poshtë dritares sime dhe unë gjithë gëzim klitha: "Sonja!". Jo, Serjozha".

Por nuk kalon as një javë, kur Tolstoi i shkruan një letër të re, të tërbuar e xheloze, me të cilën e kërcënon haptazi me divorc.

Në këtë letër as që bëhet fjalë për mospajtimet shpirtërore dhe për "moskuptimet". Gjithçka këtu është shumë e qartë.

Tolstoi kërkon që ajo të ndërpresë komunikimin me atë njeri, tek i cili sheh rivalin.

"Afrimi yt me Tanjejevin nuk është vetëm i pakëndshëm për mua, por tmerrësisht i torturues. Duke vazhduar të jetoj në këto kushte, unë helmoj dhe shkurtoj jetën time. Ja, kaloi viti, që unë nuk mundem më të punoj dhe nuk po jetoj, porse cfilitem vazhdimisht. Ti e di këtë. Këtë ta thashë edhe me irritim edhe me përgjërime dhe kohët e fundit nuk ta kam zënë më në gojë. I provova të gjitha, po asgjë nuk më bëri derman: afrimi yt vazhdon dhe madje shtohet sa s'ka ku të shkojë më tutje dhe shoh që kështu do të shkojë deri në fund".

Tolstoi i shtron asaj të zgjedhë midis pesë varianteve:

1) të ndërpresë komunikimin me Tanjejevin. "As takime, as letra, as pretekstin e shoqërimit të djemve të tyre, as portrete... por shkëputje, çlirim të plotë";

2) ai largohet jashtë shtetit, duke u ndarë prej të shoqes përfundimisht;

3) të dy largohen jashtë shtetit, deri kur Tanjejevi të jetë përzënë krejt nga koka e saj;

4) ata vazhdojnë të jetojnë si më parë, duke u hequr që asgjë nuk po ndodh. Porse ky për të është varianti më i tmerrshëm;

5) ai do të përpiqet të ndryshojë qëndrimin e tij ndaj ndaj fiksimit pasional të së shoqes dhe do të presë divorcin e natyrshëm. Por zor do të ketë fuqi ta përballojë këtë.

Tolstoi nuk e dërgoi letrën në postë dhe të nesërmen shkoi te i vëllai, Sergej Nikollajeviçi në Pirogovo për të zbrazur gjithë barrën që i rëndonte në shpirt. Në qershor vjen mysafir në Jasnoje Poljana Tanjejevi, pa ditur gjë mbi situatën. Dhe ja, gjatë kohës së qëndrimit të tij në Jasnoje, Tolstoi shkruan atë letrën e famshme mbi largimin nga shtëpia, të cilën e citojnë zakonisht si bazën e përligjjes më të mundshme filozofike të këtij akti.

"...ashtu siç largohen hindusët rreth të gjashtëdhjetave në pyje, sikundër çdo plak fetar ia kushton vitet e fundit të jetës Zotit dhe jo shakave, kalambureve, thashethemeve, tenisit, ashtu dhe unë, duke hyrë në vitin tim të shtatëdhjetë, e dëshiroj këtë qetësi me gjithë forcën e shpirtit, vetminë, në shmang me ndërgjegjen time, që megjithëse nuk ka qenë krejt në harmoni, të paktën nuk ka pasur mospajtime bërtitëse me besimin në jetën time".

Fjalë madhështore! Me çfarë mahnie i citon ato Ivan Bunini në librin "Çlirimi i Tolstoit". Ai jo vetëm thjesht i citon, por i shfrytëzon si kyç për misterin e largimit të plakut jasnapoljan. Ashtu siç hindusët largohen ndër pyje. Ashtu siç dëshirojnë pleqtë t'ia kushtojnë Zotit vitet e tyre të fundit. Dhe kjo ka qenë, siguristh, e vërteta. Dhe kjo vazhdon të mbetet e vërteta dhe pas trembëdhjetë vitesh, kur më në fund largimi ndodh konkretisht.

Problemi botëkuptimor i largimit të Tolstoit është, nga njëra anë, aq i koklavitur (për këtë janë shkruar dhjetëra studime të filozofëve dhe teologëve më të mëdhenj), dhe nga ana tjetër – aq i tejdukshëm dhe madhështor, si ujërat e thella të një liqeni, saqë mbetet vetëm të tronditesh me mënyrën se si Tosltoi ia doli ta shprehë me pak fjalë në letrën e korrikut të vitit 1897. Këtu qëndron ndryshimi principial i gjeniut nga talenti. Gjeniu është i aftë që veprimin më ekcentrik, në lidhje me konfliktet familjare, ta shndërrojë në Kuptim, mbi të cilin të vrasin mendjen brezat. Ata do ta deshifrojnë këtë si një "shifër", duke ofruar "koncepte" nga më të ndryshmet. Ata do ta provojnë këtë akt në lidhje me fatet e tyre, do ta rrahin e shestojnë, nganjëherë do ta përsërisin, por gjithmonë pa sukses.

Tolstoi e ushqeu idenë e largimit të tij në kokë për njëzet e pesë vjet mu si një vepër madhështore. Ai mëse njëherë e pati redaktuar, madje, siç e shohim, edhe në këtë letër. Por në fund të fundit ai e realizoi spontanisht dhe në pamje të parë jo në kohë. Epo nuk largohesh në pyje de, kur përtej dritares shtrihet vjeshta e mërdhirë, që po kalon në dimër.

Por në letër kishte dhe fjalë të tjera.

"Nëse këtë do ta kisha ndërmarrë faqe të gjithëve, do të kisha pasur lutje, qortime, diskutime, ankesa, dhe unë do të isha treguar i dobët, me gjasë, nuk do ta kisha zbatuar vendimin tim, e ai duhej përmbushur. Dhe prandaj, ju lutem, më ndjeni, nëse akti im ju shkakton dhimbje, dhe në shpirtin tuaj, kryesisht ti, Sonja, lërmë të jem i lirë dhe mos më kërko, dhe mos më bjer pas, mos më gjyko".

Papajtueshmëria me gruan e tij ishte një nga arsyet kryesore të këtij largimi. Dhe nuk është rastësi që gjatë gjithë viteve '90 jeta e familjes dukej se tingëllonte me motive ogurzeza të "Sonatës së Krojcerit". Tolstoi para së gjithash braktisi "projektin" e tij familjar, të cilin e konceptoi në vitet '50 dhe

e përshkroi në një letër drejtuar Ergolskajës. Dhe ky "projekt" u zhvillua, por vetë Tolstoi tani nuk e pëlqen më. Roli i një burri dhe babai të respektuar, që grumbullon thesare materiale për fëmijët dhe nipërit e mbesat në "sëndukun" e të parëve, nuk është më interesant. Është i neveritshëm, si një arkivol.

Horizonti i vizionit të tij në këtë kohë është i pabesueshëm. Ai vë në dyshim kishën, shtetin, idealet shoqërore. Në një botë që është gati të shembet (dhe do të shembet!) në kataklizma luferash dhe revolucionesh monstruoze, ai kërkon të vetmen bazë shpëtimtare dhe e gjen në komunitetin fshatar, i cili përmbush drejtpërdrejt urdhërimin e Zotit për të punuar me djersën e ballit dhe të mos kërkojë një mundësi për t'u ndjerë mëkatar në një botë të rehatshme, mashtruese, të panatyrshme, ku shumica punon dhe vdes nga uria, ndërsa pakica s'prek punë dhe ha, vishet, kurvëron, kryen veprimet më të paligjshme nga pikëpamja e krishterë, por që konsiderohet "e krishterë".

Ai përpiqet të kombinojë fetë botërore dhe praktikat morale në një model përgjithësisht të arritshëm të sjelljes morale dhe, natyrisht humbet, hallakatet përgjatë kësaj rruge, por shkon me kokëfortësi, çdo ditë, duke iu bindur urtësisë së madhe kineze: filloni të jetoni rishtas çdo ditë. Ai e kërkon këndvështrimin e tij mbi marrëdhëniet mes "Zotit dhe njeriut" dhe e gjen në faktin se personaliteti njerëzor është pjesë e Hyjnores dhe vetëm nëpërmjet dashurisë së këtyre pjesëve të vuajtura për njëra-tjetrën bëhet zgjerimi dhe bashkimi i tyre shpirtëror me të Tërën. Në këtë këndvështrim, tema e riprodhimit pushon së interesuari për të, siç nuk është i interesuar për temën e mbarështimit të lepujve. Por familja është krijuar për riprodhim. Dhe atij nuk i intereson familja. Ai ka shkruar tashmë "Lufta dhe Paqja" dhe "Anna Karenina". Ai ka thënë tashmë gjithçka për të. Më mirë se kushdo tjetër.

Dhe ja, pikërisht në këtë kohë shfaqet Tanjejevi. "Sonata e Krojcerit" përfton njëfarë mishërimi karikaturesk. Sigurisht, në "Sonata e Krojcerit" violinisti që ka shërbyer si prototip i xhelozisë së Pozdnishevit, nuk është i ngjashëm me Tanjejevin. Aty kemi një "njeri të vogël të pavlerë", një muzikant "gjysmë-profesionist", një "person gjysmë social". Tanjejevi ishte studenti më i mirë i Çajkovskit dhe profesionisti më i lartë në fushën e muzikës, dhe vetë ai ishte një kompozitor i shquar. Por mu sikur djalli t'i pështpëriste në vesh, Tolstoi i dha heroit në "Sonatën" e tij karakteristika jo mjaft "mashkullore". "Sy të lagësht në trajtë bajameje, buzë të kuqe të buzëqeshura, mustaqe të fiksuara, modeli më i fundit i flokëve në modë, fytyrë vulgare, të bukur, ajo që femrat e quajnë jo të keqe, konstrukt të dobët, megjithëse jo të shëmtuar, me të pasmet veçanërisht të zhvilluara... "

Tanjejevi e kaloi atë verë në një çardak të ndërtuar mbi sarajet e Tolstojve, luajti muzikë, luajtën shah me Tolstoin, kuvenduan përzemërsisht, por në të njëjtën kohë, pa e dashur as vetë këtë, Tanjejevi ia çmendi gruan. Sofia Andrejevna tregon në ditarin e saj se si doli në kopsht dhe bisedoi me të vdekurin (!) Vanjeçka, e pyeti: "A është e mbrapshtë ndjenja ime për Sergei Ivanoviçin. Sot Vanjeçka më largoi prej tij; me sa duket, atij thjesht i vjen keq për të atin; por unë e di se ai nuk më dënon; ai vetë ma dërgoi Sergei Ivanoviçin dhe nuk dëshiron ta largojë atë nga unë". Kjo ishte një çmenduri e përkohshme, e lidhur, me sa duket, me vdekjen, tash së fundmi, të djalit të saj dhe me faktin se ngjarjet që ndodhën përkonin me fillimin e periudhës kritike të menopauzës (e pranuar në ditar).

Të gjitha këto shënime në ditar datojnë nga 5 dhe 6 korriku. Dhe më 8 korrik, Tolstoi gatitet të largohet fshehurazi nga shtëpia dhe shkruan atë letrën e famshme për hindusët. Por bashkë me të ai shkruan dhe një letër të dytë. Si të parën, ashtu edhe të dytën, Sofia Andrejevna e lexoi vetëm pas vdekjes së burrit të saj. Tolstoi kishte mendjen dhe sensin e duhur moral për të mos e lënë gruan e tij në një kohë kur ajo ishte thellësisht e pakënaqur dhe e sëmurë shpirtërisht. Largimi i mbeti në kokë si një tjetër "draft". Sidoqoftë, L.N. i mbajti të dyja letrat dhe i fshehu nën lëkurën me ngjitëse të kolltukut në kabinet. Ky ishte një veprim shumë i çuditshëm. Ky akt do të thotë që Tolstoi thjesht e shtyu përkohësisht largimin e tij, duke e mbajtur përligjjen e tij me shkrim kur t'i vinte koha.

Në vitin 1907, Tolstoi i nxori të dyja letrat dhe ia dha N.L. Obolenskijt, burrit të së bijës, Mashës. Obolenskij pas vdekjes së Mashës ia dorëzoi këto letra M.S. Suhotinit. Hamendësohej se të dyja letrat do t'i dorëzoheshin Sofia Andrejevnës pas vdekjes së Lev Nikollajeviçit, gjë që u bë.

Pasi lexoi njërën letër, ajo e grisi menjëherë. E dyta, për hindusët, është ruajtur.

Është logjike të supozohet se letra e parë kishte të bënte me marrëdhëniet e saj me Tanjejevin. Në vitin 1910, kjo nuk kishte më kuptim. Letra e dytë përkon pothuajse

plotësisht në kuptim me atë që kishte lënë Lev Nikollajeviçi para se të largohej në vitin 1910 dhe që nuk hidhte as më të voglën hije mbi gruan e vet. Të dy letrat e paraqisnin largimin si një akt thjesht botëkuptimor.

Konflikti i korrikut 1897 nuk ishte e vetmja "prerje" në marrëdhëniet e bashkëshortëve në vitet '90, ndoshta dhjetëvjeçari më i vështirë në historinë familjare të bashkëshortëve. Në fillim të vitit 1895, pak para vdekjes së Vanjeçkës, i cili bashkoi babain dhe nënën e moshuar në pikëllimin e përbashkët, vetë Sofia Andrejvna ishte çmendurisht xheloze për Lev Nokollajeviçin ndaj botueses së re të revistës "Severny Vjestnik – Lajmëtari Verior" L.J. Gurjeviç.

"Severnij Vjestnik" ishte një nga revistat më të mira dhe më radikale të artit të viteve '90, ku bashkë me Çehovin, Leskovin dhe Gorkin, botonin dhe Sologubi, Balmonti, Gippius dhe Merezhkovski. Lindja e simbolizmit rus u zhvillua në këtë revistë. Tolstoi ra dakord me këmbënguljen e Gurjeviçit për t'ia dhënë novelën e tij "Padroni dhe punëtori i tij". Kjo e zemëroi tepër Sofia Andrejevnën!

Ajo nuk u pajtua deri në fund me faktin se nuk i ka më të drejtat për krijimtarinë e burrit të saj. Por nëse e kishte të vështirë t'u kundërvihej librave popullorë të "Posrednik" që dilnin nga shtypshkronja e Sytinit, atëherë vendimi i Tolstoit për t'i dhënë një gjë të re, të bukur dhe thjesht artistike një reviste mode, i dha asaj të drejtën morale ta dënonte për mospërputhje dhe vanitet.

Me sa duket, në negociatat me Tolstoin, Gurjeviçi nuk hezitoi ta tërheqë atë me sharmin e saj femëror. Dhe kjo më në fund e bëri Sofia Andrejevnën të dilte jashtë vetes. Tjetër gjë ishin Çertkovi dhe Birjukovi me librat që kushtonin qindarka të entit "Posrjednik", mbi të cilët nuk mund të fitosh para. Por "intrigantja Gureviç, gjysmë çifute, vazhdimisht lypte diçka për revistën e saj në një mënyrë të zgjuar lajkatare". Ditari i Sofia Andrejevnës në fillim të 1895 vlon nga zemërimi. Në të njëjtën kohë, ajo kupton se burri i saj ka shkruar një "rrëfim të mrekullueshëm". Gruaja e Tolstoit kishte shije të mira letrare. Vlerësimet e saj për krijimtarinë e L.N., të shpërndara nëpër letra dhe ditarë, janë pothuajse gjithmonë të sakta. Dhe ky "tregim i mrekullueshëm" i del duarsh dhe Sofia Andrejevna është bash në proces ribotimi të Vëllimit XIII, ku do të donte të përfshinte aty "Padroni dhe punëtori i tij". "Lev Nikolajeviçi para tani nuk merr më për veprat e tij. Atëherë, ta kishte botuar libër të thjeshtë e të lirë te "Posrjednik-u", në mënyrë që i gjithë auditori të kishte mundësinë të lexonte - këtë unë do ta kuptoja. Ai nuk ma dha ta përfshija në vëllimin XIII, thjesht që unë të mos mund të merrja para shtesë; po pse ia jep vallë Gurjeviçit? Më kaplon tërbimi dhe po kërkoj rrugë që të veproj me drejtësi në raport me publikun, jo për të kënaqur Gurjeviçin, por për inat të saj. Dhe një rrugë do ta gjej".

Xhelozisë editoriale i shtohej xhelozia dhe pakënaqësia e zakonshme femërore, që burri i saj nuk donte t'i nënshtrohej për asgjë.

Por Tolstoi e kishte marrë tashmë vendimin e tij, që familja nuk do të përfitojë më nga krijimtaria e tij e re. Nga njëra anë - kokëfortësia mashkullore, nga ana tjetër - mosgatishmëria për t'u pajtuar, çoi në faktin se më 21 shkurt 1895 në Moskë, Tolstoi shpalli edhe një herë vendimin e tij për t'u larguar nga shtëpia përgjithmonë. Duke gjykuar nga ditari i Sofia Andrejevnës, Gurjeviçi ishte shkaku i fundit i konfliktit. "Ljovoçka ishte aq i zemëruar sa vrapoi lart, u vesh dhe tha se do të largohej nga shtëpia përgjithmonë dhe nuk do të kthehej."

Është kurioz reagimi i Sofia Andrejvnës për këtë. "Papritmas më shkoi në mendje se kjo ishte vetëm njëra arsye, por që në të vërtetë Ljovoçka donte të më linte për ndonjë arsye më të rëndësishme. Mendimi për një grua më erdhi para së gjithash."

Atë e mundonte xhelozia, xhelozia dhe sërish xhelozia. Dhe çfarë reagimi i menjëhershëm! "Kam humbur çdo pushtet kontrolli mbi veten time dhe për ta penguar atë të më linte më herët, unë dola vetë e para në rrugë dhe vrapova në korsi. Ai më ndoqi. Unë isha vetëm me rrobdëshambër, ndërsa ai, me pantallona pa bluzë dhe një jelek. M'u lut të kthehesha, por unë kisha një mendim fiks - të vdisja në një mënyrë ose në një tjetër. Qava dhe më kujtohet që bërtisja: të më çojnë në komisariat, në çmendinë. Ljovoçka më tërhoqi zvarrë, rashë në dëborë, këmbët i kisha zbathur në këpucë, vetëm me një këmishë nate nën një fustan".

Në këtë kohë, Vanjeçka përpushej në ethe, djalit të tyre i kishin mbetur vetëm dy ditë jetë.

Disa vjet më vonë, Sofia Andrejevna do ta përshkruajë vdekjen e djalit më të vogël në kujtimet e saj "Jeta ime" dhe ky kapitull i titulluar "Vdekja e Vanjeçkës" do të jetë, ndoshta, vepra e saj më e mirë. Ky rrëfim autobiografik është në një nivel me veprat e të shoqit. Përshkrimi i funeralit të Vanjeçkës, i cili u preh në varrezat Nikolskoje afër fshatit Pokrovskoje pranë varrit të vëllait të tij, Aljoshës, është i mrekullueshëm me një portret të mahnitshëm të Tolstoit. Ky portret përbëhet nga disa fragmente, secili prej të cilëve i jep ngjyrë të re përshkrimit të gjendjes së brendshme të burrit të saj, një filozof dhe predikues fetar, i cili papritur u përball me një pyetje të pazgjidhshme: si të sillet me vdekjen e djalit të tij të dashur? Si ta kuptimësojë këtë në ato horizonte të pabesueshme universale ku shpirti dhe mendimi i Tolstoit fluturonin? Si ta varrosnin trupin e djalit, nëse gruaja e tij nuk e kishte varrosur sipas ritit ortodoks, të cilin Tolstoi e mohoi?

"E varrosëm Vanjeçkën. E tmerrshme - jo, jo e tmerrshme, por një ngjarje e madhe shpirtërore. Faleminderit Atë. Faleminderit!". Dy javë më vonë, Tolstoi e kupton vdekjen e Vanjeçkës si "të gëzueshme", "të mëshirshme", "zbulimi i gënjeshtrave të jetës, duke sjellë një ngjarje më pranë Tij". Në të njëjtën kohë, ai shkruan për gruan e tij: "Sonja ende vuan dhe nuk mund të ngrihet në lartësitë fetare ... Arsyeja është se ajo futi të gjitha fuqitë e saj shpirtërore në dashurinë shtazore për fëmijën e saj të mendjes: ajo i vuri shpirtin fëmijës, duke dashur ta ruajë e mbrojë atë. Dhe ajo donte të ruante jetën e saj me fëmijën, të mos e shkatërronte jetën e saj jo për fëmijën, por për botën, për Zotin".

Këto ishin fjalë mizore.

... Në një mënyrë a në një tjetër, por vitet 1890 nuk na tregojnë asnjë lloj ftohjeje mes bashkëshortëve. Përkundrazi, ishte një periudhë shumë e nxehtë.

Tolstoi nuk ishte ai "hindu" konvencional, i cili është i aftë të heqë dorë nga bota dhe të shkojë në pyll. Ai ishte një njeri kompleks rus, i fortë dhe i dobët, kokëfortë dhe sentimental, i mençur dhe xheloz, i butë, delikat dhe ndonjëherë mizor deri në një pikë të pashpjegueshme.

Përsa i përket Sofia Andrejevnës, gjendja e mendjes dhe shpirtit të saj në vitet '90 nga një këndvështrim i papritur karakterizon novelën e saj, "Sonatën e Krojcerit" të saj me titull "Faji i kujt?" (1892-1893).

(Vijon në faqen 15)

RUSANA HRISTOVA BEJLERI:

Duhet të përgatitemi për 100 vjetorin e lindjes së shkrimtarit Thoma Kacori (1922-2008)

Bisedë e Mimoza Hasani Pllana me albanologen e njohur bullgare



Marrëdhëniet ndërkulturore në mes shqiptarëve dhe bullgarëve janë të hershme, madje janë të njohura nga koha e Perandorisë Osmane. Ndërsa, në kohën e Rilindjes Kombëtare, Sofja bëhet një nga qendrat e mëdha të diasporës shqiptare, ku organizonin veprimtari të ndryshme, shoqëritë atdhetare si: "Dëshira" (1893), e cila përmes revistës në gjuhën shqipe "Kalendari Kombiar" (1897) botonte materiale letrare, kulturore, fetare dhe politike, tek shtypshkronja "Mbrothësia", misioni i së cilës ishte shtypja e librave në gjuhën shqipe me destinim tokat shqiptare. Më vonë edhe revista "Drita" ku promovoheshin idetë, veprat letrare të rilindasve shqiptarë. Nga gazetat e botuara në këtë qendër është e njohur "Shqypeja e Shqypnisë". Pas pavarësisë së Shqipërisë, veçojmë ngjarjen më të madhe, organizimin e kurseve të para të gjuhës shqipe në Universitetin e Sofjes "Shën Klimenti i Ohrit" (1962), të mbajtura nga atdhetari i shquar korçar, Thoma Kacorri. Ndërsa, në vitin 1994, me themelimin e degës së Ballkanistikës, në Fakultetin e Sllavistikës, arrihet deri te zyrtarizimi i mësimit të gjuhës dhe letërsisë shqipe, krahas gjuhëve tjera ballkanike. Mbështetje të madhe, zhvillimit të programit të gjuhës shqipe në Universitet, i dha ballkanologia e njohur bullgare, Prof. Petja Asenova. Ndërsa, brezi i ri i profesorëve të gjuhës dhe letërsisë shqipe, nga ajo kohë dhe sot, janë: Prof. Dr. Rusana Hristova-Bejleri, më vonë Prof. Dr. Anton Pançev dhe së fundi Prof. Dr. Ekaterina Tarpomanova. Brezi i ri i profesorëve, përveç zhvillimit të programeve universitare, ka arritur që të përkthejë në gjuhën bullgare veprën e mbi 50 autorëve shqiptarë, nga zhanri i poezisë, prozës, dramës, si dhe të trashëgojë pasionin për përkthimin tek studentët, që shprehin interesimin e shtuar për gjuhën dhe letërsinë shqipe.

Mimoza Hasani Pllana: E nderuar profesoreshë Hristova Bejleri, a mund të na tregoni si e mësuat gjuhën shqipe dhe si vendosët të studioni për gjuhën dhe letërsinë shqipe deri në nivelin më të lartë akademik?

Rusana Hristova-Bejleri: Kam mbaruar gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Shën Peterburgut në vitin 1992. U nisa me bursë të Radio Sofjes, për programin në gjuhën shqipe. Atje gjeta një ambient nxitës dhe mbështetës në të gjitha nivelet: në grup ishim tetë veta, te gjithë të motivuar, ndër të cilët më i njohur u bë albanologu prof. Aleksandër Novik. Pedagogët tanë ishin të ndjerat Desnickaja, Voronina dhe Ejntrej, zonja me kulturë, përgatitje të thellë shkencore dhe me aftësi pedagogjike të jashtëzakonshme në mësimin e shqipes si gjuhë të huaj. Që kur ishim studentë u përfshimë në një atmosferë shqipdashëse, që i përkiste si Tiranës së mbyllur ende, ashtu edhe Prishtinës, ku kemi bërë kurset e para në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare.

M.: Kurset e para të shqipes në universitetin e Sofjes "Shën Klimentï i Ohrit", ku punoni aktualisht, filluan në vitin 1962, ndërsa zyrtarizimi u bë në vitin 1994. Prej asaj kohe, deri më sot kontributi juaj në mësimin dhe zhvillimin e programeve të shqipes është i madh. Sa ishte sfidues gjithë ky proces i gjatë?

R.H.B.: Lektorati i gjuhës shqipe, si lëndë fakultative u themelua në vitin 1962 nga gjuhëtarët e famshëm të gjuhësisë së përgjithshme, që ishin edhe ballkanologë. Ata u bënë nxënësit e parë të zellshëm të shkrimtarit Thoma Kaçorri. Në vitin 1994 nën kujdestarinë e prof. Petja Asenovës u themelua dega e Ballkanistikës, në të cilën shqipja zuri vendin e merituar, të barabartë me gjuhët e tjera të Bashkësisë Gjuhësore Ballkanike – rumanishtja, greqishtja dhe bullgarishtja. Aktualisht studentët kanë në program deri në 600 orë të shqipes për 5 vitet e studimit dhe 90 orë ligjerata të letërsisë shqiptare. Ata që dëshirojnë mund të zhvillohen edhe më tutje në doktoraturë, shkallë për të cilën sistemi aktual në vendin tonë, është shumë i favorshëm në kuptimin e vendeve dhe të bursave.

M.: Shteti bullgar nga fundi i shek. XIX, fillimi i shek. XX dhe tutje është i njohur për kontributin e jashtëzakonshëm, që fillimisht dha për krijimin e shtetit shqiptar, më pas për zhvillimin e gjuhës dhe letërsisë shqipe, përmes shoqërive të njohura atdhetare, kulturore, si: "Drita", "Dëshira", më vonë edhe "Gjergj Kastrioti". Sa ruhet vepra e të gjitha këtyre shoqërive në institucione bullgare, a ka interes për këtë veprimtari nga studentët e gjuhës dhe letërsisë shqipe?

R.H.B.: Arkivat bullgare janë të pasura me materiale. Madje sipas kolegëve akoma nuk janë studijuar shumë faqe arkivore. Bojka Sokollova, Thoma Kacori dhe Elena Atanasova janë marrë me historikun dhe trashëgiminë e organizatave shqiptare në Bullgari. Revista "Kalendari Kombiar" e botuar në Sofje në fund të shekullit XIX para një viti u ribotua e plotë nga fondacioni ALSAR në Tiranë, mund të shkarkohet edhe në formë elektronike dhe akoma pret studiuesit e saj.

M.: Prej themelimit të Katedrës së Gjuhësisë së Përgjithshme, Indoeuropiane dhe Ballkanike, në kuadër të së cilës mësohet gjuha dhe letërsia shqipe, universiteti i Sofjes "Shën Klimentï i Ohrit", u bë urë komunikimi në mes të kulturës bullgare dhe asaj shqiptare. A keni gjetur mbështetje nga Qeveritë e Shqipërisë, Kosovës për promovimin dhe zhvillimin e shqipes, kuptohet si gjuhë dhe letërsi, në këtë qendër të njohur ballkanike?

R.H.B.: Në fakt Katedra e Gjuhësisë së Përgjithshme daton shumë para se të merrte edhe ngjyresën e saj ballkanike. Ajo përgjigjet për lëndën në fjalë jo vetëm në fakultetin tonë, por në gjithë fakultetet e tjera ku është pjesë e programit. Sa për kontaktet, duhen falenderuar fillimisht organizatorët dhe administratorët e Seminarit të Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqiptare në Kosovë, të cilat pranojnë çdo vit një numër të konsiderueshëm pjesëmarrësish nga vendi ynë, të cilët janë kryesisht studentë dhe doktorantë të Universitetit tonë. Me Shqipërinë kemi pasur për dekada marrëveshje ndërshtetërore për pjesëmarrje në Seminarin e gjuhës shqipe në Univeristetin e Tiranës. Është e udhës të falenderoj kolegët, që ky bashkëpunim u zgjat edhe jashtë marrëveshjes zyrtare dhe tani jemi në nivelin e shkëmbimit në programin Erasmus.

M.: Përveç punës në universitet, emri juaj është bërë i njohur edhe përmes veprave albanologjike dhe letrare që krijuat. Në librin "Letërsia shqipe si pasqyrë e shpirtit të popullit", pasqyroni një thesar letrar të shqipes, si u prit libri nga lexuesit dhe sa ka interes lexuesi bullgar për letërsinë shqipe?

R.H.B.: Libri u botua kryesisht për të ndihmuar studentët me një tekst akadamik. Do të dëshiroja të besoja se ka pasur shumë lexues të tjerë, por ka pak të ngjarë, sepse tregu i librave është shumë konkurrent në fusha të ndryshme.

M.: Gjatë karrierës suaj albanologjike, keni publikuar dhjetëra punime studimore për gjuhësinë dhe letërsinë shqipe.

Veçojmë këtu, jo rastësisht, studimet krahasimtare të letërsisë shqipe dhe asaj bullgare, po marrim sa për ilustrim përqasjen që keni bërë në mes shkrimtarit shqiptar Migjeni dhe atij bullgar Hristo Smirnenski, a mund të përmendni elementët e përbashkëta letrare, që keni parë te këta dy autorë?

R.H.B.: Migjeni me Smirnenskin kanë poezi që trajtojnë motivin e varfërisë ekstreme në kohën kur jetojnë, që shpërfaqen me figura çuditërisht të afërta, vjershat ngjasojnë edhe nga ana tingullore dhe këtë e kanë vënë re vetë studentët gjatë leximit të poezive në përkthim. Migjeni është përkthyer në bullgarisht nga Marina Marinova, në një mënyrë shumë poetike dhe librit që ekzistonte vetëm në Bibliotekën Kombëtare i dhamë një jetë të re duke e vendosur në internet.

Russana HRISTOVA BEJLERI, në vitin 1986, mbaroi studimet në Kolegjin Anglez në Sofje, më 1991 mbaroi studimet në Filologji shqipe në Universiteti Shtetëror të Shën Peterburgut në Rusi, ndërsa studimet doktorale i mbaroi më 1995 në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Tiranë. Në vitin 2000 fillloi punën në Universitetin e Sofjes "Sh. Kl. Ohridski"si profesoreshë e gjuhës dhe letërsisë shqipe ku punon edhe sot. Nga viti 2013-2017, drejtoi Departamentin e Gjuhësisë së Përgjithshme në Universitet, ndërsa nga viti 1991-2000 punoi në Radion Bullgaria në emisionin në gjuhën shqipe. Përveç si ligjëruese, Hristova Bejleri është e njohur përmes punimeve (mbi 50 të tilla) të shumta shkencore në fushën e letërsisë dhe albanologjisë dhe librave letrarë: Letërsia shqipe si pasqyrë e karakterit kombëtar Sofje 2009, Fjalori frazeologjik ballkanik (bashkëautore) Tiranë 1999, Albanian Identities (bashkëautore) Sofje, 2000. Po ashtu, ka përkthyer veprën e shumë autorëve shqiptarë në gjuhën bullgare, ka krijuar dhe mirëmban faqen e interneti për albanolgojinë në Bullgari www.albanianbg.com.

M.: Bashkë me studentët tuaj keni realizuar ekspedita universitare tanimë në fshatin e vetëm të banuar me shqiptarë, Mandrica. Si zhvillohet jeta në këtë fshat, sa është e ruajtur gjuha shqipe, sa është ndikuar gjuha shqipe nga gjuha bullgare dhe çfarë e karakterizon këtë fshat të banuar ende me shqiptarë nga fshatrat bullgare?

R.H.B.: Në Mandricë kemi shkuar disa herë me studentët. Fshatarët janë pak, 58 banorë gjithsej sipas statistikës, pa llogritur fëmijët e tyre që kanë dalë nga fshati. Njëri prej tyre, Ivajlo Petrov, ka themeluar Shoqatën e Rilindjes së Mandricës, ka investuar paratë e tij personale në ndërtimin e hotelit dhe në ringjalljen e disa zanateve si p.sh. pjekja e tullave karakteristike etnografike.

M.: Në listën e veprimtarisë suaj gjejmë të renditur pjesë nga vepra e më shumë se 20 autorëve shqiptarë që keni përkthyer në gjuhën bullgare. Sa vlerësohet letërsia shqipe në Bullgari në raport me letërsitë e vendeve të tjera ballkanike?

R.H.B.: Autorët e përkthyer janë mbi 50, për të cilët kemi punuar në projekte të përbashëta me studentët. Kryesorja është që letërsia shqipe të jetë e pranishme në internet në gjuhën bullgare dhe njerëzit e interesuar, por edhe specialistët të kenë mundësi për ta shfrytëzuar, pra të kenë akses. Ëeb faqja funksionon nga viti 2004 dhe më gëzon fakti se shpesh e gjej të përdorur në punime të ndryshme.

M.: Si mendoni, a studiohet letërsia shqipe e përfshirë në kontekstin akademik ballkanik?

R.H.B.: Po, letërsia shqipe është lëndë më vete, por edhe në kuadrin e shkencës letrare krahasuese ballkanike. Universiteti ynë është ndër vatrat akademike, e cila me kalimin e viteve zhvilloi një kapacitet të pavarur shkencor në fushën e albanologjisë, ku ka patur vëmendje të shtuar edhe për letërsinë shqipe, për autorë dhe tekstet të ndryshme letrare. Kjo ka ndodhur ngadalë, me formimin e specialistëve të rinj, që u afirmuan edhe në fushën e tyre të preferuar të specializuar, më në thellësi të problematikave, edhe në shqipe.

M.: Duke qenë se kanë kaluar 20 vjet që kur punoni me studentë, a mund të na thoni cilat janë motivet më të shpeshta që i shtynë ata të studiojnë një gjuhë dhe letërsi, në këtë rast shqipen, jo shumë të njohur në Europë?

R.H.B.: Studentët tanë mësojnë në degën e Ballkanistikës dhe motivi i tyre është të mësojnë disa gjuhë ballkanike përnjëherë. Duket shumë joshëse për të rinjtë. Kur e kuptojnë në kurriz se 3 gjuhë janë shumë, thellohen në njërën prej tyre. Profilizimi i mëtejshëm nuk është institucional, por intuitiv, i bazuar në interesat e tyre dhe këtu gjejmë edhe shpresat tona që orientohen në fushën e shqipes më shumë sesa drejt gjuhëve të tjera.

M.: A mund të na tregoni për projektet tuaja aktuale në lidhje me gjuhën dhe letërsinë shqipe?

R.H.B.: Duhet të përgatitemi për 100 vjetorin e lindjes së shkrimtarit Thoma Kacori (1922-2008). Besoj të përgatisim së bashku një studim të thelluar për jetën dhe veprën e tij me ndihmën edhe të bashkëshortes Violeta Kacori.

(Vijon nga faqja 13)

Në faqen e titullit të dorëshkrimit shkruhet: "Faji i kujt? Në lidhje me "Sonatën e Krojcerit" të Lev Tolstoit. Shkruar nga gruaja e Lev Tolstoit. Tashmë bie në pah njëfarë teprimi. Përmendja e dyfishtë e emrit të burrit, fillimisht si shkrimtar dhe më pas si bashkëshort, të lë të kuptosh se Sofia Andrejevna e shihte këtë novelë me një sy të dyfishtë, si një polemizuese dhe si gruaja e Tolstoit, që dëshiron t'i vërtetojë diçka të shoqit. Për herë të parë "Faji i kujt?" u botua mbi njëqind vjet pas shkrimit të tij, në 1994 në revistën "Oktjabër". Por ka pasur lexime shtëpiake të fragmenteve të novelës.

Nga pikëpamja letrare, "Faji i kujt?" - është një vepër aspak e dobët. Por në këtë vepër, shumë gjëra të vënë në siklet. Të shohësh "Sonatën e Krojcerit" të Tolstoit nga ajo perspektivë që e kishte parë Sofia Andrejevna, do të thotë të mos e shohësh asfare. Aty ku burri i saj u krodh në hon, gruaja e tij ngarendi nëpër sipërfaqe të zgripit të këtij honi dhe bërtiti: "Epo ja, jo të gjithë kërcejnë në hon!"

Gjëja më interesante e novelës nuk është kuptimi i saj filozofik dhe psikologjik, por një qëndrim i papritur ndaj burrit të saj dhe historisë së martesës së tyre. "Faji i kujt?" doli të ishte një përgënjeshtrim jo i "Sonatës së Krojcerit", por i historisë së dashurisë së Kitit dhe Levinit në "Anna Karenina", e cila zakonisht merret si një prototip shembullor i historisë së dashurisë së të riut Lev Nikollajeviç me Sofia Andrejevnën. Rezultoi se atë që Tolstoi e shihte në një dritë, gruaja e tij e shihte në një dritë tjetër.

Shkurtimisht, subjekti i novelës është si më poshtë.

Vajza ideale Anna, me të cilën princi tridhjetë e pesë vjeçar Prozorskij është trupërisht i dashuruar. Princi i propozon dhe martohet me Anën. Por shpejt e kupton se ajo që e tërhoqi imagjinatën e tij të shthurur për një muaj mjalti me një grua tetëmbëdhjetëvjeçare, del në fakt si një mërzi dhe një gjendje e dhimbshme e një gruaje të re. Ai është i dhënë pas bujqësisë, ata kanë fëmijë. Ishte një goditje e tmerrshme për Anën të mësonte se para martesës princi kishte një dashnore - fshataren Arina. Kalojnë dhjetë vjet. Miku i tij i vjetër, Dmitrij Aleksejeviç Behmetjev, vjen për të parë princin. Është kthyer nga jashtë, ku jeton me bashkëshorten, me të cilën nuk ka harmoni. Ky është një njeri i sëmurë, por i ndjeshëm, filozof, artist, etj. Natyra delikate e Behmetjevit e tërheq Anën dhe ai vetë tërhiqet prej saj. Princi është jashtëzakonisht xheloz. Ndërkohë, Behmetjevi po vdes nga veremi dhe tani, duke synuar të largohet përgjithmonë nga atdheu, mbledh miqtë në çifligun e tij për t'u dhënë lamtumirën. Aty mbërrin edhe Ana, por pa burrin e saj, i cili është në grindje si me gruan e tij, ashtu edhe me Behmetjevin. Behmetjevi i kërkon Anës të hipë në kaloshinën e tij dhe udhëton rreth e rrotull rrethinave me të, duke kuvenduar në heshtje dhe asgjë më shumë. Kur Ana kthehet në shtëpi, princi i tërbuar, në kokën e të cilit ishin pikturuar skenat më të pista gjatë mungesës së saj, i hedh një prerëse të rëndë letre që e godet në tëmth duke e plagosur për vdekje. Duke vdekur, Ana ia bën me dije princit pafajësinë e saj të plotë dhe e fal vrasësin.



Është e lehtë t'ia qëllosh se kush është prototipi i Behmetjevit. Ky është një mik i ngushtë i familjes Tolstoi dhe fqinj me ta, Leonid Dmitrieviç Urusovi, një nga "tolstojanët" e parë. Ai ishte një njeri jashtëzakonisht i sjellshëm dhe inteligjent që adhuronte mësimet e Tolstoit; ishte i pari që përktheu traktatet e tij "Në çka është besimi im?" në frëngjisht dhe "Përmbledhja e shkurtër e Ungjillit". Gruaja e Tolstoit, të gjithë fëmijët, madje edhe shërbëtorët, e nderonin me gjithë zemër. Gruaja e Urusovit parapëlqeu të jetonte në Paris, ku ndonjëherë e vizitonte burri i saj. Urusovi vdiq nga tuberkulozi në 1885, në Krime, në prani të një djali të vogël, Sergeit. Për më tepër, ishte Tolstoi që shoqëroi mikun e tij të vetmuar në Krime.

Sofia Andrejevna ishte platonikisht e dashuruar me Urusovin. Në të njëjtën kohë, ajo ia kushtoi novelën Fetit (Afanasij Fet – poet i famshëm rus i shek. XIX), i cili vdiq në vitin që pati nisur të shkruhej novela "Faji i kujt?". Marrëdhënia e Sofia Andrejevnës me Fetin është një histori e veçantë romantike e mbushur me poezi dhe ndjenjë delikate. Besnikëria martesore e gruas së Tolstoit është, sigurisht, përtej dyshimit më të vogël. Dyshimi shkaktohet nga zemërimi dhe përbuzja me të cilën përshkruhet Princi Prozorskij në novelë, prototipi i të cilit ishte Tolstoi.

Sapo pa Anën, ende një vajzuke, princi provon menjëherë ndjenjat më të ndyra karshi saj: "... ai ia zhveshi mendërisht kofshët e saj të holla dhe gjithë trupin e saj të virgjër, elastik e të fortë". Ai thotë me vete: "Duhet, po, nuk kam qare pa e shti në dorë këtë fëmijë." E gjithë kjo nuk përshtatet aspak me dashurinë e Levinit për Kitin, në të cilën L.N. ofroi modelin e tij të historisë së martesës me Sofia Andrejevnën.

Shkakton tronditje edhe karakterizimi i princit si mendimtar. "Ai ka udhëtuar shumë, ka çuar një rini të stuhishme, të gëzuar, qe i lodhur nga gjithçka dhe u vendos në fshat, duke u dhënë pas filozofisë dhe duke e imagjinuar veten si një mendimtar i thellë. Kjo ishte dobësia e tij. Ai shkruante artikuj dhe shumëkush mendonte se ishte vërtet shumë i zgjuar. Vetëm njerëz të ndjeshëm dhe shumë të ditur e panë se në thelb filozofia e princit ishte shumë e mjerë dhe qesharake. Ai shkroi dhe botoi artikuj në revista që nuk kishin asgjë origjinale, por ishin një përzierje temash dhe mendimesh të vjetra, të huazuara, të një numri mendimtarësh të kohëve antike dhe moderne. Përzierja u bë me aq zgjuarsi, sa shumica e publikut i lexoi ato, madje me njëfarë entuziazmi dhe ky sukses i vogël e gëzoi pafund princin ..."

Karakteristikat e princit, domethënë të Tolstoit, janë përgjithësisht të tmerrshme. Nëse kemi të bëjmë me vështrim, atëherë ai është sigurisht "brutal", nëse vendoset në një hotel, atëherë patjetër merr një dhomë "të ndyrë".

Përkundrazi, të gjitha karakteristikat e Anës, domethënë të autores, mbivlerësohen në mënyrë sipërane. Kjo nuk është një grua, por një Madonna. "Idealet më të larta të fesë dhe dëlirësisë." "Me shijen e saj karakteristike artistike, ajo e godiste dhomën e saj aq bukur dhe në mënyrë origjinale me gjëra të ndryshme të sjella prej saj dhe të dhuruara nga princi, saqë princi mbetej i mahnitur me shndërrimin e saj". "Nga një vajzë e hollë, ajo është zhvilluar në një grua jashtëzakonisht të bukur, të shëndetshme dhe energjike. Gjithmonë energjike, aktive, e rrethuar nga katër fëmijë të bukur e të shëndetshëm ... " "Ajo ishte e bukur në indinjatën e saj: fytyra e saj e rregullt dhe e zbehtë frymëzonte energji dhe pastërti, dhe sytë e saj të errët dukeshin edhe më të errët dhe më të thellë nga shprehja e tyre e hidhur." Princi është "cinik" për gruan e tij. Në fakt, ai vazhdimisht e dhunon fizikisht, duke mos përjetuar as interesimin më të vogël për anën shpirtërore të personalitetit të saj. Dhe për këtë arsye ajo mendon: "Vërtet vetëm kjo është thirrja jonë femërore, që nga shërbimi me trup për foshnjën e saj, të kalojë tek shërbimi me trup për burrin e saj? Dhe kjo është e alternuar - përgjithmonë! Ku është jeta ime? Ku jam unë? Unë që vërtet aspiroja dikur për diçka të lartë, për t'i shërbyer Zotit dhe idealeve?" Dhe këtu shfaqet Behmetjevi.

Kjo është e njëjta temë që qe ngritur edhe në "Sonatën e Krojcerit", veçse tanimë e parë nga një këndvështrim femëror. Por të mos harrojmë se "Sonata e Krojcerit" është monologu i një personi thellësisht të sëmurë dhe të rrënuar mendërisht, siç është Pozdnishevi. Sidoqoftë, novelën e shkruajti Tolstoi i shëndetshëm mendor. Paradoksi i novelës "Faji i kujt?" qëndron në faktin se është shkruar në një gjuhë rrëfimtare klasike, por në të njëjtën kohë të lë një ndjenjë deliri të tmerrshëm.

E vetmja pikë e dobët e Anës është se ajo është xheloze. Dhe me gjithë neverinë që përjeton nga marrëdhënia me të shoqin, ajo e ka tmerrësisht frikë largimin e tij nga familja. Për të parandaluar këtë largim, ajo është gati për çdo gjë. "Ajo vendosi me të gjitha forcat që ta mbante burrin e saj, të kërkonte ato mënyra dhe mjete me të cilat të mund ta tërhiqte përsëri dhe ta mbante në familje. Ajo i dinte në mënyrë të paqartë këto mjete, ato ishin të neveritshme për të, por ç'gjë është më e mirë?"

Xhelozia e saj për gruan fshatare Arina dhe për të gjitha gratë me të cilat princi pati marrëdhënie para martesës, merr, ndonjëherë, një karakter të dhimbshëm mazohist, "dhe më pas marrëdhënia e saj me burrin u bë krejtësisht e panatyrshme". "Ndonjëherë, e skuqur dhe e shqetësuar, ajo kërkonte prej tij t'i tregonte histori për bëmat e tij të mëparshme seksuale." "Ana i kujtonte të gjitha ato që kishte bërë për të mbajtur burrin e saj dhe u ndje e neveritur, i erdhi krrupë nga vetja."

Pra, autorja e kësaj novele e kuptonte se arsyeja e marrëdhënieve jonormale në shtëpi nuk ishte vetëm te princi. Shfaqja e Behmetjevit dhe miqësia me të janë të rëndësishme për Anën, pikërisht sepse Behmetjevi është, si të thuash, një qenie pa seks. Ajo nuk e shqetëson instinktin e tij seksual të "bishës", që ndrydhet nga sëmundja dhe ai nuk ia ngacmon asaj dhimbjet e xhelozisë, nuk e bën të çmendet. Behmetjevi është i sëmurë, ai nuk do të jetojë gjatë. Behmetjevi është *një njeri i vdekur*, por një *mik i gjallë*.

Novela "Faji i kujt?" është një dokument i vlefshëm për të kuptuar dramën reale e jo të shpikur letrare, të gruas së Tolstoit. Kjo novelë u krijua si një hakmarrje letrare. Ajo u përpoq ta "kthente" "Sonatën e Krojcerit" nga ana e saj së prapthi (e errëta) në anën e saj të përparme (të ndritshme). Novela frymon mirësjellje dhe moralitet, në kontrast me të tmerrshmen, magjepsësen dhe shkatërruesen për nga fuqia e ndikimit të novelës së të shoqit.

Ajo donte të shkruante diçka për një grua ideale, e cila ishte në mëshirën e një demoni mashkull, më pas gjeti prehje në miqësinë me një mashkull-engjëll dhe u vra "kafshërisht" nga burri i saj. Por si rezultat, ajo shkroi një novelë nga e cila nuk është aspak e qartë: faji i kujt ishte pra? Dhe a ishte vallë faji i ndokujt?

LEGJENDA PËR ARTISTËT DHE MINISTRIN

tregim nga Adil Olluri

Ministri i kulturës në vendin tonë nuk ishte njeri i sertë. Ishte i dashur, i butë dhe i afërt me mjeshtrit e artit, aktorët, piktorët, shkrimtarët, muzikantët e të tjerët, edhe pse thënë të drejtën, pak, fare pak, për të mos thënë aspak, e kuptonte artin e tyre. Megjithatë, i donte, i vlerësonte dhe përpiqej t'iu ndihmonte aq sa kishte në thesarin e ministrisë që ai drejtonte.

Siç e donte rendi dhe detyra, por edhe ngritja e një imazhi prej dashuruesi të artit, ministri merrte pjesë në shfaqje teatri, ekspozita e promovime librash të shkrimtarëve të njohur. Në të tilla ngjarje, artistët dhe krijuesit e rrethonin ministrin, ishin sy e vesh përballë tij. Secili përpiqej të ishte sa më pranë ministrit, t'i fliste e ta ftonte në një kafe, drekë apo të merrte pjesë në shfaqjen, ekspozitën a përurimin e veprës së tij. Thuhej se njëri nga shkrimtarët tanë më të njohur, që shquhej për afërsinë me secilin ministër që vinte dhe e shante secilin ministër në prag të përfundimit të mandatit, kishte vuajtur dy javë ditë rresht që ministri i tashëm nuk kishte pasur mundësi të vinte në përurimin e veprës së tij të radhës. Nuk kishte dalë nga shtëpia me ditë të tëra, nuk kishte pirë kafe me miqtë për dy javë ditë rresht. Thjesht, ishte ndier i braktisur nga ledhatimi i përhershëm ministror. Kishte bindjen se kur te dilte në kafene, miqtë do t'ia përmendnin mosardhjen e ministrit, do ta ngushëllonin dhe do t'i thoshin se ti vlen më shumë e fjalë të tjera miradije, që mund të rridhnin nga një bisedë ngushëllimtare. Pikërisht këtë gjë nuk e honepste shkrimtari ynë. Të qenit i ngushëlluar se po braktisej ose mund të braktisej nga pushteti i tanishëm ishte diçka që nuk do ta pëlqente në asnjë rast. Në këtë rast, më shumë se kurrë, shkrimtar ynë e urrente ngushëllimin dhe të gjitha fjalët dashamirëse që mund të rridhnin prej tij.

***

Njëri nga aktorët tanë më të njohur nuk linte rast pa qenë afër ministrit, qoftë para fillimit, qoftë pas përfundimit të premierave të shfaqjeve teatrore. Shfaqej sa hap e mbyll sytë në kokteje rastesh në teatrin kryesor të Prishtinës dhe bëhej sy e vesh për t'i dëgjuar fjalët e ministrit për shfaqjen e sapopërfunduar, pa marrë parasysh në do të këtë luajtur apo jo në të. Më shumë i interesonte dhe e bënte kureshtar mendimi i ministrit për një krijim artistik, se sa i kolegëve të tij të zanatit, aktorëve e regjisorëve, si dhe i kritikëve të teatrit, që lëviznin sa djathtas e sa majtas në foajenë e teatrit. Ata i bënin këto lëvizje për t'i parë dikush atypari, gjithsesi edhe për t'i pyetur rreth shfaqjes së dhënë. Por, aktori ynë i madh nuk e qante kokën për kritikët dhe njerëzit e teatrit, ai e kishte hallin se si ta merrte vlerësimin dhe miratimin e ministrit. Asgjë nuk e gëzonte më shumë se sa fjalët e thëna nga goja ministrore.

Je artist i madh! Je nderi i atdheut! Kombi ynë është krenar me ty!- ishin fjalët e

zakonshme, të njëjtat me pikë e presje, dhe të çdohershme të ministrit, që nuk harronte t'ia thoshte pas secilës shfaqje aktorit tonë të madh. Ia thoshte të njëjtat, pa ndryshuar gjë, madje as radhitjen e fjalive. Nuk kishte aspak gjasa dhe asnjëherë nuk ndodhte që ministri ynë ndonjëherë të fillonte me "Je nderi i atdheut! Je artist i madh! Kombi ynë është krenar me ty!" ose me "Kombi ynë është krenar me ty!" dhe të vazhdonte me pjesën tjetër të frazës lëvduese. Por, ministri assesi dhe në asnjë rast nuk e harronte renditjen e përhershme të fjalive. Aktori ynë i madh ende pa e përfunduar mirë pyetjen: "I dashuri ministër, si t'u duk...?, përfaqësuesi i pushtetit, pa një pa dy, ia priste me përgjigjen majegjuhe: "Je artist i madh! Je nderi i atdheut! Kombi ynë është krenar me ty! Dorën në zemër, edhe aktori ynë i madh e shtronte pyetjen e njëjtë, të zakonshme, pa e ndryshuar as më të voglën presje, dhe kishte dëshirë ta dëgjonte përgjigjen e njëjtë e të përhershme sa më shumë, sa më shpesh dhe sa më kumbueshëm. Dorën në zemër, kishte një pakt të pashkruar mirëkuptimi në mes të aktorit të madh dhe pushtetarit, sepse nuk mund të ndodhnin krejt rastësisht pyetjet dhe përgjigjet e sinkronizuara. Dyshimet për një pakt të tillë shtoheshin edhe më shumë kur pyetjet dhe përgjigjet e tilla, të njëjta e të njëpasnjëshme, bëheshin pikërisht kur rreth shtetarit kryesor të kulturës mblidheshin ajka e njerëzve të teatrit. Pikërisht për këtë e përmbushnin dhe e përplotësonin shpirtërisht aktorin tonë përgjigjet e ministrit, veçmas kur ato ishin të kumbueshme. Kumbimi e kënaqte jashtëzakonshme, sepse zëri i lëvdatës ministrore kishte gjasa të mëdha të arrinte te dyshimtarët e artit të tij skenik. Sa herë që ministri i thoshte këto fjalë, aktori ynë i madh i shikonte në sy kritikët për t'iu dhënë mesazhin e dukshëm: "E shihni vogëlsira, unë e kam miratimin dhe mbështetjen e hierarkisë së lartë shtetërore. Kush iu pyet më juve?! Dyshimet për një kod mirëkuptimi mes aktorit tonë të madh dhe ministrit binin poshtë m'u në çastin kur pushtetari në fjalë të njëjtat fjalë, pa ndryshuar pikë as presje, ua thoshte edhe aktorëve të tjerë të teatrit kryesor të Prishtinës. Ministri ynë brenda një mbrëmje të koktejit i shpallte gjysmën e aktorëve tanë "artistë të mëdhenj që e nderojnë atdheun, me të cilët krenohej i tërë kombi."

***

Piktori ynë i madh rrallëherë shkonte në ekspozita pikturash. Gjithmonë gjente arsye për të mos shkuar në ekspozitat e kolegëve të tij të zanatit, qofshin ata moshatarë të tij, më të rinj apo më të moshuar. Përjashtim bënin vetëm ekspozitat ku njoftohej se do të vinin ministri dhe ajka e politikanëve të vendit. Në këtë rast, piktori ynë i madh ngrihej vetëtimthi dhe shfaqej i tëri dhe i bëri në të tilla ngjarje. Jo vetëm që ngrihej vetëtimthi, por piktori ynë fluturonte për të arritur sa më parë aty, përkundër gjashtëdhjetë e shtatë vjetëve të tij. Hapi-hapin nuk ia zinte për të qenë sa më parë në këto ndodhi artistike, në të cilat pushtetarët nuk ishin aty vetëm në cilësinë e shikuesit dhe dashamirësve të artit, por edhe në atë të folësit dhe promovuesit të artistëve të caktuar. Kështu që, piktorit tonë të madh nuk mund t'i ikte ekspozita e një kolegu të tij më të ri në moshë, i cili sapo ishte anëtarësuar faqe botës në partinë që ishte në pushtet. Andaj, në ekspozitën e veprave të tij nuk kishte si të mos merrte pjesë ministri dhe fytyra të njohura pushtetarësh. Nuk e humbte dot këtë rast piktori ynë. Të ulurit në karriget e pushtetit, përkundër që shaheshin kafeneve nga artistët, dorën në zemër, ishin fytyrat më të dashura për ta. Mund të thuhet pa hamendje se çdo i dyti artistë synonte t'i kishte në mbledhinë e tij, sepse pushtetarët i jepnin gazmend ndejës dhe tërhiqnin pas vetes mjetet e informimit dhe kureshtarë të ndryshëm, që bënin kinse vinin për vepra arti, por realisht vinin për t'u parë nga politikanët, për të dhënë tungjatjeta dhe për të marrë tungjatjeta nga gojët e politikës, për të shtrënguar dorë politikani gjatë përshëndetjeve e shumëçka tjetër, pos për art jo.

Piktori ynë i madh gjatë përshëndetjes së përzemërt e të zakonshme, natyrisht me fjalë të njëjta, siç edhe mund ta dimë, i erdhi një teshtitje që nuk mund ta ndalte, nuk mund ta kontrollonte. Ai teshtiu para ministrit të tij të dashur, të stërlavdëruar shumë e shumë herë, dhe qurrat e artistit gati sa s'ranë mbi këpucët e zeza të ministrit. Piktori ynë u përpoq ta nxirrte faculetën, por teshtima ishte më e shpejtë dhe nuk i dha as kohë e as mundësi ta fuste dorën në xhep. Kështu që, ai provoi ta kontrollonte teshtimën me duar, por nuk arriti dot, duke u mposhtur kështu nga vullneti i organizmit, i padëshirueshëm për njerëzit, për t'i nxjerrë jashtë sekrecionet. Pështyma dhe qurrat e verdha të artistit vezullonin pranë këpucëve elegante të ministrit. Ky i fundit u bë se nuk pa gjë dhe pa një pa dy shkeli pikërisht mbi to, duke i mbuluar me këpucët për të mos i parë askush nga të pranishmit. Ministri këtë e bëri për ta ruajtur piktorin tonë të madh nga talljet e mundshme të komunitetit, në rast se dikush tjetër do ta shihte atë pamje qurrash, që nuk ishte më e madhe se dy pika ujë, por që do të mjaftonte të bëhej kryefjalë e gazit për javë të tëra e atyre që jetonin vetëm për t'i përqeshur të tjerët. Por, fatmirësisht askush nuk pa gjë dhe për këtë gjest gjithsesi se duhet lavdëruar ministrin.

Më fal, ministri im i mirë! Më fal, për besë! Isha i ftohur, siç e sheh, por nuk mund të

mos vija, t'iu shihja e t'iu përshëndesja. – fliste e përgjërohej në kërkimfaljen e pandërprerë piktori ynë i madh. Ai ishte i zbehur dhe i zverdhur në fytyrë, si një meit, që pa fije gjaku e vullneti qëndronte në këmbë para ministrit.

Mos e vrit mendjen për këtë punë! Ti je artist i madh! Ti je nderi i kombit! Pikturat e

çunit tonë më pëlqyen shumë. Si t'u duken ty, mjeshtër?- ministri ynë me një buzëqeshje të lehtë e me fjalë dashamirëse përpiqej t'i jepte kah tjetër bisedës dhe ta shpërqendronte piktorin e madh nga ndjesia e fajit, por ishte veprim i kot. Mjeshtri i pikturës sa vinte e skuqej. Nuk i zihej vendi-vend, ndihej i turpëruar përballë pushtetarit të rëndësishëm, që i kishte premtuar se do ta mbështeste në ekspozimin e pikturave të tij në një qytet të rëndësishëm europian.

- Më fal, ministri im i mirë! Nuk e bëra me qëllim. Ka dy ditë që më mundon ky grip i përdreqtë dhe nuk mund ta ndalja veten. Siç të thash, erdha vetëm të të shihja e të përshëndesja ty, sepse nuk isha në terezi.- piktori ynë i madh i përsëriste për të dytën e të treten herë kërkimfaljet dhe sqarimet e njëjta dhe ministri provonte që ta shmangte shfajësimin e mjeshtrit, që thënë të drejtën edhe e çmonte.

- O mjeshtër i madh, edhe po të bëje me qëllim, nuk më ngelet hatri mua. Unë e adhuroj punën tënde dhe nuk mund të flas ndryshe me ju, përpos nga këndi i një adhurimtari të zakonshëm. –ministri ynë duke u munduar ta pajtonte dhe ta qetësonte piktorin e njohur, e shqetësojë edhe më shumë. "Edhe po ta bëje me qëllim" e ministrit e vuri në dyshime mendjen e tij lëndimtare. Ai tash ishte në hamendje se mos ministri mund të dyshonte se do të mund ta bënte me qëllim. Këtë gjë e ziu në kokën e tij me ditë të tëra.

- Një ndihmëtar i madh i artit nuk e meriton një sjellje të tillë, një pakujdesi të tillë të pafalshme nga ana ime. – kërkimfaljet, arsyetimet, sqarimet e njëjta vazhduan derisa pranë ministrit erdhën piktorë të tjerë të njohur e riosh për ta marrë përshëndetjen e duarshtrëngimin e ngrohtë ministror. Piktori ynë i madh, i thyer dhe i lënduar sa më s'ka, iku në shtëpinë e tij. Nuk u përshëndet thuajse me asnjë të pranishëm në ekspozitë dhe mori taksinë që priste afër galerisë së madhe të Prishtinës dhe iku duke e vrarë mendjen se si do ta trajtonte ministri tash e tutje.

Piktori ynë i madh pas dy ditësh mori zemër dhe u nis drejt zyrës së ministrit.

Nuk ka kënaqësi më të madhe se kur këtë zyre shteti e viziton një njeri i madh, një

mjeshtër arti.- ministrit tonë të kulturës nuk ia shkonte kush në shpërndarjen e fjalëve të bukura. Ishte tejet i zhdërvjellët në gjetjen e fjalëve sa më madhështuese për njerëz të artit që e mbështesnin punën e tij apo për ata që përpiqej t'i joshte për ta mbështetur dhe për të mos kundërshtuar më rreth gjërave që synonte t'i bënte. – Kam biseduar me këshilltarët e mi dhe zyrtarët e tjerë dhe do ta bëjmë një ekspozitë europiane për pikturat e juaja, jo në një, por në dy kryeqendra europiane, sa që edhe piktorët e famshëm europianë do ta kenë lakmi.

Ministri im i mirë, nuk erdha sot për ekspozitën, por erdha të të kërkoj sërish falje për

atë që ndodhi në galeri. Ndihem jashtëzakonisht i turpëruar. Nuk di se si të shprehëm. Nuk e di a mjaftojnë fjalët

e ndjesës sime.- duke folur dhe duke u përgjëruar gati sa nuk ia krisi vajit piktori ynë i madh.

Të lutëm, mjeshtër i madh! Harroje atë gjë! Mos e mendo më asnjëherë. Gjëra që ndodhin. Të kam thënë edhe në atë mbrëmje.

Nuk e di se ç'mund të bëj që ta shpaguaj këtë turp që më gërryen nga brenda.

Nuk ke nevojë të bësh gjë! Është gjë që nuk ia vlen të flitet më për të.- insistonte

ministri ynë që ta tejkalonte këtë bisedë, që thënë të drejtën nuk i pëlqente aspak.

Jo, jo, ministri im i mirë, dua të bëj diçka që të jem rehat me veten. Dua të ta bëj një

nder, një shpagim sado të vogël, që të ndihem mirë me veten.

E po, meqë insiston të ma bësh një nder dhe meqë me të mund të ndihesh më mirë,

të lutëm, ta shkruash një artikull në gazeta e portale të shumta rreth punëve të mëdha dhe të mira që janë bërë gjatë mandatit tim, veçmas në fushën tuaj. Kjo lutje e imja është për të të lehtësuar nga kjo barrë e panevojshme dhe për të të bërë të ndihesh mirë, siç e the edhe vetë.

Me gjithë qejf, ministri im i mirë. E bëj me vullnetin tim më të madh.- për herë të

parë i buzëqeshi fytyra piktorit tonë të madh. Ai doli i gëzuar nga zyra shtetërore dhe pas dy ditëve në shumicën e portaleve vlonte shpërndarja e artikullit autorial të piktorit tonë të madh, që mbante titullin "Ministri që e ringjalli kulturën tonë".

***

Poeti ynë i talentuar P.N., protestonte i vetëm para dyerve të Ministrisë së Kulturës në sheshin kryesor të Prishtinës. Kishin kaluar më shumë se dy muaj dhe atij nuk i kishte shkuar huq asnjë ditë e protestës së tij vetmitare. Ai zgjohej me rrezet e para të diellit të mëngjesit, bëhej gati, hante ose nuk hante fare mëngjes, herë krihej e herë jo, dhe pa u bërë ora tetë shfaqej para godinës ministrore. Aty i shihte tek hynin në vendin e tyre të punës thuajse të gjithë zyrtarët e ministrisë. Disa prej tyre i përshëndeste përzemërsisht, ndërsa disa të tjerë i thumbonte sa herë që i shihte dhe sa herë që i linin mundësi për ta shprehur mllefin ndaj tyre. Ndërkaq, me ministrin, kundër të cilit protestonte, poeti ynë i talentuar ishte shumë i matur, gojëmbël e dashamirës. Tri herë ishte ulur pranë tij ministri (natyrisht në prani të kamerave dhe fotografëve), për t'i shtjelluar çështjet dhe problemet që e revoltonin të talentuarin tonë. Tri herë ishte zotuar i pari i ministrisë që do t'i shqyrtonte hallet e ankimtarit të përditshëm, por asnjëherë nuk ia kishte shqyrtuar dhe as që i kishte përmendur ato me vartësit e tij, ndërsa ky i fundit as nuk ishte ankuar për mosmbajtje premtimesh dhe as nuk e kishte ndalur protestën e fikallvetshme.

Poeti ynë i talentuar P.N., protestonte i vetëm para dyerve të Ministrisë së Kulturës në sheshin kryesor të Prishtinës. Ishte i indinjuar thellësisht në një komision qeveritar që nuk ia kishte dhënë shpërblimin e parë për veprën më të mirë në poezi për vitin paraprak. Këtë shpërblim ia kishin dhënë një poeti tjetër, i talentuar gjithsesi, i cili ishte rival i përbetuar i poetit tonë të dashur. Kjo i kishte shtuar peshë indinjatës së tij, gjë që kishte kulmuar në protestë të përditshme.

Në një ditë prej ditësh, dyerve të godinës ministrore ia kishte mësyrë edhe një grup prej pesëdhjetë artistësh e krijuesish, mbështetës të opozitës, për të protestuar ndaj veprimeve dhe vendimeve që ata cilësonin si jo të mira. Kishin ftuar thuajse të gjitha mediet e vendit, kishin shkruar parullat dhe i mbanin në duar. Parullat ishin të thurura bukur, dorën në zemër, siç dinë të bëjnë vetëm artistët e krijuesit. Kamerat dhe fotografët e shumtë ishin përballë tyre dhe donin ta zinin secilin çast të protestës së bukur, siç e quanin mendimtarët e krahut opozitar në vendin tonë. Para se të niste, bënin thirrje që sa më shumë artistë, krijues e dashamirës të artit t'i bashkoheshin protestës estetike, siç donin ta cilësonin, sepse ministri tashëm, sipas tyre, ishte shkatërrimtari më i madh i artit dhe kulturës në Kosovë.

Kjo protestë nuk doli ashtu siç pritej. Ajo përfundoi ende pa ia nisur mirë. Me ta marrë fjalën prijësi i protestës, regjisori i talentuar K.K., që t'i falënderonte të pranishmit, të bashkëngjiturit në kauzë, dhe ta shtjellonte dhe arsyetonte qëllimin e protestës, prapa shpinës së tij krisi anti-protesta e poetit tonë të talentuar P. N.

Hajdutë! Jeni hajdutë! ç'kërkoni këtu, o hajdutë! Që njëzetë vjet e keni zhvatur

buxhetin e kësaj ministrie. Nuk keni lënë gjë pa bërë.- ishin britmat e njëpasnjëshme e të pandalshme të poetit tonë të talentuar, që ishte stacionuar në vend-protestimin e tij pak hapa para protestuesve të tjerë, kolegëve të tij, që zejen e të qenit protestues nuk e kishin të zhvilluar. Ishte hera e parë që protestonin.

Të lutëm, qetësohu! Ne nuk të pengojmë ty, as ti mos na pengo neve dhe jemi në

rregull.- përpiqej ta merrte me të mirë poetin tonë prijësi i protestës.

Ju jeni artistë të korruptuar! Ju nuk jeni të denjë për të protestuar. Jeni mbështetës të

krimit të organizuar. Poshtë krimi njëzetvjeçar!- nuk ndalej me britmat e pandërprera poeti ynë i talentuar. Donte që me çdo kush ta zhvlerësonte protestën që bëhej pak metra përballë tij.

Pusho, o dështak! Pusho, o idiot! Ti a je protestues apo servil i ministrit? Ç'dreqin je?- u

acarua për të parën herë prijësi i protestës, regjisori i talentuar K. K. Tashmë nuk e duronte dhe ia kthente të sharat e njëpasnjëshme protestuesit vetmitar.

Unë jam artist, ju jeni kriminelë!- poeti ynë nuk ndalej në ofendimet ndaj kolegëve të

tij të zanatit. Një gjë e tillë tashmë i kishte acaruar ata tejmase. Më nuk shfaqnin fije konsiderate ndaj poetit tonë të talentuar.

Po të ishe protestues, do të duhej të ishe mes nesh, jo në anën e ministrit. Por, ti nuk je

protestues. Ti je servil, ti je mut!- shfryhej regjisori ynë dhe tashmë goja e tij ishte shthurur bukur shumë. Plaste nga inati që protesta po merrte tatëpjetën dhe po zhvlerësohej në mënyrën më të keqe të mundshme. Sharjet ndaj poetit tonë të talentuar u lëshuan edhe nga protestuesit e tjerë. "Ti je mut, ti je servil, ti je dështak, ti je psikopat!"!, ishin sharje që vinin e shpeshtoheshin dhe tashmë protesta kundër ministrit ishte shndërruar në një protestë kundër protestuesit të vetmuar.

Ministri me këshilltarët e tij e shikonin protestën prapa perdeve të dritareve të godinës ministrit dhe shquheshin gazit nga akuzat, sharjet dhe shfryrjet e mllefit mes artistëve, që dorën në zemër tashmë e kishin humbur betejën me eprorët e ministrisë. Artistët e zhgënjyer me dështimin e protestës së tyre nuk kishin mundur ta bënin zap mllefin e tyre dhe e rrahën, e shqelmuan dhe grushtuan, bukur fortë protestuesin e vetmuar. Edhe pse i rrahur e i shqyer vetullave nga grushtet e kolegëve të tij, poeti ynë i talentuar doli fitimtari i vetëm i ditës. Ai u bë i stërnjohur dhe i stërdashur për një pjesë të madhe të qytetarëve dhe një zotërues i hapësirës protestuese apo më mirë të themi zotërues i të protestuarit. Ai tashmë shihej si një protestues i licencuar, i pranuar edhe nga pushteti dhe pa lejen a miratimin e tij tash e tutje vështirë se do të mund të protestonte kush para dyerve të ministrisë.

E NJËJTA HËNË

Poezi nga Dan Ibrahimi

dikush

dikush
nga një vrimë kohe
se ku
më vështron
e ndiej ritualin e përhershëm
që luhet diku
me mua
amza e krijimit të tij
fryt i ndërgjegjes
si një frymë
më përshkon
në kërkim
skutave të mendimit
kujtimeve dhe fantazive
e ndiej si më ndjek me uri
nga një vrimë kohe
dikush

një dalldi

një dalldi
si stuhi diellore
për nurin e saj
ma zë frymën
ajo vjen online rrallë
shumë rrallë
sa kalon portën
poreve më ndizet
një zjarr
oh ç'flakë bilur
për dy sy
më ngjizet retinës
si xixa unuri
sa dua t'ia zë mollat
me dorë
del nga linja
pas ma lë në sy
eshkën e ndezur
një dalldi

ah...!

ah
sa bukur hapërove
fushëndrrës sime
se ku nga bota paralele
me engjëllin përbri
shikim verbues në orën e gabuar
më ra si yll në sy
kur u zgjova
fushëkoha ime e njëjta
në djegie prore këtej
ah...!

kujdes

kujdes
është kohë e njëtrajtshme
të gjitha sëmundjet
të gjitha filozofitë
të gjitha dashuritë
një katalizator
një zot
një hipnozë
një diagnozë
me nje test
bota merr frymë me një respirator
kohë e njëtrajtshme
kujdes

një ditë

një ditë
pasi të ngopet pranvera
dhe vera të rrëshqasë e vluar
edhe vjeshta me rrebe
dhe dimri mrrolan
të sillen rrotës
me yje të mërdhezur
dhe hënën e kafshuar
pranverës tjetër
do të mbjellim lule
për çdo fjalë
për çdo varg
...një ditë

po më thonë

po më thonë
shiko si u bëmë ikona
të netëditëve të përflakura
pa vënë dorën në zjarr
o Zot çfarë korbash
po e hanë diellin rreze për rreze
si petulla flije
ag e terr
bëhu edhe ti hora
po më thonë



NATË E ETHSHME

Poezi nga Mara Venuto

Përktheu Dashamir Malo

Shkëputur nga vëllimi poetic Gjuha e qytetit
Mara Venuto është pjesëmarrëse e Takimit Ndërkombëtar Poetik "Trirema e Poezisë Joniane", Sarandë Tetor 2021.

* * *

Përparon nata dhe thyen dhëmbët.
Një goditje dhe përsëri në këtë kohë ujku
që përgjum gjenë e gjallë
ndërsa unë me sytë katër vështroj lart.

Fjalët janë gjëlpëra pastaj këngëza,
një lutje dorëzimi pa kushte
kërkon
sa dënime, cilat dashuri të shkëmbesh.

Ecim mbi tokë si krrimba të vegjël,
kemi besim
shpëtojmë po ne vetë
gërmojmë qorrazi derisa ja deti.

Çfarë mbetet nga vrima pas goditjes së fundit
 të lopatës,
në dheun e hapur para se fara të bjerë?
Një tjetër stinë për të na thënë çfarë bën,
drita e agimit e njohur prej kundërmimit.

Në lëkurën e braktisur të gjarprit
gjendet jeta e një moshe të pjekur.

* * *

Harrojmë muret e rrënuara, plagët e qytetit,
floknajën e barit që askush nuk e ka shkulur prej brimave,
dregëzat mbi mol, ujin e njelmët,
një denzifektim për të gjallët.

Harrojmë qiejt e vrenjtur të mbrëmjes
fenerët e udhëve këto drita të teknologjisë njerëzore,
një grusht orësh për t'u mbrojtur
prej diellit të qetë dhe mashtrues.

NATE E ETHSHME

Rrëzohet në tokë prej zgripit të një humnere
butësia përvëluese në të cilën kam lindur
foleja e placentës shqyer me dorë.

Prej nga nuk guxon të vështrosh janë ligjet
që kanë bërë vetë njerëzit, kanë varrosur parqet,
frutat e përhapura si një batanije poshtë pemëve.

Nata vjen, vjen e ethshme,
askush s'e pret.

Lëviz një gisht, pastaj bulën e veshit,
rrënjën e errët të flokëve,
dhe gjithçka përreth vdekjes së ëndrrës,
çlirimi i rraskapitur i qarjes së parë.

Shpirti im shpirt kafshe e plagosur
që i përket dhe arratiset prej gjuetarëve,
rron kur armiqtë i kanë sytë të mbyllur
vdes në udhëkryq prej turmës së kalimtarëve.

ERA DO TE NDRYSHOJE

Digjemi prej shirokës
me kripë për të mbuluar gojën.
Do të ndryshojë era dhe do të flasim,
do të kemi mëshirë për tokën e largët
nën presionin e rrymave. Do të jetë e mundur
me pranu të gjitha në paretet e stomakut
një rrethak pa ringjallje dhe pa përdëllesë.

Do të jemi vetëm ne,
arkat më të thella të kumbimit
që jeta ndërmend, nuk do të na falë
sado që arsyet turbullojnë sytë.
Prej një gjembi, marrë kushe di se ku,
do të na therin gishtat,
një organ i huaj,
një kujtim.

GJUHA E QYTETIT

Nëpër ura fillimi ndërmend fundin,
vargu fillon atje ku mbrin,
në mes drita bie dhe
struket në prehrin e nënës.
Nuk ka rritur bij, i ka lënë në terrin e rrugës
në flakët e vatrës, më i egri prej vatrave.
Ata jetimë dashurojnë si Zoti vetë,
nuk mbajnë mend, mëshirojnë,
shkrujnë mbi pluhur gjuhën e qytetit.

* * *

Shndërrohemi në deltë lumi
në fjalë të hedhura në shtatë pika të horizonitit
peshkim i humbur ku
askush nuk dëshiron ta kërkojë.
Mban fjalë zie
goja që mundet dhe nuk di t'a thotë,
një ngjalë kujton, gjigante dhe e ngushtë
kur kalon mllefi i pashpallur mes duarve.

Vetëm, mbi moçal rend
një burrë, peshkon krimba të brishtë
në më të shumtën e kohës gjuan arin dhe armiqtë
duke u hedhur nëpër gropa.

* * *

Bie nata në rruginën e ngushtë
ku kalohet si shenjetorët
me krahët e dorëzimit në kryqin e gjoksit.
Kundërshton ndjenjën e panevojshme
poshtë zotërisë që thotë falenderim ose vdekje.

Zbulon jetën duke u zhvendosur nga një vend në tjetrin,
në qorrsokakun e deriçkës së fshehtë të detit.
në zbrazëtinë e kësaj që ka qënë
kur askush nuk kishte një emër,
emrin dhe kush e quan,
të pafajshëm në barkun e nënës.

* * *

Zëri ynë është shkruar në muret e qytetit
jehona është një hije prej uji të rrafshët
dëgjojmë të moshuarit për të na dhënë të drejtë
tek njëri tjetri shfaqet një dashuri
e padukshme që netëve lind heonj.

Në gjumë drita e zbehtë në ballkone
 është një projektim i flokëve të virgjër,
një zonjë braktis veten mbështetur në kripën e detit,
por askush nuk e lut.

Besnikë të riteve të thella nyjet e padukshme
zbresin në ezofag dhe shfaqin jetën kështu siç është,
një komplot i qëndrushëm i viteve që ikin rrufe.

* * *

Kërcëllitja mbi shina dhe gjuha e të gjallëve,
poshtë karrelit të ndryshkur ku nuk vlejti as udhëtimi
që bëmë.
Të vdekurit kanë frikë, janë hija e të harruarve
pushojnë atje ku nuk ndjejnë dhe nuk dëgjojnë,
hapësira e tokës është e ngushtë, si krahu i një fëmije
të mitur.

Ajëri që kalon ngjall besim, dhe nxehtësinë e ujit në ballë
në dimër ngrin shiroku, mundi është një faj
mbi copat e çelikut duke na pasqyruar ashtu siç jemi.

* * *

Lëkura është portreti i stinëve,
vera na harron, mbyt xhixhivallet
poshtë këmbëve lakmitare buzë detit.
Është vështirë të jesh fëmijë
të përdorësh maskë për të parë humnerën
dhe pastaj të shkridhemi siku jeni humanë.
Koha sjell jehonën e të qeshurës nga bregu
komandon duart e rreshkura prej ujit,
për të larguar me kripë luspat tona.

* * *

Nuk ka rrugë që të mund të më lidhi me qytetin
në rrokje që mbarojnë. Ushtrime të panevojshme
fjalët e pakta të ligështisë sime,
paftësi për të thënë atë që do të duhej,
një frymëmarrje pa gulçime. Më kujtohet
kur në agshol ktheheshim në port
vagona të salduar me çelik në trupin e nënës.
Binarët e hekurudhës i vështronim nga lart,
krahë dhe këmbë të shtrembëra,
gjymtyrët e një shpirti që shkëputen.
Vitet duhet të na bëjnë të ndjehemi të plotë,
dhe nuk ishim më ne,
ishim të tjerë.

* * *

Çfarë nuk di
fjalët që nuk njeh
lënë tek ty dyshimin,
një dritare gjysmë të mbyllur mbi një humnerë
me shkurre.
Ajo skamje për t'u shlyer
do të doja që të ishte zëri im, asgjë
për të gjelbëruar tokën në shkurt.

Shikoni pasiguritë
ankthin e humbjeve
ndërsa shquhet poshtë syve një fole milingonash
dhe bëhet e nëndheshme jeta.

Një gojë prej nga ku dilet tekembramja shfaqet
përtej murit të kufirit
midis copave të tokës ku jemi mysafirë
për t'iu lutur hirit,
për të ditur përherë si insktet, ku me shku.



Mara Venuto është poete, romanciere dhe dramaturge italiane. Jeton dhe punon në Jug të Italisë. Debutimin e saj e bëri në vitin 2008 me përmbledhjen me tregime të shkurtra dhe monologje me titull Lexo mendimet e mia, e ndjekur kjo përmbledhje nga disa romane dhe vepra të shumta si autore dhe bashkautore.

Ajo ka punuar me disa gazeta, duke shkruar për lajme, sport, kulturë dhe tema shoqërore. Redaktore dhe fantaziste në Itali, ajo ka redaktuar dhe mbikëqyrur botimin e disa romaneve të njohura.

Në vitin 2016, ajo publikoi monologun teatral Monstra (finalist në Mario Fratti Aëard 2014, një çmim i dramës italiane i dhënë në Neë York).

Ka botuar dy vëllime poetike me titujt "I papërshkueshëm nga uji" dhe "Ky pluhur shpërndahet nga era" (Enti botues @ Casa Editrice & Libraria). Vëllimi "I papërshkueshëm nga uji" në vitin 2014 u vlerësua me Honourable Mention në Piero Alinari International Poetry Prize. Disa nga tregimet dhe poemat e saj kanë fituar çmime letrare kombëtare dhe ndërkombëtare dhe janë botuar në antologji të ndryshme.

Në dhjetor 2016 Monologu i saj teatral Monstra u vu në skenë me sukses nga grupi teatror Zërat e Detit. Drama të tjera të saj u vlerësuan me çmime të rëndësishme italiane dhe u vunë në skenë me sukses nga grupe teatrale. Poezitë e saj janë përkthyer dhe botuar në Poloni, Rusi, USA, në Indi etj.

KURRË S'DO TA KUPTOSH

Poezi nga Bruno K. Öijer (1951 -)

Përktheu Qerim Raqi

KURRË S'DO TA KUPTOSH

Ti kurrë nuk do ta kuptosh
se kur u largove unë qëndrova edhe më tutje aty
pranë barit të shtypur ku ishe ulur ti
e vura dorën
mbi barin e shtypur dhe ndjeva sikur
kisha më tepër nevojë të kujdesem për mungesën tënde
sesa për ty
më dukej sikur asgjë s' mund të kthehej
nëse do të kthehesh
ti do t' i prishje pushtimet e dhembjes
dhe ti kurrë nuk do ta kuptosh sa dhembshurisht dhe sa fuqishëm
fola me hijen tënde mbi barë
më dukej sikur unë që nga ai çast kisha dhembje për ty
sikur përpiqesha të mësohem
me atë që na pret të gjithëve
dhe se çmimi për të marr njeriu një mësim
është ndjenja e braktisjes
e cila që në fillim ka përjashtuar dhe rrënuar besimin
për një dashuri të qëndrueshme

PRANË TRYEZAVE NDRIÇUESE

qyteti që ti themelove akoma s' është gati
vetëm një skicë të tij
më ke treguar

por do të ketë vende të hapura
të pastrehët
do t' i kenë altaret me pamje kah dielli
lumenjët në mbrëmje do të
hipin nëpër autobusë
do të përzihen me të gjallët e të vdekurit

trafiku do të ndalet
kur dashuria të ecën hapur rrugëve
askush s' do të ketë nevojë ta rrudhë fytyrën
prej mendimeve e botëkuptimeve të sëmura

ka mbetur edhe shumë
për t' u bërë
por netët do të ulen pranë
tryezave të ndriçuara

dhe do të jetë qyteti yti
do të ketë ngjyrën e syve tu
mënyrën tënde të ecjes

KISHA TË FTOHTË

Unë kisha të ftohtë
Nuk kisha për çfarë të jetoja
Muajt bëheshin vite
kur unë kisha tërhequr
trupin tim më shumë kah vetvetja
Duhet të kemë pasur një rreze të kaltër
në fund të gjithë zezonës

Një hekurudhë
me lokomotivën e kthyer përpjetë
e rëndë dhe e ftohtë
e zezë
më e zezë se e zezë
qëndronte anash
dhe nga fundi
dolën anemona blu
të vogla dhe të brishta
duhet t'i kenë rritur
kallinjët e tyre
për të thyer
një qiell blu
për t'u rritur
gjithnjë e më lartë
dhe ta tërheqin përsëri trenin lart
ta vendosnin në shina
përsëri

VERË E PANJOHUR

Jetët tona ishin
fushqeta në ajër
ne pinim çfarë na ofronte dita
edhe sonte sikurse më parë
hijet kanë festë brenda në kokën time
vallëzimi mund të fillojë
realiteti cakërrohet si gota me gotën
por çfarë ishte e gjitha
çfarë donim me të vërtetë me jetët tona
çfarë ishte ajo më e rëndësishmja
burgu që rrënuam
u ngrit përsëri gjetiu
e ardhmja qëndronte si në një shtresë akulli
dhe bota shtyhej
do të kishte triumfuar në fund
nëse nuk do kisha mësuar ca gjëra
që të shtrydh
verë të panjohur nga mendimet e mia
një verë shumë të kuqe
që me siguri më ka dehur
më ka shpëtuar
dhe në ëndërr vapa ishte depërtuese
unë e hapa gardhin
i lëshova të dilnin jashtë ditët e mia të mbetura
unë rrija anash
i shikoja sesi loznin lirshëm në rrugë
duke e kaluar çdo pengesë
dhe duke rrëzuar çdo kalorës

E PAMUNDURA

hijet tona binin mbi dysheme
ishin më të bukura se ne
dhe nëse i besoj ditarit tim
ishte një natë me ty një natë më tepër

ishte para disa vitesh
nuk jemi parë më kurrë
por kur kaloj rrugës afër shtëpisë
ku banoje ti
më kujtohet dhoma ku qëndronim
dhe vrasë mendjen nëse hijet tona
janë aty brenda
nëse janë ngritur
dhe më në fund kanë bërë të pamundurën-
të jenë përqafuar

Ti erdhe tek unë
më dhembshurisht se rëndomtësia e jetës
ende e ndjej sesi kuptueshmëria e jetës hyri
në ty
me forcën e një kafsheje që i hape zemrën
më duhet ta pranoj se unë bëra përpjekje
të shërojë
atë që s´mund të shërohej
më duhet ta bind veten
se do vij një ditë kur unë nuk do të vuaj më
nga zbrazëtia që lamë pas
se do të vij një ditë
kur do mësohem të ndjejë një kënaqësi dhembje-gëzuese
të tërë asaj që humbëm
dhe do të dëgjoj frymëmarrjen tënde
hapat e tu që thërrasin pas shpinës
dhe unë të kthej kokën pas e të mos shoh asgjë
përveç më të fundmen hije të diellit perëndues
që përvijohet në mes reshë
dhe bënë që parku i braktisur nga njerëzit
të vetëtijë në ari të zverdhur
dhe magnezium ndriçues

*

nuk ekziston e vërteta
te njeriu
ai mund të dëshirojë që ta zbresin në det
apo hirin e tij ta ngrisin qiellit
mund të theret në gjilpërën e tij
t'i jap ushqim një qeni endacak
apo t'i vëjë zjarrin kopshtit të fqiut
mund të qëndroj lakuriq
por të hezitojë të shtrihet
në ëndërr mund të notojë mbi kangjella
apo të qajë në një shtëpi
që qeshë me secilën dritare
mund ta shohë manjolën duke lulëzuar
dhe ta ftohë pasqyrën me një shikim të akulltë
mund të thurrë heshtje në flokun e tij
dhe ta dëgjojë britmën e autostradës
mund të ketë lindur me një vrimë në zemër
ta ketë bartur një mall tërë jetën
me premtimin se do ta kërkojë një natë
por pa i dhënë shansin që ta hapte derën
të ketë qëndruar dhe të ketë trokitur në derën tënde
me grushta ere

*

rrugës për në shtëpi pas takimit me ty
në agun e hershëm të marsit
vura re se rrugët po afroheshin kah unë
dhe pothuaj po më kërkonin me një lloj
adhurimi nga xhelozia
unë ndalem dhe i lë të vijnë
i lë rrugët e zhveshura të ftohtat rrugë ngadalë
t' i shtrijnë duart kah unë
dhe të ngrohen në errësirën e dhomës tënde
të gjumit
që akoma
më mbështjell me yje të vegjël me tone blu
që dolën nga trupi yt kur ne
po bënim dashuri e ishim mbuluar me jorgan
ti i buzëqeshje nën balluke secilit yll
që zvetnohej në harqe drite duke rënë errësirës
dhe shuheshin në mua
gravoheshin në mua

TRASHËGIM

dëshiroj
që gjithçka të jetë ndryshe
dëshiroj që botëkuptimi im mbi botën
të shndërrohet në një gjësend të bukur të brishtë në duart e mia
si diçka e bërë prej qelqi më e hollë se ajri
dhe kur ta flakë tutje
të mos bartë hije
dëshiroj të harrojë
dëshiroj që dhembja e vuajtja të mos ekzistojnë
por dhembja është e vërteta
dhembja është dëshmi që ti ke jetuar
dhe ke ekzistuar këtu
dhembja nuk mund të blihet apo të shitet
dhembja nuk zbrapset për asgjë
jeta koha dhe një shoqëri e ftohtë akull
mund të t' i marrë të gjitha
të t' i vjedhë të gjitha
por askush s' mund të t' i marrë përjetimet
askush s' mund të të vjedhë dhembjen

MARRËZIA

marrëzia
ka vetëm një fytyrë
të njeriut
me marrëzitnë nuk mund të përleshesh
marrëzinë as s' mund ta luftosh
as ta ndalosh
ajo e shtrinë pushtetin e saj
zgërdhihet gjithandej errësirës së shoqërisë
botës mund t' i mungojnë shumë gjëra
por nuk i mungojnë ata
që hapin trurin vullnetshëm
dhe lejojnë të dhunohen nga të tëra marrëzitë e turpshme
ajo nuk njeh kufij
lëvizë më shpejtë se rruzulli tokësor
dhe mund ta bëjë një shtet të tërë
të rrudhet sa një apartament i pistë
ku muret rrjedhin idiotizëm
dhe kërkon që të jetë e dukshme
që ta duan të gjithë.

PUTHJA

Dr. Bledar Kurti

Romeo - Si një besnik i urtë, bëj një faj,
Po buzën e kam gati si fetar,
Me puthje të ëmbla, mëkatin të ta laj ...
Mëkat nga buza ime? Ç'fjalë e çmuar!
Ma jep prapë, të laj mëkatin e formuar.
Zhuljeta - Puthke mbas librit, si i mësuar!

Puthja e ka shoqëruar njerëzimin në çdo hap, simbol, kulturë, letërsi, pasion, tradhti si e ajo e Judës, e padyshim në art. E kryejmë këtë akt njerëzor çdo ditë, por kur ndalemi e mendojmë apo flasim për të, menjëherë përfytyrojmë veprën *Puthja* (1908), nga Gustav Klimt (1862-1918).

Kjo tablo, në formën e një katrori barazbrinjës prej 1.8 metra, e ndodhur në muzeun Belvedere të Vienës, është ndër më të njohurat në mbarë botën, dhe e bëri Klimt-in tejet të njohur pas mesit të shekullit të njëzetë. Ashtu si kjo pikturë edhe vetë krijuesi i saj ishte tejet i veçantë.

Në Vienën aristokrate, në vendin e saloneve të arta, e të atmosferës perandorake, Klimt vishej me sandale, mbulohej me një rrobë murgjish ngjyrë blu, të varë gjer tek këmbët, nuk mbathte të brendshme, dhe kishte një mjekër të trashë dhe me flokët tullë në majë të kokës. Por kjo ekstravagancë nuk ishte vetëm në paraqitje. Ai kishte një oreks të egër seksual dhe një magnetizëm fizik si edhe një "ndjesi të fortë kafshërore" dhe i përdorte femrat dhe modelet e tij si t'ia kishte ënda.

Klimt njihet si një ndër etërit e modernizmit vjenez dhe një shembull motivues për artistët e rinj në revoltën kundër vlerave të brezit të vjetër. Si një anëtar i *Lëvizjes Separatiste* në Austri, dhe pionier i simbolizmit, një zhanrë europian artistik i karakterizuar nga motive mistike, me një qasje personale ndaj arteve pamore dhe një estetikë e ngjashme me lëvizjet e artit të ri, të njohur si *Art Nouveau*, Gustav Klimt shpalosi një qasje avangarde ndaj pikturës. Stili i tij veçantë është i dukshëm në veprën *Puthja*, e cila u pikturua gjatë periudhës së tij të shkëlqyer e njohur si "Periudha e Artë".

Vepra *Puthja* përban dy figura, një mashkull dhe një femër, të mbështjellë në një përqafim të artë. Të dyja figurat janë të ndërthurura simbolikisht teksa përballen me humnerën e përsosmërisë. Figura mashkullore e dominon këtë tablo. Me plot forcë e pasion, mashkulli e shtrëngon me egërsi femrën, ndaj edhe figurat nuk janë në qendër të tablosë por janë të anuara në të djathtë të pamjes duke ilustruar dhunën pasionante të epshit dinamik të mashkullimit. Si një çift që bën dashuri plot pasion në cep të shtratit e jo të shtrirë ftohtësisht në qendër. Këmbët e femrës janë të varura tek skaji i greminës ndërsa dora e saj e djathtë mbahet tek qafa e mashkullit, i cili me ngjyrë të errët të lëkurës dhe flokëve e puth me egërsi.

Femra duket e dorëzuar. Ajo ka lëkurë të bardhë dhe buzë e mollëza kuqaloshe. Me pozën e saj erotike, me dorën e majtë që ledhaton dorën e mashkullit, dhe linjat trupore joshëse, ajo paraqitet si një pre seksuale. Asnjë vepër tjetër e mëparshme nuk mbart kaq shumë epsh. Asnjëherë më parë arti nuk e kishte shpalosur fytyrën e tij erotike si në këtë tablo. Kjo vepër e ilustron më së miri fjalën *dëshirë*, e cila vjen nga latinishtja *desidera*, që do të thotë, *mungesa e yjeve*. Pasi marinarët humbnin drejtimin në mes të detit kur netët ishin pa yje, ata endeshin kuturu pa asnjë orientim. Ai moment ishte *desidera*, pra përhumbje. Edhe kjo tablo është pa orientim yjesh, por një deklaratë e gjallë e pasionit, i cili të ysht edhe pse gjendesh në skaj të greminës. Ndaj edhe Klimt e titulloi këtë vepër *Dashnorët* dhe jo *Puthja*, pavarësisht se ne e njohim kështu.

Forca dominuese e mashkullit dallohet edhe nga mbulesa e fuqishme me blloqe drejtkëndore të zeza dhe gri, të cilat janë shenja falike mashkullore, që zbuten nga rrathët shumëngjyrëshe të veshjes së femrës, të cilat, ndryshe nga blloqet mashkullore shpalosen me forma rrethore motivesh të luleve të ndezura që shkrihen me linja që rrjedhin për nga lart. Veshja e femrës është e ngushtë, për t'u dalluar më mirë linja e trupit të saj. Nga rrobat e krijuara artistikisht rrjedh një shi i artë që bekon tokën pjellore poshtë tyre, me bar jeshil e lule shumëngjyrëse. Puthja është dashuri, na shpreh Klimt përmes kësaj vepre, dashuria është vetë natyra, ndaj edhe erosi është mëse i natyrshëm.

Për shkak të eroticizmit të dukshëm në këtë vepër, shoqëria post-viktoriane në Britani, e më gjerë, nisi ta konisderonte atë si pornografi, edhe pse figurat janë plotësisht të mbuluara. Por, pavarësisht kësaj tabloje epshore, qeveria austriake e bleu atë që përpara se të përfundonte, duke paguar një çmim prej 25,000 korona ($240,000 në ditët e sotme), ndërkohë që një vepër tjetër e Klimt, *Portreti i Adele Bloch-Bauer I* u shit në vitin 2006 me vlerën 135 milionë dollarë.

Vijmë tek sfondi i artë i tablosë. Jo vetëm mbulesa e përqafimit por edhe sfondi është prej ari. Në vitin 1903, Klimt udhëtoi dy herë në Ravena, Itali, ku pa mozaikët e *San Vitale*, të cilat me elementët e tyre bizantin ndikuan në krijimtarinë e artistit, në atë që njihet si "Periudha e Artë." Por frymëzimi nga veprat bizantine të rrethuara me ar vinte edhe nga e shkuara e vetë Klimt, i cili vinte nga një familje me baba dhe vëlla argjendarë. Interesimi i Klimt në periudhën bizantine simbolizonte gjithashtu edhe një lëvizje drejt një stabiliteti më të madh, përmes formave statike dhe jo organike: në kërkim të një strehe të eksplorimit artistik të fuqisë instinktive të Greqisë së lashtë arkaike.

Klimt tërhiqej shumë prej miteve dhe simboleve të Greqisë primitive, të cilat përfaqësonin jetën e instinktit dhe dëshirat përpara arsyes, ende të pakufizuara nga klasicizmi. Ndaj, sfondi i artë, duke mos treguar një kohë dhe një vend, simbolizon hapësirën dhe heqjen e kufijve të kohës midis primitives dhe modernes, duke unifikuar kështu instinktin bazë të njeriut, pa arsyen, thjeshtë dëshirat bazike dhe epshore të pacensuruara.

Parë në kontekst më të gjerë, Klimt jetoi në Vjenën e Sigmund Freud dhe nën ndikimin e tij përmes librit të botuar në vitin 1899, *Interpretimi i Ëndrave*, dhe me teoritë e tij të seksualitetit dhe psikoanalizës. Klimt duhet të jetë ndikuar edhe nga vepra e Nietzsche, *Lindja e Tragjedisë*. Këto ndikime të mendimtarëve të shquar të kohës vërehen tek veprat e Klimt-it në aspektin e shpalosjes iracionale të fytyrës së njerëzimit dhe përdorimit të formave seksuale si motive artistike.

Me të përfunduar vepra *Puthja*, Vjena kishte tashmë një princ të ri në art. Kjo tablo, ndryshe nga veprat e tjera të Klimt, që shkaktonin gjithmonë skandale, u prit me entuziazëm të madh dhe u shndërrua në simbolin e kryeqytetit austriak. Por, *Puthja*, prej dekadash të tëra, shkaktoi debate mbi qëllimin e artistit. A ishte ai në të? A është mashkulli në tablo përshkrim i autorit, dhe a është femra në atë pikturë dashnorja e tij e përhershme Emilie Flöge? Apo mos ndoshta Klimt e pikturoi këtë vepër si një alegori, një tablo univesale pasioni që shpalos instinktin njerëzor bazik?

Pas shumë spekullimesh, gjatë kohëve të fundit u botuan shënimet e një ish modeleje në salonin Flöge. Sipas saj Emile shihte tek piktura veten e saj dhe Klimt-in. Dhe gjithashtu doli në dritë një bllok



vizatimesh e vitit 1917 në të cilin gjendet një skicë e dy dashnorëve të përqafuar, dhe anash ka emrin "Emilie" të shkruar me gërma të mëdha.

Emilie, një stiliste veshjes, ishte dashnorja e artistit për njëzetë e shtatë vjet, por ata nuk u martuan kurrë. Gjatë të gjithë jetës së tij, Klimt mbeti një beqar plot pasion për femrat. Ai pati shumë lidhje me femra, zakonisht modele, dhe ishte baba i tre fëmijëve të cilët i mbështeste financiarisht. Pas vdekjes së tij, katërmbëdhjetë femra pretendonin se kishin fëmijë me të.

Në të gjitha tablotë e tij, Klimt i shpalos femrat me një natyrë tjetër nga ç'ishin përshkruar më parë. Dhe, kjo vinte edhe si rezultat i marrëdhënieve që ai kishte me to. Për shkak se nga njëra anë ai jetonte si beqar i vetëm me nënën dhe motrën, dhe nga ana tjetër si joshës pasionant ndaj femrave, figurat femërore në artin e tij përbajnë elemente mëmësie por nga ana tjetër përdorimin e tyre si objekt seksual.

Klimt i pikturoi femrat si *femme fatale*, krijesa joshëse dhe misterioze, me magjinë e të cilave zënë në kurth dashnorët e tyre, shpeshherë duke i drejtuar ata për nga situata të rrezikshme dhe vdekatare, ashtu siç vërehet edhe tek *Puthja*, në të cilën çifti është në buzë të greminës.

Gjatë jetës së tij, Klimt la 2,000 vizatime dhe skica, kryesisht nudo. Pasionet e tij të errëta shpalosen nga vizatimet e pozicioneve gjenitale frontale, lezbismi, orgjia, etj, që gjenden në to, duke na treguar tematikën pasionante të artistit në ndjekje të lumturisë erotike. Në të gjitha veprat e tij, femra paraqitet si objekt seksual, në dispozicion të mashkullit. Por, parë nga këndvështrimi feminist, shumë studiues e interpretojnë këtë liri dhe ekspozim të ekzagjeruar të trupit femëror si liri e atyre femrave dhe çlirim nga vargonjtë e moralit borgjez.

Pra, *Puthja*, është një instinkt primitiv pasioni midis artistit dhe të dashurës së tij, por nuk duhet harruar se nuk mund të arrijmë të gjejmë një ngjashmëri të Emilie në figurën e femrës, dhe aspak ngjashmëri të vetë Klimt-it në figurën e mashkullit, kësisoj kjo vepër mund të merret si një tablo alegorike, një simbol i pasionit të mbarë racës njerëzore. Vetë Klimt, u shpreh kështu:

Nuk ka asnjë autoportret timin. Nuk jam i interesuar në veten time si 'material për pikturë,' përkundrazi jam i interesuar te të tjerët, sidomos femrat, e madje më shumë edhe në fenomenet e tjera. Jam i bindur se *si person nuk jam aspak interesant. Nuk ka asgjë të veçantë për t'u parë në mua. Unë jam piktor, dikush që pikturon çdo ditë nga mëngjesi deri në mbrëmje.*

Ndaj vepra *Puthja* duhet parë universalisht. Edhe ne sot, mund të gjejmë veten sipas gjinisë në këtë tablo, dhe ndoshta ky ka qenë qëllimi i Klimt-it, duke pikturuar një pasion të zjarrtë të dy figurave pa fytyra të qarta, pasi ato fytyra mund të jenë tonat. Ndaj, i dashur lexues tani që e mbarove së lexuari këtë shkrim dhe shko e dhuroi një puthje të dashurës apo të dashurit tënd, dhe nëse të kërkohet shpjegim se nga të erdhi ky hov i papritur, jepi këtë përgjigje: *Puthja e* Gustav Klimt, *ajo e ka fajin.*

DAMON GALGUT FITON "THE BOOKER PRIZE" 2021

Damon Galgut fitoi *The Booker Prize* për portretizimin e një familjeje të bardhë afrikano-jugore që lundron në fundin e aperteidit. Juria e vlerësoi "The Promise" (Premtimi) si "një shfaqje mbresëlënëse e asaj se si romani mund të na bëjë të shohim dhe mendojmë ndryshe" dhe e krahasoi atë me veprat e William Faulkner dhe Virginia Woolf.

Kjo është hera e parë kur Galgut do të nderohet me çmimin £50,000, paçka se ai ka qenë në listën e ngushtë edhe dy herë të tjera. "The Promise" është romani i tij i nëntë dhe i pari në shtatë vjet. Kështu, ai u bë i treti afrikano-jugor që e fiton këtë çmim prestigjoz pas JM Coetzee dhe Nadine Gordimer. Përmes lenteve të katër funeraleve të njëpasnjëshme, secili i vendosur në dekada të ndryshme, "The Promise" ndjek Swarts, një familje e bardhë në Afrikën e Jugut që jeton në një fermë jashtë Pretorias. Premtimi i titullit është një i tillë i bërë nga Swarts-ët, të cilët dështuan ta mbanin përgjatë viteve, që t'ja jepnin shtëpinë dhe tokën gruas me ngjyrë e cila punoi për to gjatë gjithë jetës.

Romani është, sipas jurisë të *The Booker*, "një koment i fuqishëm dhe i qartë i historisë së Afrikës së Jugut dhe i humanizmit në vetvete që mund të përmblidhet më së miri në pyetjen: a ekziston drejtësia e vërtetë në këtë botë?"

"Ne ndjemë mes jurisë se ky libër është vërtetë një arritje. Ai kombinon një histori të jashtëzakonshme me tema të pasura – historinë e 40 vjetëve të fundit në Afrikën e Jugut – në një paketë jashtëzakonisht të mirësistemuar," tha kryetarja i jurisë së *The Booker*, historiania Maya Jasanoff. "Para se të fillonim të flisnim për tituj në veçanti, ne kishim një diskutim më të gjerë rreth asaj çfarë është ndjesia jonë për ta bërë një libër fitues. Njëri nga anëtarët bëri dallimin mes *shumë i mirë* dhe *madhështor*. Për mua, 'The promise' arrin të vendosë së bashku cilësitë e një historie madhështore – është një libër që përtypet me vështirësi - me vëmendjen e jashtëzakonshme për strukturën dhe stilin. Në secilin lexim të këtij libri, zbulohet diçka e re."

Galgut i cili u rrit në Pretoria, ku "The Promise" është vendosur, dhe që jeton tani në Cape Town, e përshkruan familjen Swart si "një lloj amalgame të gjithçkaje me çka u rrita në Pretoria."

"Ato janë një bashkim i anglishtes me afrikansen dhe gjithashtu një mishmas i kredove dhe besimeve. Jo e pazakontë për këtë pjesë të botës. Por çfarë i bën ata 'përfaqësues', nuk është karakteri, por koha në të cilën ata jetuan," tha ai në një intervistë për *The Booker Prize*.

Në marrjen e çmimit, Galgut tha "Ky ka qenë një vit i madh për letërsinë afrikane. Pëlqej ta pranoj këtë [çmim] në emër të të gjitha historive të thëna e të pathëna, të shkruara e të pashkruara nga kontinenti i shquar prej ku unë vi."

Ai shtoi "Shpresoj që njerëzit ta marrin letërsinë afrikane pak më seriozisht tani."

Galgut tha se ishte e rëndësishme për të që libri të ishte argëtues. "The Promise" merret me "temat e rënda" të "funeraleve, vdekjeve, kalbjeve dhe braktisjes... Nuk besoj se kam dashur të shpenzoj katër vjet për të shkruar një libër që po më rrëzonte. Humori krijon një mënyrë për mua që të shkruaj rreth anës njerëzore të gjerave, sepse libri nuk është vërtetë rreth vdekjes, por rreth jetës."

Struktura e "The Promise" është origjinale, me narracionin që zhvendoset mes perspektivave;

Juria e *The Booker Priza* e quan atë "një stil narrativ të pazakonshëm [që është] një testament i lulëzimit të romanit në shekullin XXI". Galgut thotë se filloi ta shkruante "The Promise" "në një mënyrë shumë më tradicionale", pjesëmarrja në shkrimin e skenarit të një filmi e ndihmoi të përfytyronte "se narratori mund të sillet si një kamera, duke u afruar e menjëherë më pas, larguar tek kërcen nga njëri personazh, në mes të skenës, ose dhe një fjali, ose ndjekjen e një vije të veprimit që nuk ka asgjë të bëjë me përmbajtjen."

"Në film, pika e vështrimit kërcen dhe ndryshon gjatë gjithë kohës – pse jo dhe në një roman? Isha shumë i emocionuar nga realizmi, sepse më çliron nga shtrëngimet e traditës dhe më lejon të jap sundimin e lirë të kakofonisë së zërave që duken gjithnjë të jenë përleshje e brendshme që do të dëgjohet," tha autori, që më përpara ka qenë në listën e ngushtë të *The Booker Prize* në 2003 për "The Good Doctor" dhe në 2010 me "In a Strange Room".

Idea për ta vendosur romanin rreth katër funeraleve erdhi pas "një pasditeje gjysëm të pirë, duke dëgjuar një shok tek përshkruante funeralet e prindërve, vëllait dhe motrës," i tha ai *The Guardian*. "Dramaturgu brenda meje pa potencialin në vënien në skenë të një historie familjare në katër akte, secila e përqendruar në një varrim. Dhe kur secili akt zë vend në një dekadë të ndryshme, me një president të ndryshëm në pushtet, vërejta një mënyrë për të shfaqur kombin përtej familjes dhe për të dhënë një shije të kohës."

Ndërsa juria ishte unanime në vendimin për t'ja dhënë çmimin Glaugut-it, Jasanoff thotë se ata kishin "goxha adhurim" për pesë romancierët e tjerë në listën e ngushtë: romancieren debutuese Patricia Lockwood me *No One Is Talking About This*, autoren britaniko-somaleze Nadifa Mohamed me *The Fortune Men*, amerikania Maggie Shipstead me *Great Circle*, romancieri nga Sri Lanka Anuk Arudpragasam me *A Passage North* dhe romancieri amerikan Richard Powers me *Bewilderment*. "Këto janë libra në të cilët ne vërtetë besuam dhe që ne besojmë se e meritojnë vendin e tyre në listën e ngushtë," tha Jasanoff.

Vitin e shkuar, *The Booker Prize* është fituar nga autori skocezo-ameriakan Douglas Stuart me romanin e tij të parë *Shuggie Bain*, bazuar në përvojën e vetë Stuart-it të rritjes në varfërinë e 1980 në Glasgow.

Marrë nga The Independent



DIAPSALMATA

ad se ipsum

aforizma nga Søren Kierkegaard

Përktheu Adri Kalaja

Grandeur, savoir, renomée,
Amitie, Plaisir et bien
Tout n'est que vent, que fumée :
Pour mieux dire, tout n'est rien.[1]

Çfarë është poeti? Poeti është qenie e palumtur zemra e të cilit është çjerrë prej vuajtjeve të fshehta por buzët e të cilit janë kaq çuditshëm të formuara sa kur psherëtimat dhe të qarat arratisen prej tyre tingëllojnë si muzikë e bukur. Fati i tij është si ai i viktimave të pafat që tirani Phalaris i burgoste në një dem prej bronzi të zgavërt dhe ngadalë i torturonte mbi një zjarr të qëndrueshëm, qaravitjet e tyre nuk i arrinin dot veshët e tiranit dhe për pasojë nuk mundeshin të shkaktonin zemëratë në shpirtin e tij, kur i mbërrinin në vesh, i dukeshin si muzikë e ëmbël. Dhe njerëzia bëhen turmë rreth poetit dhe i thonë atij: Këndo për ne një muzikë të afërt; kjo është si të thuash: "Shpresojmë që vuajtje të reja të mundojnë shpirtin tuaj por buzët tuaja të jenë aq të formuara sa më parë, të qarat vetëm do të na frikësonin, por muzika është me shije." Dhe kritikët gjithashtu vinë dhe thonë "Goxha e saktë, kështu duhet të jetë sipas rregullave të estetikës." Tani kuptohet që kritiku i ngjan një poeti deri në rrëzë të flokëve, atij vetëm i mungon vuajtja në zemrën e tij dhe muzika mbi buzët e tij. Prandaj, më mirë do të zgjidhja të isha pjesë e një turme me derra nga Amager dhe të kuptohesha nga llumi se të isha një poet dhe të keqkuptohesha nga njerëzit.

1 Madhështi, dije, famë
Miqësi, kënaqshëm e mirë
Gjitha nuk janë veç erë, veç tym
Më mirë thënë, gjithë nuk është asgjë

Pyetja e parë në më të hershmin dhe më përmbledhësin instruksion që një fëmijë është, siç të gjithë e dinë, kjo: Çfarë do marrë fëmija? Përgjigja është: da-da. Dhe me refleksione të tilla jeta fillon e megjithatë ka njerëz që e mohojnë mëkatin fillestar. Ndaj kujt fëmija i detyrohet mërzitë e para përveçse ndaj prindërve?

Preferoj të flas me fëmijë sepse akoma është e mundur të shpresosh se ato mund të bëhen qenie racionale. Për ato qe tashmë janë bërë të tilla, Zot i madh!

Sa absurdë që janë njerëzit! Ata kurrë nuk i përdorin liritë që kanë, ata kërkojnë atë që nuk kanë. Ata kanë liri mendimi dhe kërkojnë liri fjale.

Nuk më bën përshtypje asgjë. Nuk më intereson kalërimi sepse ai lloj ushtrimi është tepër i lodhshëm. Nuk më bëhet të ec, e ecura është shumë stresuese. Nuk më bëhet të shtrihem sepse përndryshe duhe të rri shtrirë dhe nuk më bëhet ta bëj as atë ose duhet të ngrihem prapë e as këtë të fundit nuk më bëhet ta bëj. *Summa Summarum*: nuk më bëhet të bëj asgjë.

Ka insekte të mirënjohura që vdesin në momentin e fekondimit. Kështu edhe me gjithë gëzimin, momentet më të gëzuara dhe supreme të kënaqësisë çiftohen me vdekjen.

Këshillë e testuar për autorët: Përcaktojini reflektimet tuaja pa kujdes dhe printojini, duke korrektuar fletët prova, më shumë ide të mira do të zbulojnë veten gradualisht. Prandaj, bëhuni kurajozë, të gjithë ju që nuk keni guxuar akoma të publikoni diçka, madje dhe printimet e dala huq nuk duhen përbuzur dhe një autor i cili bëhet i shkathët nepërmjet këtyre të fundit duhet të shihet si legjitimisht i tillë.

Kjo është mangësia e të gjitha gjërave njerëzore, që objekti i dëshirës arrihet fillimisht përmes së kundërtës. Nuk do të flas për multitudën e tipave temperamentalë që i japin diçka për të bërë psikologëve (temperamenti melankolik ka sens të lartë të komikes, më entuziasti është zakonisht më idiliku, më i shthururi zakonisht më morali, më dyshuesi zakonisht më besimtari) do të thërras në vëmendje faktin që një lumturi e përjetshme kalon më përpara nga mëkati.

Përveç rrethit të zakonshëm të të njohurve të mi kam akoma një të besuar intim - melankolinë time. Në mes shendit, në mes të punës sime, ai më thërret dhe më merr veç, megjithëse unë jam akoma në trupin tim. Melankolia është dashnorja më besnike që kam njohur, çfarë mbetet për t'u pyetur atëherë, që ja kthej dashurinë.

Ka një të arsyetuar thashethemexhie e cila në pafundësinë e vet mban në kurriz të njëjtën relatë me rezultatin, ashtu si linja e pandërprerë e monarkëve egjiptianë mbajnë vlerën historike të rregjimeve të tyre.

Mosha e vjetër realizon ëndrrat e rinisë: Shikoni përshembull Dean Smith, në rininë e tij ai ndërtoi një azil për të çmendurit, në moshë të vjetur u burgos vetë aty.

Kur sheh se me çfarë thellësie hipokondriake një gjeneratë më e hershme anglezësh zbuloi ambiguitetin që përbën thelbin e të qeshurës, është e lehtë të krijohet një ndjenjë ankthi. Dr. Hartley, përshembull bën një ndërhyrje të tillë: "Kur e qeshura fillimisht manifeston veten tek kërthiu është një e qarë e ngjizur, e ngacmuar prej dhimbjes ose nga një ndjenjë, dhimbja e përjetuar rishtazi dhe që shfaqet në intervale të shpeshta." Po sikur çdo gjë në botë të ishte një keqkuptim, po sikur të qeshurat të ishin në të vërtetë lotë?

Ka raste kur dikujt i shkaktohet një ndjenjë e mërzisë së pafundme tek shikon një qenie njerëzore që qëndron vetëm në botë. Prandaj, ditën tjetër pashë një vajzë të varfër tek ecte në kishë, si për ta konfirmuar këtë.

Cornelius Nepos tregon një histori për një komandant i cili qe mbyllur në një fortresë me disa forca të konsiderueshme kavalerie. Ky urdhëronte që kuajt të kamxhikoheshin përditë, në mos ato do të lëndoheshin nga kaq shumë duke ndenjur në vend – prandaj i jetoj këto ditë si dikush i rrethuar; në mos më bën dëm kaq shumë i ndenjuri në vend, qaj paturpësisht.

Përsëris për brengën time atë çfarë Anglezi thotë për shtëpinë e vet: brenga ime i përket shtëpisë sime. Ka shumë që e shohin brengën si një prej levërdive të jetës.

Më duket sikur jam një gur shahu dhe kundërshtari im thotë: "ai gur nuk lëvizet".

Arsyeja se pse *Aladdin* është kaq gjallërues ka të bëjë me faktin se kjo përrallë shpreh një guxim gjenial dhe njëherësh fëmijëror ndaj dëshirave ekstravagante.

Sa njerëz ka në epokën tonë të cilët vërtet guxojnë të shpresojnë, dëshirojnë dhe guxojnë t'i adresohen Natyrës me më shumë se një "të lutem" prej fëmije të sjellshëm apo me inatin e një shpirti të humbur? Sa njerëz ka atje të cilët në pikëpamjen e të ndjerit se njeriu është bërë në imazhin e zotit, diçka për të cilën epoka jonë flet shumë, kanë vërtet zë të komandës? Apo nuk jemi ne që qëndrojmë të gjithë aty si Nuredini duke u përkulur dhe kërkëllitur me frikën se mos pyesim shumë apo pak? Çdo kërkesë e mrekullueshme pak nga pak a nuk e redukton vetëm në një refleksion të sëmurë për egon duke kërkuar një gjë pas tjetrës, një art në të cilin jemi thelbësisht trajnuar?

Jam aq i rrudhur sa një *sheva* hebre, i dobët dhe i heshtur si një Daghesh lene; ndihem sikur një letër e printuar së prapthi në tubë dhe në të njëjtën kohë po aq i rëndësishëm sa një pasha me tre kokë, aq xheloz për veten time dhe mendimet e mia sa një bankë për kartmonedhat e saj dhe aq introvert sa çdo *pronomen reflexium.* Sikur fatkeqësitë dhe brengat të ishin si veprat e mira për të cilat ai që i kryen është i vetëdijshëm, në mënyrë që ata që i kryejnë e kanë marrë tashmë shpërblimin – nëse kjo bëhet e vërtetë për brengën atëherë do të isha më i lumturi i njerëzve; do i kisha marrë të gjitha telashet përpara dhe megjithatë të gjitha mbeten prapa.

Energjia e stërmadhe poetike e letërsisë popullore shprehet në vetvete, ndër gjëra të tjera, në forcën e saj dëshiruese. Dëshirat e epokës sonë janë, krahasuar me këto, të mërzitshme dhe mëkatare meqë ne dëshirojmë çka i përket komshiut. Letërsia popullore ishte fare mirë e vetëdijshme që fqinji zotëronte aq pak prej asaj që dëshironte sa ai prej të cilit e dëshironte. Dhe kur iu dha dëshirave mëkatare ato ishin kaq të tmerrshme sa t'i bënin njerëzit të dridheshin. Kjo dëshirë nuk e shet veten dhe aq lirë duke përllogaritur probabilitetet me arsye të kthjellët. *Don Juan* akoma ecën si kaposh në skenë me 1003 dashnoret e veta. Askush nuk guxon të buzëqeshë prej respektit për traditën e konsoliduar. Nëqoftëse do qe sjellë në mënyrë të ngjashme, ai do qe nxjerrë nga skena.

Në mënyrë të çuditshme u trishtova kur pashë një njeri të varfër duke ecur rrugëve me një pallto të vjetër të ngrënë me ngjyrë të lehtë jeshile në të verdhë. Më erdhi keq për të por gjëja që më preku mua më shumë ishte se ngjyra e palltos së tij më kujtoi përnjëherësh rezultatet e mia të para fëminore në artin fisnik të të pikturuarit. Kjo ngjyrë ishte, në mënyrë precize njëra prej nuancave të mia jetësore. Nuk është e trishtueshme që këto përzierje ngjyrash, të cilat i mendoj me shumë kënaqësi nuk gjenden askund në jetën reale; e gjithë bota i mendon të ashpra, të çuditshme, të përshtatshme vetëm për lojërat e Nurembergut. Ose, nëse ndokush rastis në to, ka gjithmonë diçka të pakënaqshme në lidhje me takimin, siç është rasti tani. Është gjithmonë dikush me vullnet të dobët, ose dikush që ka qenë i pafat, shkurt, dikush që e ndien veten të huaj në botë dhe bota nuk do ta pranojë. Dhe unë, që gjithmonë i kam pikturuar heronjtë e mi me këtë të paharrueshmen të verdhë në jeshile ngjyrën në pallton e tyre! A nuk ndodh kështu me të gjitha ngjyrat e përziera të fëmijërisë? Nuancat që jeta dikur kishte, gradualisht bëhen tepër të forta, të ashpra për sytë tanë të lodhur.

Në fund, dyert e fatit nuk happen së brendshmi. Duke hyrë me forcë dikush mund t'i sforcojë së jashtmi dhe për pasojë asgjë nuk mund të bëhet.

Kam kurajën; besoj; që të dyshoj çdo gjë. Kam kurajën; besoj; të luftoj me çdo gjë, por nuk e kam kurajën të di ndonjë gjë, as kurajën të zotëroj, të kem pranë diçka. Shumica e njerëzve ankohen që bota është kaq prozaike, që jeta nuk është romancë, ku mundësitë janë gjithmonë kaq tq favorshme. Ankohem që jeta nuk është si romanca, ku dikush kishte prindër kokëfortë dhe kukudhë e gogolë për të luftuar dhe princesha të magjepsura për të çliruar. Çfarë janë të gjithë këta armiq të marrë bashkë krahasuar me të zbehtët, këmbëngulëset forma nokturne me të cilat luftoj dhe të cilave i jap jetë dhe substancë.

Sa shterpë është shpirti dhe mendimi im dhe përgjithmonë i torturuar prej brerjeve, sensuale dhe torturuese! Mos duhet që shpirti im atëherë të rrijë gjuhëlidhur, mos duhet gjith të belbëzoj?

Për çfarë kam nevojë është një zë po aq penetrues sa syri i Lynceus, aq tmerrues sa psherëtima e gjigandëve, aq këmbëngulës sa zhurma e natyrës, aq tallës sa era e akullt e veriut, aq i lig sa ngacmimet e pashpirta të Echos, të një busulle nga basi më i thellë tek sopranoja më e butë, moduluar prej butësisë së shenjtë të pëshpërimës tek furia e dhunshme e inatit. Kjo është ajo çfarë kam nevojë në mënyrë që të marr frymë, të gjej shprehje për çfarë kam në mend, të trazoj të brendshmet e dhembshurisë dhe zemërimit tim. Por zëri im qendron në fyt ose shuhet tutje si bekimi mbi buzët e budallait.

Çfarë paralajmërohet? Çfarë do të sjellë e ardhmja? Nuk e di, nuk kam asnjë parandjenjë. Kur një merimangë rrëzohet nga një pikë e caktuar, në përputhje të plotë me natyrën e saj, gjithmonë sheh përpara vetes vetëm një hapësirë boshe ku nuk mund të gjejë pikëmbështetje pavarësisht sa shumë lëviz. Kështu ndodh edhe me me mua. Gjithmonë përpara meje një hapësirë bosh, çka më bën të eci përpara është një konsistencë e cila është tejkaluar. Kjo jetë është me shqetësime, e tmerrshme, e padurueshme.

Asnjë pjesë e jetës nuk është aq e bukur sa ditët e para të dashurisë, ku me çdo takim, me çdo shikim dikush tërheq diçka të re në shtëpi për ta gëzuar.

Pikëpamja ime jetësore është totalisht e pakuptimtë. Supozoj se një shpirt i lig më ka vendosur një palë syze mbi hundë, nga të cilat njëra lente është një tejqyrë tejet e fuqishme, tjetra, një lente zvogëluese me fuqi të njëjtë.

Dyshuesi është si maja e një kamxhiku, në majë për pak apo shumë kohë, në varësi të momentumit, por nuk mund të qëndrojë, aq i vogël sa një majë.

Ndër gjithë gjërat qesharake më duket më qesharakja të jesh i zënë me punë, i varur nga vaktet dhe i varur nga puna. Prandaj, kur shikoj një mizë që ulet në një moment kritik te hunda e një biznesmeni apo ta shoh të spërkatur nga një karrocë që i kalon afër me një ngut akoma më të madh, ose kur një urë e lëvizshme ngrihet përpara tij apo një tullë bien nga çatia dhe e lë të vdekur, atëherë qesh megjithë zemër. E kush mund të ketë çfarë ti bëjë të qeshurës? Çfarë do arrijnë këta matrapazë? A nuk janë ata si ajo shtëpiakja që kur shtëpinë e kishte në zjarr shpëtoi dorezat e furrës? Çfarë më shumë do të shpëtojnë nga zjarri i madh i jetës?

Në mënyrë të përgjithshme më mungon durimi për të jetuar. Nuk mund të shoh barin të rritet, por, meqë nuk mundem, nuk e vras mendjen ta shoh fare. Pikëpamjet e mia janë vëzhgimet e shkurtra të një shkollari udhëtues i cili vete përmes jetës me një nxitim të tepërt. Njerëzit thonë që stomaku i një zotërie mbushet përpara syve të tij; nuk e kam vënë kurrë re; sytë e mi janë të ngopur dhe në gatishmëri ndaj çdo gjëje, e megjithatë ndiej uri.

Më pyesni për çfarë të doni por mos më kërkoni arsye. Një vajze mund t'i falet nëse nuk është e zonja të japë shpjegime meqë thuhet se ajo jeton në ndjenjat e saj. Jo me mua. Përgjithësisht kam shumë arsye, dhe në shumë raste arsye kontradiktore të ndërsjella, për këtë shkak është e pamundur për mua të jap arsye. Duket që diçka ka shkuar keq me shkakun dhe afektin, sikur nuk venë tamam bashkë. Shkaqe të mëdha dhe të jashtëzakonshme ndonjëherë prodhojnë efekte të vogla dhe jo mbresëlënëse, ndonjëherë asnjë efekt; më pas ndonjëherë ndodh që një shkak fare i vogël prodhon një efekt kolosal.

Dhe tani kënaqësitë e pafajshme të jetës. Duhet pranuar se ato kanë vetëm një faj, që janë kaq të pafajshme. Për më tepër ato duhen kënaqur në mënyrë të moderuar. Kur doktori im më jep një dietë, ka njëfarësoj kuptimi; abstenoj prej ushqimeve të caktuara për një kohë specifike por të qenit dietik në dietë – do të thotë të kërkosh shumë.

Jeta është bërë një pije e hidhur për mua dhe megjithatë duhet ta marr si ilaç, ngadalë dhe pikë-pikë.

Askush nuk kthehet pas prej të vdekurve, askush nuk hyn në botë pa qarë. Askush nuk pyetet kur ka dëshirë të hyjë në jetë, askush nuk pyetet kur ka dëshirë të largohet.

Koha rrjedh, jeta është një valë, njerëzit thonë, dhe kështu me rradhë. Nuk e vë fare re. Koha rri në vend dhe unë me të bashkë. Të gjitha planet që bëj më përplasen në fytyrë. Kur do pështyja, do pështyja fytyrën time.

Kur zgjohem në mëngjes kthehem në shtrat sërish. Ndihem mirë në darkë kur fiki dritën dhe tërheq kuvertën mbi kokë. Më pas ngrihem sërish, shikoj rreth dhomës me kënaqësi të papërshkrueshme dhe, pastaj, natën e mirë, nën kuvertë.

Për çfarë duhem unë? Për çdo gjë apo asgjë? Kjo është një zgjuarsi e rrallë. Pyes veten nëse bota do e vlereësojë? Zoti e di nëse çupat punëtore që kërkojnë një pozicion pune si shërbyese gjejnë ndonjë vend ose, në mungesë të tij, diçka të çfarëdoshme.

Dikush duhet të jetë misterioz, jo vetëm ndaj të tjerëve, por ndaj vetes. E studio veten; kur bëhem i vetëdijshëm për këtë gjë, për të kaluar kohën ndezi një cigare dhe mendoj: Zoti di vetëm ç'ka kishte planifikuar për mua ose ç'ka kish në plan të bënte me mua.

Asnjë grua shtatëzënë nuk mund të ketë dëshira më të çuditshme apo më të paduruara se unë. Këto dëshira ndonjëherë kanë të bëjnë me gjërat më të zakonshme, ndonjëherë me më të lartësuarat, por janë në mënyrë të barabartë me pasionin momentar të shpirtit. Në këtë moment dëshiroj një tas me porrixh hikrre. Mbaj mend prej ditëve të shkollës qe ne gjithmonë hanim këtë të mërkurave. Mbaj mend sa i butë dhe sa i bardhë ishte kur shërbehej, gjalpi dukej sikur buzëqeshte, sa i ngrohtë dukej porrixhi, sa i uritur isha, sa i paduruar për t'u lejuar të rifilloj. Ah, një pjatë e tillë porrixhi! Do të jepja më shumë se trashëgiminë për të!

Magjistari Virgil dikur e ndau veten në shtatë copa të cilat, të zhytura nëpër kazanë për t'u zier përgjatë një jave në mënyrë që rinia e tij të rinovohej. Ai punësoi një burrë që të bënte roje në mënyrë që asnjë të mos ndërhynte. Por roja nuk mundi t'i rezistonte tundimit, ishte tepër herët, Virgjili u zhduk me një të qarë si fëmijë i vogël. Unë gjithashtu padyshim kam shikuar tepër shpejt tek kazani, kazani i jetës dhe zhvillimit historik dhe mesa duket asnjëherë nuk do të arrij të bëhem më shumë se fëmijë.

"Një burrë nuk duhet kurrë të humbasë kurajën, kur fati i keq shtohet në mënyrën më të frikshme për të, duket në qiell një dorë ndihmëse." Kështu foli pastor Jesper Morten javën e kaluar. Tani kam marrë zakon të udhëtoj shpesh nën qiellin e hapur por nuk kam parë diçka të ngjashme. Disa ditë më përpara, megjithatë, gjatë një shëtitjeje, një fenomen i tillë zuri vend. Nuk qe ekzaktësisht një dorë por diçka si krah ajo që që u zgjat nga qielli. Fillova të mendoj. Kuptova që po të kishte qenë pastori këtu ai mund të kish qenë në gjendje të vendoste nëse ky ishte fenomeni të cilit ai iu referua. Kur po qëndroja aty mes mendimeve të mia mu drejtua një udhëtar. Duke bërë me gisht drejt qiellit më tha: "E shikon atë pellg? Janë tepër të rrallë në këto anë, ndonjëherë marrin shtëpi të tëra me vete." "Zot na ruaj,"- mendova, "është ai vërtetë një pellg uji?"- dhe ja dhashë vrapit aq shpejt sa munda. Pyes veten se çfarë do të kish bërë pastori në vendin tim.

E ndaj kohën në mënyrën më poshtë! Gjysmën e kohës fle, gjysmën e kohës ëndërroj. Kurrë nuk ëndërroj kur fle, ajo do të ishte mëshirë sepse gjumi është arritja më e lartë e gjeniut.

Për t'u bërë njeri perfekt është, pas së gjithash ideali më i lartë njerëzor. Tani kam drithë, i cili duhet t'i hyjë në punë dikujt.

Rezultati i jetës sime është thjesht asgjë, një humor i caktuar, një ngjyrë e vetme. Rezultati im është si ai i një artisti i cili po planifikonte të pikturonte një pikturë të izraelitëve tek kalonin detin e kuq. Në fund të kësaj ai e pikturoi të gjithë murin e kuq duke shpjeguar se izraelitët kishin kaluar tashmë dhe egjiptianët qenë mbytur.

BA
SHKË
KO
HOR
ËT



Giedra
RADVILAVIČIŪTĖ

Ata
të cilët do të doja
të takoja sërish

tregime

OMBRA GVG
design21